



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë/Ministarstvo Pravde/Ministry of Justice

RAPORT VJETOR

I ZBATIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE

PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NDAJ

GRAVE

2022-2026

Maj 2024

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----|
| HYRJE | 3 |
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE..... | 4 |
| II. PROGRESI I PËRGJITHSHEM I ZBATIMIT PER VITIN 2023..... | 5 |
| III. PROGRESI I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE | 5 |
| 1. Objektivi Strategjik #1: Parandalimi dhe identifikimi i dhunës | 5 |
| 2. Objektivi Strategjik #2: Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare | 11 |
| 3. Objektivi strategjik #3: Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave. 14 | |
| 4. Objektivi strategjik #4: Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat | 19 |
| IV. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME SIPAS STRUKTURAVE ZBATUESE | 222 |
| V. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET | 233 |
| VI. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE .Error! Bookmark not defined.6 | |
| SHTOJCA 1 | 28 |

HYRJE

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 - 2026 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Janar të vitit 2022.¹ Kjo Strategji synon të sigurojë mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në përputhje me standardet e instrumenteve ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Duke u bazuar në këtë, Strategjia përfshin 4 objektiva strategjike: 1) Parandalimi dhe identifikimi i dhunës, 2) Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare, 3) Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave dhe 4) Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat. Këta objektiva ndahen tutje në 13 objektiva specifike, të cilat përmbajnë së paku nëntë aktivitete konkrete për secilin objektiv specifik.

Ky është Raporti i dytë vjetor (Janar-Dhjetor 2023) për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të parapara me Planin e Veprimit 2022-2024 për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026. Raporti është hartuar duke u bazuar në standardet e raportimit të dokumenteve strategjike, sipas Udhëzimit Administrativ 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit² dhe Manualit për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit.³ Po ashtu, është përdorur metodologjia për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave sipas “Kornizës së Monitorimit për vitin 2022” i cili u hartua nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Grupin Punues përgjegjës për monitorim të dokumentit strategjik.

Raporti përfshin të dhëna mbi zbatimin e përgjithshëm, zbatimin sipas objektivave strategjike e specifike si dhe paraqet performancën e përgjithshme sipas strukturave zbatuese. Të dhënat e prezantuara janë të paraqitura në formë narrative por edhe grafike, në mënyrë që të ofrohet informacion më i detajuar lidhur me zbatimin e aktiviteteve të parapara në planin e veprimit për zbatimin e strategjisë. Plani i Veprimit përmban një pasaportë të indikatorëve, mirëpo vlerësimi i progresit sipas pasaportës së indikatorëve bëhet në baza trevjeçare, meqë ky raportim është për periudhën njëvjeçare Janar – Dhjetor 2023, raportohet vetëm në nivel të zbatimit të aktiviteteve të parapara për periudhën përkatëse. Njëherazi, përpos grafikoneve të paraqitura për rezultatet e implementimit të objektivave strategjike dhe atyre specifike për vitin 2023, janë ruajtur edhe rezultatet nga implementimi i të njejtave në periudhën paraprake të raportimit 2022, për të bërë krahasimin e rezultateve të arritura nga viti në vit. Në fund, raporti paraqet konkluzionet dhe rekomandimet, si dhe rreziqet dhe hapat që duhet të ndërmerren për tejkalimin e tyre.

Në shtojcën 1, janë dhënë shpjegime të detajuara nga institucione bartëse për zbatimin e secilit aktivitet, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë.

¹ Mbledhja e 56-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi 12/56: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Vendimet-e-Mbledhjes-se-56-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-1-1.pdf>

² Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/udhezimi-administrativ-qrk-nr.-07-2018-per-planifikimin-dhe-hartimin-e-dokumenteve-strategjike-dhe-planeve-te-veprimit-28-03-2018.pdf>

³ Manuali për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/manual-per-planifikimin-hartimin-dhe-monitorimin-e-dokumenteve-strategjike-dhe-planeve-te-tyre-te-veprimit.pdf>


I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjetjet e Raportit vjetor për Strategjinë, që njëkohësisht pasqyrojnë situatën aktuale sa i përket dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Republikën e Kosovës, ofrojnë informata mbi aktivitetet kyçe të cilët janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin vendor, Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021–2025, Konventën e Stambollit, Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave (CEDAW), Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendën 2030, si dhe strategji të tjera sektoriale. Rezulton se janë bërë përmirësime përmes aktiviteteve të realizuara të Strategjisë në fushën e avancimit dhe harmonizimit të politikave publike me standardet ndërkombëtare, fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë, fuqizimit institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave si dhe trajtimi i kryeseve të dhunës ndaj grave përmes programit psiko-social.

Këto aktivitete të Strategjisë janë vlerësuar në bazë të tri kategorive vlerësuese: 1) të zbatuara plotësisht; 2) të zbatuara pjesërisht ose në zbatim e sipër; dhe 3) të pazbatuara.

Per dallim nga viti 2022, vërehet ngritje e dukshme në progresin e zbatueshmërisë së aktiviteteve të parapara për vitin 2023. Kështu, nga gjithsej 135 aktivitete të parapara që të realizohen gjatë viti 2023, 86% apo 117 aktivitete janë zbatuar plotësisht/ose janë në proces të zbatimit, 13% apo 18 aktivitete nuk janë zbatuar sipas dinamikës së paraparë në planin e veprimit për vitin 2023.

Aktivitetet për këtë periudhë të Strategjisë janë vlerësuar në bazë të tre kategorive vlerësuese: 1) të zbatuara plotësisht; 2) të zbatuara pjesërisht ose në zbatim e sipër; dhe 3) të pazbatuara.



II. PROGRESI I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT PËR VITIN 2023

Sa i përket përqindjes së aktiviteteve të realizuara sipas strategjisë, në fig.1, është paraqitur gjendja e zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë për periudhen raportuese

Duke u bazuar në Figurën 1., vërejmë se pjesa më e madhe e aktiviteteve që janë paraparë në Planin e Veprimit të Strategjisë për këtë periudhë të vitit 2023, janë zbatuar plotësisht apo janë duke u zbatuar, ku nga të dhënat shihet se 87 % e aktiviteteve janë zbatuar apo pjesërisht kanë gjetur zbatim. Nga 135 aktivitetet e planifikuara gjatë periudhës raportuese, 65 aktivitete (48%) janë zbatuar plotësisht, 52 aktivitete (39 %) janë zbatuar pjesërisht apo janë në proces të zbatimit, ndërsa 18 aktivitete (13.%) nuk janë zbatuar.

Ndërsa aktivitetet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë raport janë të parapara për tu zbatuar sipas Planit Veprimit pas vitit 2023.


Vlenë gjithashtu të theksohet, që gjatë periudhës së raportimit për vitin 2023, krahas aktiviteteve të parapara për zbatim në këtë vit, kanë vazhduar të implementohen edhe aktivitete që kanë qenë të ndërlydhura në vazhdimësi të aktiviteteve nga periudha e kaluar të raportimit, përfshirë këtu edhe disa aktivitete të cilat nuk janë zbatuar gjatë periudhës paraprake por që kanë vazhduar të zbatohen këtë vit. Si rrjedhojë, të gjitha së bashku kanë reflektuar nivel dukshëm më të lartë të zbatueshmësisë së aktiviteteve në këtë periudhë të vitit të dytë të zbatimit, 2023, të strategjisë (2022-2026)

III. PROGRESI I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

1. Objektivi Strategjik #1: Parandalimi dhe identifikimi i dhunës

Parandalimi dhe identifikimi i dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave kanë vazhduar të jenë prioritet dhe të adresohen si fenomene shumë të rëndësishme edhe këtë vit sipas Planit të Veprimit, ku nga të gjitha objektivat strategjike, numri më i madh i aktiviteteve është i paraparë në kuadër të kësaj objektive. Në këtë drejtim, nga gjithsej 41 aktivitete të planifikuara, 20 prej tyre janë zbatuar plotësisht (49%), 15 prej tyre janë zbatuar pjesërisht (37%), si dhe 6 aktivitete mbeten të pazbatuara, rreth (13%). Kjo tregon që niveli i zbatueshmërisë në vitin 2023 krahasuar me vitin paraprak (2022) është dukshëm më i rritur.

*Fig. 2: Rezultatet në kuadër të Objektivit Strategjik #1.
Parandalimi dhe identifikimi i dhunës
2023*



Zbatimi dukshëm më i lartë në kuadër të këtij objektivit strategjik është i pranishëm në objektivin specifik OS 1.4 “Krijimi dhe zbatimi i programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës” dhe OS 1.1 “Ndryshimi i sjelljeve qëndrimeve, roleve dhe stereotipeve” në raport me numrin e aktiviteteve të planifikuara. Ndërsa, numri më i madh i aktiviteteve të pa zbatuara, në raport me aktivitetet e planifikuara, paraqitet në objektivin specifik OS 1.3 “Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, medias dhe sektorit privat për promovimin e masave për të parandaluar dhe luftuar dhunën”

Si histori kryesore të suksesit në këtë objektiv mund të përmenden: Aktivitete vetëdijësuese të përmuajshme mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave me fokus të veçantë në grupet e cënueshme të grave dhe vajzave; Adresimi i dhunës në familje dhe martesat e hershme; Promovimi i modeleve pozitive të Agjentëve të ndryshimit në komunitet, të cilët sfidojnë stereotipet gjinore dhe shprehin mos-tolerancë ndaj dhunës; Edukimi i bashkëmoshatarëve, vajza dhe djem (peer education) për parandalimin dhe identifikimin e ngacmimit seksual në shkolla, si dhe për të krijuar qëndrim kritik ndaj portretizimit negativ dhe seksist të imazhit të grave dhe vajzave në fusha të ndryshme të jetës; Fushatat/aktivitetet vetëdijësuese të vazhdueshme nga Policia e Kosovës për dhunë në familje, ngacmimet seksuale, kundër përdorimit të substancave narkotike, trafikimit me njerëz, siguria në komunikacion dhe thirrje qytetarëve të ndalojnë dhunën ndaj anëtarëve të familjes dhe të raportojnë rastet e dhunës në Policinë e Kosovës; Tutje, janë bërë edhe sesione informim të publikut përmes mediave për pasojat që sjell dhuna

në familje si informimi lidhur me detyrat dhe përgjegjësit e Policisë së Kosovës në trajtimin e kësaj dukurie, përfshirë këtu edhe informimin rreth hetimit efektiv dhe përgjigje e menjëhershme e policisë në thirrjet për ndihmë, menaxhim të duhur të situatave të rrezikshme dhe hetim për të gjitha akuzat për dhunë ndaj grave dhe dhunë në familje, duke evidentuar rrethanat rënduese.

Storie tjetër suksesi që vazhdon edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit është Fushata e përvitshme e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. Shtimi i programit të vizitave në shtëpi për këshillim të prindërimit pozitiv për gratë dhe familjen pranë qendrave të shërbimeve shëndetësore për gratë dhe familjen, ose pranë qendrave për punë sociale, si dhe shtimi i identifikimit të rasteve të dhunës në familje të identifikuara nga observimi gjatë vizitave në shtëpi.

Si veprime institucionale gjatë kësaj periudhe (2023) vlenë gjithashtu të përmendet themelimi i Grupit Ndërinstitucional për parandalimin e martesave të hershme në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian me propozim të Ministrisë së Drejtësisë. Çështja e martesave nën moshën 18 vjeçare është trajtuar edhe me draftin e Kodit Civil dhe themelimi i këtij grupi do të ndihmojë në vetëdijesimin e shoqërisë për pasojat e martesave të hershme dhe parandalimin e tyre.

Me qëllim të informimit rreth masave të cilat duhet marrë për adresimin e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore janë mbajtur sesione intenzive informuese me shoqëri civile, vizita vetëdijësuese të viktimave lidhur me rëndësinë e raportimit të dhunës, si dhe sesione informimi nëpër shoqatat e nënave vetëushqyese dhe grupe të grave viktime nga dhuna nëpër strehimore lidhur me shërbime që lidhen me dhunën në familje përmes ndihmës juridike falas dhe kompensimi i viktimave.

Në kuadër të programit të vizitave në shtëpi për kujdes ndaj nënës dhe fëmijës këshillohen gratë shtatëzana, nënat dhe baballarët për prindërimin pozitiv. Të trajtuarit për zbatimin e programit të vizitave në shtëpi janë të trajnuar edhe me modulën për prindësi të mirë. Gjatë këtij viti (2023) janë trajnuar 252 profesionistë shëndetësorë, infermiere, edukatore dhe punëtorë social për të ofruar këto këshillime.

Si iniciativë për mbrojtjen e fëmijëve dhe prindërve nga përdorimi i dëmshëm i faqeve të ndryshme të internetit, dhe për të siguruar informacion për fëmijët dhe prindërit për përdorimin e sigurtë të internetit, mediave sociale dhe komunikimeve elektronike është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi në mes të Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Fondacioni Terre des hommes Laussane në Kosovë (TdhK), sipas të cilit palët zotohen të ngrisin nivelin e bashkëpunimit reciprok për implementimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në media. Në këtë drejtim memorandumit ka për qëllim që të licencuarit e KPM-së të ndër marrin masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mental dhe moral të tyre, në veçanti programet me përmbajtje të papërshtatshme ose

dhunë ekstreme. Njëherazi, ky memorandum synon të promovojë në media temat që adresojnë mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtat e komuniteteve, drejtësinë për të mitur si dhe iniciativa të ngjashme. Ndër aktivitetet që parashihen janë organizimet e përbashkëta si: fushata vetëdijesuese, trajnime, sesione informuese, tryeza diskutimi, konferenca dhe takime për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Storie suksesi, gjatë kësaj periudhe të raportimit është trajnimi intenziv i personelit në programe të trajtimit psiko-social të kryerësve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave. Janë trajnuar personeli shëndetësor nga të gjitha qendrat që ofrojnë trajtime psiko-sociale, të cilët edhe janë çertifikuar nga Oda e Mjekëve për trajtim të kryerësve të dhunës dhe trajnimet e profesionistëve shëndetësorë sipas programit të tyre brenda institucionit ku trajtohen kryesisht e dhunës me vendim gjykate. Gjatë kësaj periudhe, janë trajtuar të gjitha rastet me prioritet sipas Urdhëresave dhe kërkesave të parashtruara nga gjykata dhe prokurorët në IPFK, ku edhe është bërë risocializimi dhe riintegrimi në bazë të protokoleve të brendshme dhe programeve të veçanta të miratuara për trajtimin e kryerësve të varur nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor. Kryerësit e dhunës në familje, në përputhje edhe me grupmohën e tyre janë trajtuar brenda institucioneve nga profesionistët e trajnuar për të trajtuar personat me varësi nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor. Njëherazi, janë bërë ekzaminime të vazhdueshme hospitalore dhe psikiatrike të kryerësve të dhunës, (burra dhe gra) për të ju ofruar trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim pëgjat tërë vitit. Në këtë drejtim, sfidë gjatë kësaj periudhe ende mbetet mungesa e vendeve të lira për trajtim të kryerësve të dhunës me probleme të shëndetit mendor dhe substancave që rezultojnë në zvogëlimin e rasteve të dërgimit në paraburgim të të pandehurve për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të shtretërve.

Meqenëse Strategjia parasheh përgaditjen dhe publikimin e raportit vjetor lidhur me trajtimin e kryerësve të dhunës, gjatë periudhës së raportimit, për herë të parë në Kosovë është lansuar programi për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave, gjatë vitit 2023 dhe janë bërë të gjitha përgaditjet për pilotimin e programin 6-mujor në vitin 2024 sipas të cilit do të trajtohen të burgosur me veper penale dhuna në familje sipas metodes DULUTH.

Si sfidë gjatë kësaj periudhe, janë evidentuar vonesa lidhur me realizimin e hulumtimit për perceptimin e përgjithshëm mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, i cili ishte planifikuar të përfundojë në vitin 2022, por që ende nuk është kompletuar. Raporti statistikor i kësaj analize është përgaditur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) por mungon analiza e të dhënave. Kështu, Ministria e Drejtësisë, në dhjetor 2023, në bashkëpunim me Ambasaden Angleze ka ri-filluar këtë hulumtim prapë i cili pritet të përfundojë në fund të muajit prill 2024. Tutje, sfidë mbetet edhe matja e arritshmërisë së kampanjes, meqenëse ende nuk është zhvilluar ndonjë instrument matës për të ditur

nivelin e vetdijësimit të personave, e në vecanti të burrave e djemëve rreth dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave tek të cilët ka ndikuar kampanja.

Krahas sfidave të përmendura më lart, në kuadër të këtij objekti, janë evidentuar sfida vështirësi tek kapacitetet e institucioneve për zbatimin e aktiviteteve konkrete në hartimin e programeve dhe analizave përkatëse, si dhe mungesa e kapaciteteve buxhetore të mjaftueshme për organizimin e fushatave vetëdijësuese, sesionet informuese dhe hulumtimet relevante.

Sfidë mbetet inkurajimi i mediave për të vendosur udhëzime dhe standarde vetë-rregulluese për të rritur respektin për dinjitetin e grave, në mënyrë që të ndihmojnë në ndërtimin e roleve pozitive gjinore dhe të parandalojnë dhunën kundër grave. Edukimi i profesionistëve dhe profesionistëve të medias për të trajtuar me më shumë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm çështjet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; Përgatitja dhe zbatimi i politikave të qarta dhe mekanizmave funksionalë të ankesave që ndalojnë materialet diskriminuese, me përmbajtje seksiste, apo që favorizojnë dhunën në familje dhe efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose zakonore, në median audiovizive e të shkruar.

Sfidë tjetër mbetet inkurajimi i mediave për të raportuar në mënyrën e duhur dhe analizojnë dhunën në familje e dhunën ndaj grave duke reaguar me profesionalizëm dhe duke respektuar parimet e etikës dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas Strategjisë kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe Konventës së Stambollit; Njëherazi, sfidë mbetet bashkëpunimi me mediat dhe kompanitë e informacionit të teknologjisë për të shmangur dhunën, ngacmimin seksual apo përndjekjen e grave dhe vajzave nëpërmjet medias sociale e internetit.

Progresi sipas rezultateve të pritura në kuadër të Objektivit Strategjik 1 brenda periudhës së raportimit sipas strategjisë

- Rritje e dukshme e numrit të fushatave dhe sesione informuese përgjatë tërë periudhës raportuese nga të gjithë akterët kryesorë institucional dhe ndërsektorial për ngritje të vetdijësimit të shoqërisë për të mos toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave si rrjedhojë e veprimeve të integruara
- Rritje e sesioneve informuese dhe vetëdijësimi të shoqërisë civile, shoqatave të grave dhe strehimoreve që merren me mbrojtjen e viktimave ndaj dhunës për të inkurajuar raportimin e rasteve të dhunës dhe informimi i tyre për të drejtat si dhe mënyrën e çasjes së tyre në ndihmë juridike falas për të adresuar dhe realizuar të drejtat e tyre siç edhe e parasheh legjislacioni në fuqi;
- Krijimi i një baze të të dhënave për kryerësit që kanë marrë shërbime/ trajtim psiko-social gjatë dhe pas kryerjes së dënimit. Kjo është realizuar në kuadër të

databazës ekzistuese për evidentimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Kjo data bazë është një modul i ri i zhvilluar krahas zhvillimit të programit për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave. Aktualisht programi i trajtimit është në proces të zbatimit dhe në të njëjtën kohë është duke u zhvilluar edhe procesi i monitorimit, pët të mundësuar matjen e treguesve të harmonizuar treguesit me treguesit SDG 5.2.2. dhe 11.7.2, apo edhe i treguesëve të tjerë të cilët maten në nivel ndërkombëtar;

- Janë hartuar programe lëndore të institucioneve arsimore para universitare të edukimit seksual të gjitha niveleve që ofrojnë dije për parandalimin, identifikimin, mbrojtjen dhe në tërësi luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.
- Janë realizuar trajnime, standarde, manuale dhe protokolle për stafin e institucioneve arsimore para universitare që të jenë më të përgatitur profesionalisht për të identifikuar dhe referuar sipas standardeve rastet e dhunës në familje apo dhunës ndaj grave;
- Në kuadër të programit të vizitave në shtëpi për kujdes ndaj nënës dhe fëmijës këshillohen gratë shtatzëna, nënat dhe baballarët për prindërimin pozitiv. Të trajnuarit për zbatimin e programit të vizitave në shtëpi janë të trajnuar edhe me modulën për prindësi të mirë; Janë realizuar gjithësejt 42004 vizita në shtëpi nga të cilat 36336 për fëmijë 0-3 vjeç; 5668 Vizita për gra shtatzëna; 1880vizita për fëmijë në komunitet Rom Ashkali dhe Egjiptian; 511 vizita për gra shtatzëna dhe komunitet rom, ashkai dhe egjiptian; 487 fëmijë gjatë vizitave të referuara te specialistët tjerë; 151 fëmijë janë identifikuar me ngecje në zhvillim dhe referuar (nga kontrollët gjatë vizitës në shtëpi); 1115 raste sociale të identifikuar dhe te raportuara; 9 raste të dhunës në familje te identifikuar (nga observimi gjatë vizitave në shtëpi);
- Janë marrë iniciativa konkrete për ofrimin e trajtimeve psiko-sociale për kryerësit e dhunës në familje në përputhje me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare. Fuqizimi i kapaciteteve Shërbimit Sprovues të Kosovës për përcjelljen e rehabilitimit të kryerësve të dhunës përmes trajnimit intensiv për trajner për zbatimin e Programit të Trajtimit Psikosocial për punën me kryesit e dhunës në familje.


Sfidë mbetet bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, mediave dhe bizneseve private i cili duhet të fuqizohet dhe shoqërohet me rezultate pozitive në veprime kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, vërehet përfaqsim i një numri të madh të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha insitucionet relevante, në nivel lokal e atë qëndror në të gjitha aktivitetet vetëdijësuese që janë organizuar lidhur me edukimin e shoqërisë rreth dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave si fenomen i patolerueshme. Pritet që pas hulumtimit që do të zhvillohet rreth perceptimit të publikut të gjërë rreth këtij fenomeni të dhunës, të kuptohet edhe rezultati i arritshmërisë së fushatave vetëdijësuese, dhe ndikimi i saj në ndryshimin e sjelljeve dhe stereotipeve ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në përgjithësi, gjë që është edhe synimi i Objektivit Strategjik 1 të strategjisë.

2. Objektivit Strategjik #2: Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare.

Objektivit Strategjik 2 përfshin gjithsej 30 aktivitete, për periudhën raportuese, 2023, të cilat synojnë përmirësimin e kornizës ligjore, investime në burime njerëzore e infrastrukturore, si dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, me qëllim të lehtësimit të proceseve të trajtimit të viktimave dhe menaxhimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Në kuadër të Objektivit Strategjik 2, janë 22 aktivitete të zbatuara plotësisht (73%), 6 aktivitete janë zbatuar pjesërisht (20%), kurse 2 aktivitete mbeten të pazbatuara (6%), gjatë kësaj periudhe raportuese.



Objektivi specifik II.2 “Fuqizimi i kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave” i ka në tërësi të zbatuara të gjitha aktivitetet të cilat janë paraparë të zbatohen brenda periudhës së raportimit Janar-Dhjetor 2023.

Ndërlidhur me objektivin 2, si histori sukseesi konsiderohen: Analiza e plotë e kuadrit ligjor civil dhe penal mbi dhunën ndaj grave, dhunën në familje, si dhe evidentimi i masave që duhet të ndërmerren për ta harmonizuar këtë kuadër ligjor me instrumentet ndërkombëtarë, përfshirë CEDAW dhe Konventën e Stambollit; Raporti i vlerësimit të përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave me Konventën e Stambollit, [GREVIO]; harmonizimi i ligjeve dhe politikave të Grevios, për plotësim ndryshimin e 3 projekt akteve: Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale si dhe plotësim ndryshimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, këto dokumente ligjore janë votuar nga parlamenti dhe janë në fuqi; Përgatitja dhe paraqitja e projekt-akteve për ndryshim/plotësimin e kuadrit ligjor civil; hartimi dhe miratimi i protokolleve dhe programet e veçanta për trajtimin e kryerësve të varur nga substancat, apo me probleme të shëndetit mendor. Janë hartuar dhe miratuar dy Udhëzime për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje sipas të cilëve kryerësit trajtohen në tri nivelet e kujdesit shëndetësor; bashkëpunimi me ndërmarrjet publike, për “Shpërndarjen e mesazhit në secilën shtëpi” me sloganin i fushatës “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR” kundër dhunës dhe thirrjet për raportim; Telekomini e Kosovës VALA për shpërndarjen e mesazheve: Mos dhuno! Raporto 192!” dhe përmes Qendrës Kinematografike shfaqja e filmave të cilët kanë trajtuar fenomenin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe trafikimin dhe dhunën seksuale ndaj vajzave

Storie sukseesi gjatë kësaj periudhe raportimi gjithashtu është rishikimi i kurrikulave dhe moduleve të trajnimit në departamentin e trajnimeve në Policinë e Kosovës dhe përditësimi i tyre sipas kërkesave të kuadrit ligjor kombëtar e ndërkombëtar (me këndvështrimin gjinor të përfshirë) për ngritjen e kapaciteteve profesionale të kadetëve dhe policëve; Rishikimi edhe i programeve të trajnimeve afatshkurtëra në të cilat trajtohet dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave si trajnime themelore në Hetimin e Krimit; Hetimi i Dhunës Familjare; Trajnimi i Avancuar i Hetimit të Krimit; Trajnimi i zyrtareve/zyrtarëve policorë mbi përkufizimin e dhunës në baza gjinore dhe ngacmimit seksual sipas ligjeve të Kosovës, si dhe mbi mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve, konform Kodit Penal të Kosovës; 12 lloje të trajnimeve me gjithsej 19 trajnime ku janë përfshirë temat e ngacmimit seksual dhe dhunës me baza gjinore ku ndër të tjerash janë realizuar edhe trajnime të fushave të veçanta si: Ngacmimi Seksual në vendin e punës; Trajnimi Qasja ndaj Dhunës në Baza Gjinore dhe Trajnimi Hetimi i dhunës në familje;

Tutje storie sukseesi është progresi në përgatitjen dhe zbatimin e kurrikulës dhe zhvillimi i trajnimeve për punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë për identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Progres është bërë gjithashtu në ndarjen e hapësirës fizike dhe dhomave mike për intervistimin e viktimës dhe kryerësit të dhunës, përderisa mbeten të vazhdohet me

ngritjen e të njëjtave edhe për stacionet tjera policore. Njëherazi, është evidentuar ngritje e numrit të Urdhrave Mbrojtës të lëshuara nga gjykata për mbrojtje të viktimave nga kryersit e dhunës.

Progresi sipas rezultateve të pritura në kuadër të Objektivit Strategjik 2 brenda periudhës së raportimit sipas strategjisë:

Disa nga rezultatet e pritshme nga zbatimi i objektivave specifike nën Objektivin Strategjik II gjatë periudhës raportimit janë:


- Rritje e numrit të akteve ligjore dhe politikave dhe të miratuara për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave
- Numër i konsiderueshëm i profesionisteve dhe profesionistëve të trajnuar dhe aftësuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave sipas protokolleve dhe standardeve që dalin nga aktet ligjore që janë paraparë në strategji. Është evidentuar pjesëmarrje e lartë e përfaqësueseve dhe profesionistëve institucional nga të dy gjinitë.
- Zhvillimi, avancimi i databazës të integruar ndërsektoriale për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në lidhje me rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Gjatë periudhës së raportimit, vërehet ngritje e përgjegjshmërisë dhe prioritizim më e lartë në nivelin institucional në hetimin e rasteve të denoncuara të të gjitha formave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe i ndëshkimit të kryerësve të dhunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Njëherazi, në mënyrë paralele kanë filluar iniciativat konkrete për zhvillimin dhe zbatimin e pilot programeve për rehabilitimin e kryerësve të dhunës, gjë që pritet të ndikojë edhe në zvogëlimin e numrit të kallzimeve penale me kryerës të rritur dhe të mitur në të ardhmen, që është edhe synimi i Objektivit Strategjik 2.

3. Objektivi strategjik #3: Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave.

Në kuadër të Objektivit 3 janë planifikuara 34 aktivitete. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, 18 aktivitete janë zbatuar plotësisht (53%), 13 aktivitete janë zbatuar pjesërisht apo janë në zbatim e sipër (38 %), kurse 3 aktivitete mbeten të pa zbatuara (8.8 %).

Objektivi Strategjik 3: Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave
Zbatimi i aktiviteteve sipas strategjise (2023)



Objektivi strategjike 3 parasheh 5 objektiva specifike, në kuadër të-së cilave progresi më i madh reflektohet tek objektivi specifik III.5 “Përmirësimi i qasjes në drejtësi të viktimave /të mbijetuarave të dhunës”, kurse përqindja më e ulët e zbatimit paraqitet në objektivin specifik III.4 “Hulumtimi, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave ndërinstucionale për evidentimin e rasteve”.

Si histori suksesi gjatë kësaj periudhe të raportimit në kuadër të këtij objektivi janë: rritja gati i dyfishtë e numri i mbajtjes së sesioneve informuese me grupe të ndryshme të grave, të rejave, vajzave, burrave, të rinjve e djemve, mbi rolet gjinore dhe ekzistencën e mekanizmave koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në nivelin lokal, si dhe mbrojtjes, trajtimit e qasjes në drejtësi përmes këtyre mekanizmave, krahasuar me periudhën paraprake të raportimit; Tutje, në të gjitha komunat është realizuar fushata ‘16 ditë aktivizimit’ dhe është punuar në vetëdjesimin e qytetarëve rreth

ndalimit të dhunës në familje dhe dhunës së gruas dhe pasojat e dhunës në familje, seanca informative në shkolla, takime, vizita etj.

Gjithashtu, ka vazhduar implementimi i aktiviteteve me të rinjtë në projektin "Komuna për të rinjtë" në komunat me komunitete të cenueshme. Zbatimi i Raundit të parë të programit të trajnimit dhe subgranteve për të rinjtë në 10 komuna anembanë Kosovës si përfituese të projektit me të cilat MAPL ka nënshkruar marrëveshje për implementim. Rritje e konsiderueshme e pjesë marrjes së vajzave në implementim dhe monitorim të subgranteve në këto komuna krahasuar me meshkuj dhe duke përfshirë të gjitha grupet e cenueshme.

Histori suksesi gjatë kësaj periudhe është edhe hartimi i dokumentin "Manuali 2023" ku janë listuar informata mbi dhunën dhe format e saja, si dhe shërbimet që ofrohen nga institucionet përgjegjëse, duke përfshirë ndihmën juridike falas dhe kompensimin e viktimave të krimit dhe janë përgatitur dhe shpërndarë fletushka informuese mbi format e dhunës, institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimit, numrat e raportimit. Gjithashtu, janë përgatitur fletushka për format e reja të dhunës të parapara me Kod Penal-Ngacmimi Seksual. Me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve në vazhdimësi janë mbajtur takime informuese me akterë të ndryshëm komunal (nga ofruesit e Ndihmës Juridike Falas). Është përgatitur përmbajtja, dizajnimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve për Informimin e viktimave / të mbijetuarave të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, si dhe publikut në tërësi, mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet ku mund të marrin ndihmë, përfshirë ndihmën juridike falas për personat e ekspozuar ndaj dhunës, në një gjuhë që ato/ata e kuptojnë dër të aktivitetit, me qëllim të informimit të drejte mbi shërbimet për rastet e dhunës në familje. Gjithashtu është bërë përgaditja dhe shpërndarja e informacionit në gjuhët zyrtare dhe të përshtatshme për personat me nevoja të veçanta (alfabeti braille, etj), mbi legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet përkatëse ku duhet të adresohen viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Gjatë periudhës së raportimit, është realizuar mbeshtetja financiare e Strehimoreve që ofrojnë Shërbime Strehimi për viktimat e Dhunës në Familje: Me qëllim të qëndrueshmërisë financiare për strehimoret të cilat ofrojnë shërbime strehimi për viktimat e dhunës në familje, Ministria e Drejtësisë ka rritur buxhetin për Strehimoret, nga 1 milion në 1,5. Nga ky buxhet, 10 strehimore në nivel të Kosovës, për herë të parë mbështeten plotësisht për shërbimet e strehimit dhe trajtimit psiko-social të viktimave gjatë qëndrueshmërisë në strehimore

Storie suksesi gjithashtu është edhe ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 gjatë kësaj periudhe të raportimit, meqë rast është finalizuar instrumenti

raportues pas konsultimit me institucionet përgjegjëse që raportojnë në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026). Ky instrument ofron pasqyrë të qartë mbi zbatimin e strategjisë dhe ndihmon Ministrinë e Drejtësisë në monitorimin e saj dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë. Për herë të parë përmes këtij formati mundësohet raportimi i organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare në mbështetje të zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit.

Sa i përket sfidave ndërlidhur me specifikat e kësaj objektive, janë disa nga veprimet që mbesin ende për tu zbatuar e të cilat ndërlidhen me kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe përcaktimin e llojit dhe metodologjisë në mbledhjen dhe analizën e këtyre të dhënave, në përputhje me përkufizimet dhe kërkesat në Konventën e Stambollit), e që pritet të rregullohet me një udhëzues mbi bashkëpunimin ndër-institucional, i cili gjithashtu përfshinë fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse qendrore e lokale për mbledhjen e të dhënave administrative në përputhje me metodologjinë e dakordësuar;

Ndonëse bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qenë evident me mbështetjen nga organet shtetërore qendrore e lokale gjatë kësaj periudhe të raportimit, ky bashkëpunim nevojitet të intensivkohet ende më shumë në të ardhmen dhe të shtrihet tutje në të gjitha komunat.

Njëherit, edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit janë vërejtur sfida dhe vështirësi në planifikimet e duhura buxhetore edhe nga institucionet përkatëse ku adresohen viktimat, të cilat kanë vështirësi në realizimin e aktiviteteve për mbrojtjen e viktimave /të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Progresi ndaj rezultateve të pritshme nga zbatimi i objektivave specifike nën objektivin strategjik III gjatë periudhës raportuese:

- Qeveria e Kosovës ka dedikuar buxhetin e duhur dhe fonde adekuate për fuqizimin e Zyrës së Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje, për të mundësuar koordinim dhe monitorim efikas të veprimeve kundër dhunës; Mbetet që zyra ende të fuqizohet tutje me resurse të mjaftueshme njerëzore për funksionim më efikas
- Është hartuar dhe lansuar udhëzuesi për standardet e funksionimit dhe veprimet të mekanizmave koordinues në nivel lokal kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, në përputhje me qasjen shumë-sektoriale të koordinuar sipas Ligjit të ri në fuqi. Qëllimi i Udhëzuesit është themelimi dhe koordinimi i mekanizmit lokal koordinues, hartimi i procedurave dhe protokolleve duke përfshirë bazën e të dhënave në nivel lokal, avokimi për ndarjen e buxhetit nga vendimmarrja komunale, hartëzimi dhe definimi i referimit për shërbime specifike, si dhe ngritja e kapaciteteve, po ashtu, koordinimin dhe

bashkërendimin e politikave me organizatat e grave dhe të shoqëris civile duke mbështetur gratë në komunitet dhe grupet e marginalizuara

- Është bërë progres në ngritjen dhe funksionalizimin e Mekanizmave Koordinues lokalë për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në disa komuna por nevojitet ende të punohet për të ngritur dhe funksionalizuar këto mekanizmat edhe në komunat tjera të Kosovës. Disa komuna janë mbështetur në zbërthimin e kësaj strategjie nacionale në strategji lokale, përfshirë dhe hartimin i planeve të punës. Tutje mbetet të punohet edhe në sigurimin e burimeve njerëzore e financiare adekuate për të siguruar mbarëvajtje dhe qëndrueshmëri të këtyre mekanizmave në të gjitha komunat e Kosovës.
- Policia e Kosovës është fuqizuar përmes themelimit të drejtorisë së veçantë në polici në nivel qendror dhe njësi nga niveli rajonal dhe lokal për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Njëherazi, është mundësuar edhe mbështetja logjistike për njësitet e trajtimit të rasteve të dhunës në familje duke siguruar transportin për viktimat në qasje për shërbime emergjente qofshin ato mjekësore, paraqitje në gjykatë apo shërbime tjera mbështetëse.

Sfidë mbetet sigurimi i fondeve emergjente (para të imëta) në Policinë e Kosovës dhe Qendrat për Punë Sociale (QPS) me qëllim të plotësimit të nevojave emergjente të viktimave gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje gjatë qëndrimit në stacionet policore dhe QPS.

- Lidhur me të dhënat për menaxhimin dhe koordinimin e rasteve dhe të dhënat administrative për rastet e trajtuara në mënyrë shumë-sektorioale, pritet të hartohet Udhëzimi Administrativ lidhur me udhëzimet detaje, protokolet dhe metodologjinë e mbledhjes dhe përditësimit të informatave nga të gjitha institucionet përgjegjëse në kohë reale për rastet që kërkojnë dhe marrin ndihmë juridike falas dhe mbështetjen profesionale. Ky udhëzim do të kontribuoj në përmirësimin e mënyrës së mbledhjes së të dhënave duke u fokusuar edhe tek tregues që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë drejtim, pritet që në databazë të evidentohen edhe kategorite e raportimeve të viktimave (vajza, gra, djem e burra) të dhunës seksuale, jo vetëm dhunës në familje, sipas kategorive deri në 15 vjete dhe atyre mbi 18 vjet sipas SDG 16.2.3 në përputhje me përkufizimet dhe kërkesat në Konventën e Stambollit; Tutje, sipas këtij udhëzimi do të fuqizohen edhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse qendrore e lokale për mbledhjen e të dhënave administrative në përputhje me metodologjinë e dakordësuar më sipër.

Edhe gjatë kësaj periudhe të zbatimit gjatë vitit 2023 janë bërë shumë përpjekje dhe aktivitete për të përmirësuar qasjen në drejtësi të të gjitha grave dhe vajzave dhe numri i kerkueseve për ndihmë juridike është në rritje e sipër. Çështja e sigurimit të qëndrueshëm të ofrimit të ndihmës juridike falas në mbarë Kosovën mbetet ende sfidë për shkak të mungesës së resurseve të mjaftueshme edhe njerëzore por edhe fondeve të cilat mbulohen nga donatorët kohë pas kohe për vendet të cilat nuk mbulohen përmes zyreve regjionale ekzistuese në Kosovë.

Në kuadër të Objektivit Strategjik III, gjatë periudhës raportuese është bërë progres në funksionalizimin e mekanizmave koordinues në disa komuna, dhe pritet që në të njëjtë mënyrë të avancohet edhe në komunat tjera. Në mënyrë paralele është përmirësuar edhe koordinimi, si ndërmjet këtyre mekanizmave ashtu edhe me shoqërinë civile në tërësi dhe kështu do të vazhdoj tutje edhe në periudhat e ardhme të implementimit të strategjisë.

Në ndërkohë me aprovimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje përgjegjësia e Zyrës së Koordinatorës Nacionale si organi shtetëror që mbikëqyr koordinimin, monitoron zbatimin e Konventës së Stambollit, si dhe që raporton mbi zbatimin e kësaj Konvente në GREVIO. Sipas Ligjit të ri për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Baze gjinore, janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për koordinatorin kombëtar. Po ashtu sipas ligjit në fuqi, është rritë përgjegjësia politike në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Prandaj, në periudhën e ardhshme do të punohet tutje edhe në avancimin e proceseve monitoruese e vlerësuese të institucioneve, si për zbatimin e kësaj strategjie kombëtare, ashtu dhe për politikën publike kundër dhunës, në tërësi.

Gjatë periudhës së raportimit janë shënuar vonesa në kryerje e hulumtimeve kombëtare periodike (çdo 4 vite) mbi fenomenin, përmasat, profilin e dhunuesve dhe perceptimin e qytetarëve dhe qytetarëve ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, gjë që mbetet të realizohet vitin e ardhshëm. Njëherit në të ardhmen mbetet të punohet në krijimin e lehtësirave për punëdhënësit/bizneset të cilët punësojnë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë, përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave gjë që ndërlihet me procesin e masës së cekur më lartë.


Ndërsa në proces të zbatimit është krijuar i databazës për numrin e viktimave/ të mbijetuarave të dhunës të riintegruara e fuqizuara përmes programeve përkatëse, në nivel qendror e lokal, që ka filluar në fund të periudhës së raportimit (2023). Në lidhje me zbatimin e kësaj mase janë përfshirë një sërë mekanizmesh institucional për periudhë gjashtemujore me mundësi vazhdimi edhe në periudhë e ardhshme të raportimit.

4. Objektivi strategjik #4: Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat

Objektivi Strategjik IV përmban 28 aktivitete të parapara në Planin e Veprimit. Gjatë periudhës raportuese, 7 aktivitete janë zbatuar plotësisht (25 %), 14 aktivitete janë në zbatim e sipër (49%) , kurse 7 aktivitete mbeten të pazbatuara (25%).

Për dallim nga objektivat strategjike paraprake, ku shumica e aktiviteteve janë zbatuar apo janë në zbatim e sipër, në këtë pjesë vërehet një realizim dukshëm më i ulët i aktiviteteve të planifikuara nga institucionet relevante.

Në Fig. 6 dhe Fig.6' janë paraqitur rezultatet e zbatueshmërisë së objektivave specifike për vitin 2023 dhe ato të vitit 2022, prej nga vërehet që këtë vit zbatueshmëria është në nivel më të lartë se viti paraprak, por që ka ende ngecje në zbatim krahasuar me objektivat tjera strategjike në periudhën e raportimit.



Nga dy objektivat specifike të parapara, objektivi specifik IV.1 *“Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara për viktimat/ të mbijetuarat nga të gjithë grupet, si dhe fëmijët viktima dhe dëshmitarë të dhunës”* tregon zbatueshmëri më të mirë krahasuar me aktivitetet tjera të këtij objektivi strategjik IV, prej nga 55% të aktiviteteve janë zbatuar plotësisht ose janë në zbatim e sipër (IV.1), krahasuar me objektivin specifik IV.2 , ku vetëm 13% nga aktiviteteve të parapara me objektivin strategjik IV janë në zbatim e sipër.

Megjithatë, disa nga aktivitetet janë zbatuar me sukses gjatë periudhës së raportimit për vitin 2023 duke përfshirë: Caktimi i koordinatorëve dhe gjyqtareve e gjyqtarëve të

profilizuar në gjykata, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në aspektin civil dhe penal; Profilizimi i profesionisteve dhe profesionistëve që ofrojnë shërbime riintegruese për fuqizim të qëndrueshëm të viktimave; 67 zyrtar të profilizuar në 33 komuna; Themelimin e njësitit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në prokuroritë ku paraqiten një numër i madh i rasteve të dhunës në familje). Në të gjitha prokuroritë themelore janë të caktuar koordinatore dhe zëvendës koordinatore të dhunës në familje; është evidentuar rritje e numrit të policeve gra nga 995 në 1024 krahasuar me periudhën e kaluar të raportimit.

Sfidë, në kuadër të kësaj objektive, edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit paraqiten sfida serioze sa i përket planifikimit dhe angazhimit në realizimin e veprimeve (ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe të strehimit për grupe të veçanta si djem dhe burra viktime të dhunës në familje, personat LGBTI+, etj.); mungesës të bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat (Ofrimin e mundësive për punësim të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave); dhe planifikimin buxhetor jo adekuat (mbështetjen financiare të shërbimeve për fëmijët viktime dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës si dhe viktimave të sulmeve seksuale të ofruara nga ana e institucioneve publike ose në OJQ e specializuara).

Sfida (vonesa) janë vërejtur edhe në rekrutimin e OJQ-ve për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve që kontribuojnë në fuqizimin ekonomik dhe mirëqenien e viktimave të dhunës në familje/dhunës ndaj grave në zbatimin e prioriteteve të parapara në Objektivat Strategjike të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 dhe planit të tij të veprimit në këtë objektivë. Edhe pse thirrja është shpallur tri here nga ABGJ, sipas vlerësimit të komisionit për zgjedhës asnjëra nga OJQ-të nuk i ka plotësuar kriteret në bazë të thirrjes publike.

Strehimoret (10) që shërbejnë për të trajtuar rastet e dhunës në familje dhe dhunën ndaj grave, vazhdojnë të sigurojnë qasje të shpejtë në shërbimet e disponueshme për viktimat, dhe shërbejnë si platformë për avokim në mënyrë që të marrin mjete financiare nga komunat përkatëse dhe mbështesin përfshirjen e të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore në programet e banimit social. Por, deri më tani vetëm 21 komuna ofrojnë mbështetje financiare për këto strehimoret dhe mbetet si sfidë për tu përfshirë edhe komunat tjera në kontributin e tyre financiar për të mbështetur viktimat e dhunës.

Sfidë vazhdon të jetë edhe Subvencionimi i pagesave për kopshte të fëmijëve të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave: Nuk ka ende të dhëna të sakta të numrit të fëmijëve përfitues. Deri në periudhën raportuese vetëm 11 komuna subvencionojnë pagesa për kopshte të fëmijëve.

Vonesa në Zhvillimin e planit të banimit social trevjeçar në Komuna dhe planifikimi i banimit social për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (qiratë, ofrimi i banimit). 15 komuna kanë të aprovuar planin trevjeçar, 8 komuna janë në zhvillim e siper, komuna tjera nuk kanë plan të banimit social

Progresi dhe sfidat kundrejt rezultateve të pritshme nga zbatimi i objektivave specifike nën Objektivin Strategjik 4

- Janë ndarë fonde adekuate për OJQ-të për ofrimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat e dhunës, në përputhje me kërkesat/standartet e Konventës së Stambollit; por ka vonesë në përzgjedhjen e disa OJQ-ve që do të ofrojnë ndihmë viktimave në riintegrimin e tyre të qëndrueshëm për shkak të mos plotësimit të kriterëve për përzgjedhje deri në periudhën raportuese
- Mungesë e planeve dhe programeve konkrete për të investuar me prioritet në riintegrimin dhe fuqizimin e qëndrueshëm të të mbijetuarave të dhunës, përmes funksionimit me efikasitet të programeve përkatëse;
- Nuk ka ende ndonjë progres evident rreth përmirësimit të të drejtave pronësore të grave, si një tjetër mundësi që çon në fuqizimin afatgjatë të tyre apo gëzimi dhe sigurimit të ushtrimit në mënyrë të barabartë.

Vërehet zbatimi më i ngadalshëm në funksionalizimin e qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës dhe sfida në mbështetjen me buxhetin e nevojshëm nga qeverisja qendrore e lokale. Po kështu vërehen sfida dhe ngecje në mbështetjen dhe funksionalizimin e programeve riintegruese, të cilat mundësojnë fuqizimin e qëndrueshëm të të mbijetuarave të formave të ndryshme të dhunës.

IV. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME SIPAS STRUKTURAVE ZBATUESE

Sa i përket performancës së institucioneve përgjegjëse, në tabelen 1 është pasqyruar gjendja e zbatimit të aktiviteteve gjatë periudhës raportuese .

| No | Institucioni | Të planifikuara | Të zbatuara plotësisht | Të zbatuara pjesërisht | Të pazbatuara |
|-----------------|--------------|-----------------|------------------------|------------------------|---------------|
| 1 | KN-MD | 50 | 25 | 21 | 4 |
| 2 | PK | 6 | 5 | 1 | 0 |
| 3 | MPB - AP | 6 | 2 | 3 | 1 |
| 4 | MAPL | 5 | 1 | 3 | 1 |
| 5 | MSH | 8 | 6 | 1 | 1 |
| 06 | MASHTI | 9 | 4 | 5 | 0 |
| 7 | ABGJ | 3 | 1 | 0 | 2 |
| 8 | KPM | 7 | 0 | 6 | 1 |
| 9 | KGJK | 8 | 4 | 3 | 1 |
| 10 | KPK | 3 | 2 | 1 | 0 |
| 11 | MINT | 3 | 0 | 0 | 3 |
| 12 | MFPT | 10 | 1 | 5 | 4 |
| 13 | KRK | 1 | 1 | 0 | 0 |
| 14 | AD | 6 | 6 | 0 | 0 |
| 15 | AKSP | 2 | 2 | 0 | 0 |
| 16 | ANJF | 3 | 1 | 2 | 0 |
| 17 | ZMNV | 2 | 2 | 0 | 0 |
| 18 | ZKPSH | 3 | 2 | 1 | 0 |
| Gjithsej | | 135 | 65 | 52 | 18 |

V. KONKLuzionet dhe Rekomandime

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, ka një zbatim dukshëm më të mirë gjatë vitit të dytë krahasuar me atë të vitit të parë, ku rreth 87% të aktiviteteve të përcaktuara për periudhën raportuese janë zbatuar plotësisht apo janë në zbatim e sipër. Nga gjithsej 135 aktivitete, 18 aktivitete (13%) nuk janë zbatuar.

Progresi evident në zbatimin e objektivave strategjike që janë arritur gjatë kësaj periudhe të raportimit:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe fuqizimi i kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, duke pasur parasysh edhe standardet e Konventës së Stambollit;
- Formimi i Drejtorisë në kuadër të Policisë së Kosovës për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje;
- Ndryshimi/plotësimi i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe harmonizimi me Konventën e Stambollit;
- Hartimi i udhëzuesve/protokolleve për standardet e funksionimit dhe veprimet për mekanizmat koordinues në nivel lokal, në përputhje me qasjen shumë-sektoriale të koordinuar;
- Promovimi i modeleve pozitive të "Agjentëve të ndryshimit në komunitet", të cilët sfidojnë stereotipet gjinore, dhe shprehin mos tolerancë ndaj dhunës përmes video promovuese me akter të ndryshëm me qëllim të ndryshimit në komunitet;
- Analizë e plotë e kuadrit ligjor civil dhe penal mbi dhunën ndaj grave, dhunën në familje, si dhe evidentimi i masave që duhet të ndërmerren për ta harmonizuar këtë kuadër ligjor me instrumentet ndërkombëtare, përfshirë CEDAW dhe Konventën e Stambollit;
- Krijimi i moduleve të reja në bazën e integruar të të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje dhe trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave;
- Certifikimi i 15 fasilitatorëve për ofrimin e programit për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Shërbimit Sprovues të Kosovës, Shërbimit Korrektues, Punëtorëve Sociale, Psikologëve Klinik për ofrimin e programit për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave;
- Ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026;
- Fuqizimi i kapaciteteve të zyrtarëve/zyrtarëve të institucioneve përgjegjëse të integruara në databazën kundër dhunës në familje, në evidentimin e rasteve në aplikacion gjatë procesit të regjistrimit;
- Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit në gjuhët zyrtare dhe të përshtatshme për personat me nevoja të veçanta (alfabeti braille, etj), mbi legjislacionin në fuqi,

- mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet përkatëse ku duhet të adresohen viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
- Përfshirja më e lartë e shoqërisë civile dhe partnerëve strategjikë në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë;
 - Rritja e buxhetit për Strehimoret, nga 1 milion në 1,5 milion euro. Nga ky buxhet, 10 strehimore në nivel të Kosovës, për herë të parë mbështeten plotësisht për shërbimet e strehimit dhe trajtimit psiko-social të viktimave gjatë qëndrueshmërisë në strehimore.
 - Trajnime për dhunën në familje dhe procedurat standarde të 150 zyrtarëve policor nga sektori i hetimeve dhe zyrtar policor nga njësit patrulluese si reagues të parë në rastet e dhunës në familje;
 - Janë hetuar 2638 raste të dhunës në familje;
 - Rritja e numrit të policeve gra nga 995 në 1024;
 - Rritja e sesioneve informuese nga 28 në 51 sesione brenda vitit në shkollat fillore dhe të mesme të organizuara nga komunat me grupe të ndryshme të grave, të rejave, vajzave, burrave, të rinjve e djemve, mbi rolet gjinore dhe ekzistencën e mekanizmave koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në nivelin lokal, si dhe mbrojtjes, trajtimit e qasjes në drejtësi përmes këtyre mekanizmave;
 - Janë përpiluar dy udhëzime për trajtim të kryerësve të dhunës dhe trajnimet e profesionistëve shëndetësorë sipas programit të tyre brenda institucionit ku trajtohen kryesisht e dhunës me vendim gjykatë ;
 - Edukimi i bashkëmoshatarëve, vajza dhe djem (peer education) për parandalimin dhe identifikimin e ngacmimit seksual në shkolla, si dhe për të mbajtur qëndrim kritik ndaj portretizimit negativ dhe seksist të imazhit të grave dhe vajzave në fusha të ndryshme të jetës;
 - Caktimi i koordinatorëve dhe gjyqtarëve e gjyqtarëve të profilizuar në gjykata për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në aspektin civil dhe penal;
 - Themelimi i njësitit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në prokuroritë ku paraqiten një numër i madh i rasteve të dhunës në familje;
 - Trajnime të përbashkëta për trajtimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, për punonjëset dhe punonjësit e policisë, prokuroret/prokurorët dhe gjyqtaret/gjyqtarët në detyrë, Avokatët e Viktimave, QPS, MSH, MV, Psikiatria Forenzike, në aspektin penal dhe civil dhe ndikimit të traumës në viktimën;
 - Janë realizuar gjithsej 42004 vizita në shtëpi, për fëmijë 0-3 vjeç, ku në mes tjerash janë identifikuar 1115 raste sociale dhe disa raste (9) të dhunës në familje dhe të raportuara;
 - Është zbatuar Udhëzuesi për Procesimin e Rasteve për Ndihmë Juridike Falas ku u jepet përparësi rasteve të viktimave të dhunës dhe grupeve të marginalizuara dhe për adresimin e çështjeve civile, familjare dhe pasurore juridike.
 - Janë ofruar ndihma juridike falas te 6081 qytetarë, 2890 gra dhe 3191 burra, nga të cilët kanë përfituar edhe Viktimave të Dhunës në Familje gjatë vitit 2023 në lëmit

penale dhe civile. Në lëmin Civile - Familjare, është ofruar ndihma juridike falas për 782 përfitues të ndihmës juridike falas.

- Sipas gjinisë, kanë përfituar 527 gra dhe 255 burra nga të gjitha grupet e marginalizuara dhe etnive. Për ta janë ndërmarrë 1214 veprime juridike.

VI. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Bazuar në gjendjen aktuale të zbatimit të Strategjisë, disa nga rreziqet e identifikuar janë:

- Funkcionalizimi i plotë i Zyrës së Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje me kapacitetet dhe resurset e duhura njerëzore për monitorimin e zbatimit të Strategjisë kundër Dhunës në familje dhe Dhunës ndaj grave;
- Planifikimi jo i duhur i aktiviteteve si dhe mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve që dalin nga strategjia;
- Mungesa e fondit emergjent për nevojat e viktimave gjatë periudhës kur ata/ato paraqiten për ndihmë në polici;
- Mos qartësimi i roleve dhe kompetencave të disa institucioneve për implementimin dhe raportimin e aktiviteteve që dalin nga strategjia sipas Konventës së Stambollit;
- Mungesa e llogaridhënies nga disa institucione përgjegjëse dhe zyrtarët institucional, mos adresim i saktë i aktiviteteve dhe raportimi i mangët kundrejt indikatorëve/treguesëve matës të përcaktuar në strategji dhe sipas standardeve ndërkombëtare për viktimat e dhunës (sipas Konventës së Stambollit);
- Kapacitetet e kufizuara institucionale për të përmirësuar mbledhjen dhe raportimin e të dhënave dhe përdorimin në kohë reale të databazës së krijuar pranë Ministrisë së Drejtësisë me koordinimin e të gjitha institucioneve relevante;
- Mungesa e të dhënave që tregojnë rezultatet e arritura dhe ndikimit i fushatave vetëdijësuese të realizuara tek burrat, djemtë dhe publikut të gjerë kundrejt ndryshimit të përceptimeve, dhe stereotipeve ndaj dhunës në baza gjinore dhe seksuale.
- Mungesa e bashkëpunimit të mirëfilltë ndërmjet Qeverisë, mediave, shoqërisë civile dhe bizneseve private lidhur me veprimet kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave
- Mungesë e programeve mbështetëse të mjaftueshme për riintegrimin ekonomik të viktimave të dhunës dhe sigurimi i banimit të nënave vetushqyese viktimat të dhunës dhe mos mbështetja financiare për fëmijë e tyre në institucione kopshte etj.

Për adresimin e këtyre rreziqeve, institucionet zbatuese të kësaj Strategjie duhet të ndërmarrin sa më parë veprimet e parapara, gjithmonë duke siguruar koordinim të ngushtë me të gjithë akterët.

Lidhur me këto veprime, duhet të ndërmerren hapa në:

- Rishikimi i Planit të Veprimit dhe definimi më i qartë i roleve dhe obligimeve të institucioneve përgjegjëse për implementimin e Strategjisë kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave (2022-2026)

- Planifikimin paraprak dhe me kohë buxhetor, alokimin e fondeve adekuate si dhe krijimin e linjave buxhetore për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve sipas dinamikës së Planit të Veprimit të Strategjisë;
- Ngritjen e kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin lidhur me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave e njëkohësisht veprimeve të ndërmarra, apo vonesave në ndërmarrjen e këtyre veprimeve;
- Raportimi më i strukturuar dhe i saktë i të dhënave nga institucionet relevante rreth viktimave të dhunës sipas tregueseve të përcaktuar në strategji (Konventës së Stambollit) dhe standardeve ndërkombëtare;
- Të përforcohet dhe fuqizohet edhe më tutje niveli i monitorimit të zbatimit të aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse për zbatim të strategjisë dhe kërkohet llogaridhënia dhe transparenca e raportimit të rasteve të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe masave mbrojtëse dhe ofrimin e shërbimeve që janë ndërmarrë apo jo ndaj tyre;
- Në raportimet e ardhshme, institucionet duhet të fokusohen më shumë në raportimin e aktiviteteve të tyre (rezultatet) me fokus kryesor te viktimat e dhunës dhe grave e vajzave që kërkojnë ndihme dhe mbështetje nga institucionet relevant nga rastet e kërcënimeve dhe për parandalimin e dhunës së ushtruar ndaj tyre, si dhe ato që kërkojnë mbështetje në realizimin e të drejtave të tyre, jo vetëm në hapjen e procedurave por edhe deri tek realizimi final i të drejtave të tyre në mbrojtje ndaj dhunës;
- Bashkëpunimin e mirëfilltë me partnerët strategjikë, shoqërinë civile, mediat dhe bizneset private lidhur me veprimet e parapara sipas strategjisë dhe Konventës së Stambollit

Gjatë periudhë raportuese është vërejtë që roli, kompetencat dhe obligimet i disa institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë kanë pësuar ndryshime nga ato që fillimisht janë paraparë me strategji, si rrjedhojë disa nga aktivitetet kanë mbetë të pazbatuara deri më tani. Prandaj, nevojitet të bëhet rishikim i dokumentit të strategjisë dhe Planit të Veprimit, dhe të përcaktohen më saktë rolet dhe obligimet e disa institucioneve relevante që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të parapara në periudhën e radhës së raportimit dhe përtej.

SHTOJCA 1

Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit për vitin 2023

| Aktivitet i zbatuar plotësisht | Aktivitet i zbatuar pjesërisht | I pazbatuar |
|--------------------------------|--------------------------------|-------------|
| | | |

| Nr. | Objektivat dhe veprimet | Afati i fundit | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente | Progresi në zbatim |
|--------|---|---|---|---|---|---|---|
| I. | Objektivi strategjik: | Parandalimi dhe identifikimi i dhunës | | | | | |
| I.1 | Objektivi specifik: | Ndryshimi i sjelljeve qëndrimeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që justifikojnë dhunën. | | | | | |
| I.1.1. | Zhvillimi i një analize për të kuptuar perceptimin e përgjithshëm mbi dhunën | 2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MD / Zyra e Koordinatorës | Raporti me të gjeturat dhe rekomandime | Raporti i MICS-it Agjencioni i Statistikave të Kosovës. | Agjencia e Statistikave të Kosovës në bashkëpunim me EUROSTAT, kanë përfunduar hulumtimin mbi perceptimin e përgjithshëm të dhunës, Ky hulumtim ka përfunduar në qershor të vitit 2023 dhe të dhënat e këtij hulumtimi janë pronësuar në data bazën e Agjencisë së Statistikave. Hulumtimi në fjalë nuk e ka bazën e analizës dhe për këtë janë zhvilluar takime në mes të Agjencisë dhe UNFPA për angazhimin e eksperteve në përgatitjen e analizës. Deri me tash, nuk kemi ndonjë informate se kur përfundon procesi i nxjerrjes së analizës së këtij hulumtimi. Ky raport analitik nuk ka përfunduar as në vitin 2023 si pasoje e mungesës së buxhetit nga ana e Agjencisë së Statistikave. -Në dhjetor të vitit 2023, duke e konsideruar tejet të rëndësishëm perceptimin e burrave dhe grave mbi dhunën dhe të gjitha format e saja, në bashkëpunim me Ambasaden Britaneze është iniciuar hulumtimi mbi perceptimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Ky hulumtim ka për qëllim nxjerrjen e analizës dhe ndërtimin e politikave në fushën e parandalimit dhe identifikimit të dhunës në familje dhe formave të tjera. Ky hulumtim ka filluar në Janar 2024 dhe përfundon në qershor 2024. Në lidhje me këtë, është zhvilluar pyetësori dhe aktualisht është në fazën e zhvillimit të fokus grupeve. Nga hulumtimin do të drejtohet fushata e përditshme në nivel vendi me moton "SOT DHE CDO DITË TJETËR" |
| I.1.2 | Promovimi i modeleve pozitive të "Agjentëve të ndryshimit në komunitet", të cilët sfidojnë stereotipet gjinore, dhe shprehin mostolerancë ndaj dhunës | 2022-2024 (Në vazhdi mësi) | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ Zyra e Koordinatorës, ABGJ, të gjitha Ministrinë dhe Partnerët Strategjikë, Institucionet e të drejtave të njeriut, Organizatat e shoqërisë civile. | Videomesazhe e postera të personave të dashur për publikun që shërbejnë si modele pozitive dhe nxitje për të mos e pranuar dhe mos e toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 7, 12, 12/5 dhe 13, kapitulli IV, nenet 18, 19, kapitulli V, neni 42) | Promovimi i modeleve pozitive të agjentëve të ndryshimit në komunitet është zhvilluar përmes 7 video mesazheve profesionale dhe 25 videomesazheve jo profesionale. Adresimi i videomesazheve kishte për qëllim sensibilizimin e opinionit për mos tolerancë ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Të njëjtat video mesazhe janë shpërndarë në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, rrjetet sociale dhe televizion, ndërsa 25 videomesazhet jo profesionale janë shpërndarë nga artistët, sportistët, aktivistët të të drejtave të grave, personale me ndikim në komunitet, politikanë, ministra, zv.ministra etj. Zhvillimi i këtij aktiviteti është bërë në bazë të planit të Ministres së |

| | | | | | | | |
|-------|---|----------------------------|--|---|---|--|---|
| | | | | | | | Drejtësisë. Aktiviteti në fjalë ka filluar në muajin Korrik të vitit 2022, me vazhdimësi për vitin 2023. Po ashtu, përveç videomesazheve, janë shpërndarë fletëpalosje për raportimin e dhunës në familje, Ligjin për Ndihmë Juridike Falas si dhe Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimin. Të gjitha video mesazhet janë shpërndarë përmes faqes zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në rrjetet sociale (facebook, instagram dhe twitter) të Ministrisë, po ashtu akterë të ndryshëm video mesazhet i kanë shpërndarë në rrjetet e tyre sociale (facebook dhe instagram). |
| I.1.3 | Sesione informuese dhe mobilizim i liderëve në komunitete si partnerë e bashkëpunëtorë në veprimet kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave | 2022-2024 (Në vazhdi mësi) | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ Zyra e Koordinatorës, Bashkësitë fetare, ABGJ, të gjitha ministrinë dhe partnerët zhvillimorë, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ, institucionet ndërkombëtare | Më shumë liderë në komunitet të informuar, mbi rëndësinë e qëndrimit të tyre kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet liderëve të komuniteteve fetare dhe të tjerë dhe Zyrës së Koordinatorës Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, mbi veprime të përbashkëta kundër të gjitha formave të dhunës | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13) | Në kuadër të aktivitetit të planifikuar, janë zhvilluar takime-sesione informuese me kryetarë të pesë komunave, (Prishtinë, Shtimje, Ferizaj ,Gjilan dhe Dragash). Qëllimi i këtyre takimeve është informimi mbi rëndësinë e thirrjes dhe veprimeve të tyre si kryetarë komunash në adresimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave si dhe mobilizimi në komunitet me qëllim të informimit (bashkësi lokale, komunitetit fetar, OJQ, shkolla etj). Në të gjitha takimet është potencuar roli i Mekanizmit Koordinues Lokal kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj gra Në kuadër të adresimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në kuadër të sesioneve informuese, janë organizuar 6 takime me komunitetin fetar (Bashkësia Islame e Kosoves, Kisha Katolike, Kisha Protestante dhe Komuniteti Hebre ne Kosove. Në kuader te fushate se 16 Diteve te Aktivizmit, jane organizuar 2 takime me gra e burra te komunitetit fetar (me gra dhe vajza ne Bashkesine Islame dhe me gra e burra te komunitetit katolik) - Me datë 30 nëntor 2023, bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2023, nën objektivat strategjike për parandalim të dhunës, Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Bashkësitë Fetare, (Bashkësia Islame, Kisha Katolike dhe Kisha Protestante) përmes së cilave |

| | | | | | | | |
|--------|--|----------------------|--|---|--|--|--|
| | | | | | | | janë pajtuar për realizimin e sesioneve informuese kundër dhunës për komunitetin fetar, dhe mobilizimin e liderëve në komunitet, si partner e bashkëpunëtorë në veprimet kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. ve dhe vajzave. |
| I.1.4. | Aktivite vetëdijësuese të përmuajshme mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave me fokus të veçantë në grupet e cënueshme të grave dhe vajzave | 2022-2024 (çdo muaj) | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ Zyra e Koordinatorës, ABGJ, të gjitha Ministrisë dhe Partnerët Strategjikë, Institucionet e të drejtave të njeriut, Organizatat e shoqërisë civile. | Të paktën 12 aktivitete vetëdijësuese të realizuara çdo vit Më shumë gra dhe vajza nga grupe të cënueshme të informuara mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13) | Gjate muajve Janar-Dhjetor, janë mbajtur katër takime me grupet e cënueshme të grave dhe vajzave. Janë takuar gra dhe vajza në Komunen e Dragashit, Prizrenit, Pejës dhe Fushe Kosovës, Gjakovës dhe Kamenicë, si dhe me gra refugjate nga Ukraina. Adresimi gjatë takimeve ka qenë dhuna në familje dhe martesat e hershme. Po ashtu në kuadër të aktivitetit, MD ka adresuar çështjen e martesave të hershme, ndërsa më datë 13 dhjetor 2023, me propozim të Ministres së Drejtësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka themeluar Grupin Ndërinstitucional lidhur me parandalimin e martesave të hershme në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Çështja e martesave nën moshën 18 vjeçare është trajtuar edhe me draftin e Kodit Civil dhe themelimi i këtij grupi do të ndihmojë në vetëdijësimin e shoqërisë për pasojat e martesave të hershme dhe parandalimin e tyre. Aktivitetet e ndërmarra në përmbyllje të kësaj mase: 1. Vizitë strehimoreve në Pejë dhe Mitrovicë me grupet e grave të marginalizuara. Në këto takime është diskutuar rëndësia e raportimit të dhunës, si dhe kërkesa për adresimin e shërbimeve që lidhen me dhunën në familje, po ashtu ndihma juridike falas dhe kompensimi i viktimave (prill dhe maj 2023). 2. Vizitë tek shoqata e nënave vetëushqyese dhe kujdestare në familje (mars 2023). 3. Përrurimi i strehimoreve në Gjilan (mars 2023). 4. Është krijuar dhoma e vizitave për familjaret në burgun e grave në Lipjan. 5. Është organizuar tryezë me shoqërinë civile, |

| | | | | | | | |
|--------|---|-----------|-------------------------------|--|--|--|---|
| | | | | | | | Komisionin për të Drejtat e Njeriut, MD-në, etj. Tema e trajtuar ka qenë "Veprimet e ndërmarra në adresimin e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore". |
| I.1.5. | Fushata/aktivitete vetëdijesuese të vazhdueshme nga Policia e Kosovës | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Policia e Kosovës, Institucionet përgjegjëse lokale, organizatat e shoqërisë civile. | Të paktën tre aktivitete vetëdijesuese të realizuara çdo vit | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13) | <p>Gjate muajve Janar-Dhjetor, janë mbajtur katër takime me grupet e cënueshme të grave dhe vajzave. Janë takuar gra dhe vajza në Komunën e Dragashit, Prizrenit, Pejes dhe Fushe Kosovës, Gjakovës dhe Kamenicë, si dhe me gra refugjate nga Ukraina. Adresimi gjatë takimeve ka qenë dhuna në familje dhe martesat e hershme. Po ashtu në kuadër të aktivitetit, MD ka adresuar çështjen e martesave të hershme, ndërsa me datë 13 dhjetor 2023, me propozim të Ministres së Drejtësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka themeluar Grupin Ndërinstitucional lidhur me parandalimin e martesave të hershme në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Çështja e martesave nën moshën 18 vjeçare është trajtuar edhe me draftin e Kodit Civil dhe themelimi i këtij grupi do të ndihmojë në vetëdijësimin e shoqërisë për pasojat e martesave të hershme dhe parandalimin e tyre. Aktivitetet e ndërmarra në përmbyllje të kësaj mase:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vizitë strehimoreve në Pejë dhe Mitrovicë me grupet e grave të marginalizuara. Në këto takime është diskutuar rëndësia e raportimit të dhunës, si dhe kërkesa për adresimin e shërbimeve që lidhen me dhunën në familje, po ashtu ndihma juridike falas dhe kompensimi i viktimave (prill dhe maj 2023). 2. Vizitë tek shoqata e nënave vetëushqyese dhe kujdestare në familje (mars 2023). 3. Përrurimi i strehimores në Gjilan (mars 2023). 4. Është krijuar dhoma e vizitave për familjaret në burgun e grave në Lipjan. 5. Është organizuar tryezë me shoqërinë civile, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, MD-në, etj. Tema e trajtuar ka qenë "Veprimet e ndërmarra në |

| | | | | | | | |
|-------|---|----------------------------|--|---|--|---|--|
| | | | | | | | adresimin e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore". |
| I.1.6 | Edukimi dhe promovimi i modeleve pozitive të djemve dhe burrave si "Agjentëve të ndryshimit në komunitet", të cilët sfidojnë stereotipet gjinore, nuk e tolerojnë dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, si dhe nuk pranojnë "kodet e nderit dhe turpit", që nxitin veprime të dhunshme, deri në fatalitet. | 2022-2024 (Në vazhdi mësi) | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ Zyra e Koordinatorës, ABGJ, të gjitha Ministrisë dhe Partnerët Strategjikë, Institucionet e të drejtave të njeriut, Organizatat e shoqërisë civile. | Videomesazhe e postera të personave të dashur për publikun që shërbejnë si modele pozitive dhe nxitje për të mos e pranuar dhe mos e toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Më shumë burra dhe djem aleatë të grave dhe vajzave në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 7, 12, 12/5 dhe 13, kapitulli IV, nenet 18, 19, kapitulli V, neni 42) | Në kuadër të adresimit të dhunës në familje, janë prodhuar dhe promovuar 4 video mesazhe me teme: Dhuna virtuale, raportimi, ngacmimi seksual dhe lansimi i aplikacionit "afer teje" |
| I.1.7 | Fushata e përvitshme e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje (25 nëntor - 10 dhjetor) | 2022-2024 (1 herë në vit) | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ Zyra e Koordinatorës ABGJ, të gjitha ministrisë dhe partnerët zhvillimorë, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ. | 1 Fushatë ndërgjegjësimi e koordinuar ndërmjet institucioneve, partnerëve e OJQ-ve, me kohëzgjatje 16 ditore, e realizuar çdo vit. Bashkërendimi i mesazheve dhe aktiviteteve për të maksimizuar ndikimin. | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13) | "16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore" është një fushatë globale e iniciuar në vitin 1991 nga Qendra për Leadership Global të Grave. Kjo fushatë vjetore fillon më 25 nëntor - në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe zgjat deri më 10 dhjetor - në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Fushata është lansuar me synimin për të tërhequr vëmendjen dhe për të mobilizuar veprime kundër një prej shkeljeve më të përhapura dhe më të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në botë - dhunës me bazë gjinore. Me kalimin e viteve, fushata është rritur për t'u bërë një platformë e fuqishme për ndërgjegjësimin dhe avokimin për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Fushata bashkon individë, organizata dhe qeveri në një përpjekje kolektive për të sfiduar dhe ndryshuar status quo-në. Ministria e Drejtësisë edhe këtë vit për herë të dytë ka organizuar mbi 80 aktivitete të cilat kanë adresuar çështjen komplekse dhe fenomenin e të gjitha formave të dhunës me bazë |

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|---|
| | | | | | | <p>gjinore në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë fushatës kemi bashkëpunuar me ministritë e linjës, zyrën e Presidentes, partneret tanë institucional, strategjikë, si dhe agjencitë ndërkombëtare. Për t'i bërë jehonë mesazhit që të gjithë duhet të punojmë së bashku për të parandaluar dhe për t'i dhënë fund të gjitha formave të dhunës ndaj vajzave dhe grave, ndërtuam synimet e qarta duke i orientuar në tri objektiva kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shtrirjen në tërë territorin e Republikës së Kosovës; • Shpërndarjen e mesazhit në secilën shtëpi; • Përfshirjen e të gjitha grup-moshave dhe të gjitha komuniteteve <p>-Për realizimin e objektivës Nr. 2 “Shpërndarja e mesazhit në secilën shtëpi”, bashkëpunimi me ndërmarrjet publike ka qenë i domosdoshëm. Përmes bashkëpunimit me ndërmarrjet publike sllogani i fushatës “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR” bashkë me mesazhet tona kundër dhunës dhe thirrjet për raportim, janë vendosur në faturat e energjisë elektrike, faturat e TERMOKOS dhe në faturat e të gjitha kompanive të ujësjellësve të komunave të Kosovës, KRU Prishtina, KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Hidrodrini, KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni, KRU Mitrovica. Përmes këtyre faturave, mesazhi ka arritur në secilën shtëpi në Republikën e Kosovës. Përmes bashkëpunimit me Telekomin e Kosovës VALA, në ditën e hapjes së fushatës, mesazhi nga Ministria e Drejtësisë: “Ministria e Drejtësisë ka ashpërsuar dënimet për veprat penale të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Mos dhuno! Raporto 192!” është dërguar tek të gjithë përdoruesit e VALA, pra tek mbi 800.000 përdorues.</p> <p>-Përmes filmave dhe shfaqjeve teatrale që trajtojnë pozitën dhe rolin e gruas në shoqëri, kemi synuar që nëpër komuna të ngjallim interesim dhe diskutim rreth temave të ndryshme. Prandaj në bashkëpunim me Qendrën Kinematografike të Kosovës, kemi organizuar shfaqjen e filmave në Komunën e Podujevës dhe Shtimes, të cilët kanë trajtuar fenomenin e dhunës</p> |
|--|--|--|--|--|--|---|

| | | | | | | | |
|---------|--|-----------|--|---|--|--|--|
| | | | | | | | ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe trafikimin dhe dhunën seksuale ndaj vajzave. Pas shfaqjes së filmave, bashkë me përfaqësues nga QKK dhe aktorë, regjisorë apo producent të filmave kemi zhvilluar bashkëbisedime me publikun prezent, duke prekur kështu tema të rëndësishme të cilat shpeshherë refuzohet të diskutohen. <ul style="list-style-type: none"> • Filmi “ Vozitësi” Komuna Podujevë • Filmi “ Salloni” Komuna Shtime • Filmi “ Një muaj” Komuna Shtime |
| I.1.8. | Pilotimi i programeve/kurseve të këshillimit paramartesor, ku ofrohet informacion i detyrueshëm mbi legjislaconin në fuqi për mbrojtjen e familjes nga dhuna, të drejtat martesore e pronësore, etj. | 2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MAPL Komuna/ Zyrat e Gjendjes Civile, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ, | Të reja e të rinj që vendosin të krijojnë familje, janë të informuar mbi ligjin në mbrojtje të familjes dhe format e ndryshme të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV) | I pazbatuar, në pritje të planit |
| I.1.9. | Vlerësimi i efikasitetit të programeve/ kurseve të pilotuara të këshillimit paramartesor, dhe krijimi i udhëzuesit për shtrirjen e tyre në mbarë Kosovën | 2024-2025 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MAPL Komuna/ Zyrat e Gjendjes Civile, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ | Raporti i përgatitur mbi vlerësimin e efikasitetit të programeve/qendrave të tilla me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Udhëzuesi i përpiluar për shtrirjen e këtyre programeve/kurseve në mbarë vendin, bazuar mbi këtë vlerësim. | Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV) | I pazbatuar, në pritje të planit. |
| I.1.10. | Shtimi i programit të këshillimit për prindërimin pozitiv pranë qendrave të shërbimeve shëndetësore për gratë dhe familjen, | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MSH/ Këshillimoret apo Konsultaret e nënave dhe fëmijëve, MFPT/ QPS, | Moduli mbi prindërimin pozitiv i zhvilluar dhe i gatshëm për t'u aplikuar me | Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV) | Gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2023 në qendrat e shërbimeve shëndetësore është punuar me programin për këshillim prindërim pozitiv për gratë dhe familjen. Moduli prindërim pozitiv i zhvilluar me profesionist shëndetësor të trajnuar në bazë të moduleve në 29 Qendra te mjeksive |

| | | | | | | | |
|---------|---|-----------|--|--|--|--|---|
| | ose pranë qendrave për punë sociale | | | MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, Komunitat, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ, institucionet ndërkombëtare | prindër (nëna e baballarë) Profesioniste e profesionistë të trajnuar për ta aplikuar këtë modul | Kodi i Familjes | familjare në region ku gjithësejt numri i personave të këshilluar mbi prindërim pozitiv është 2568 vizita dhe këshilla për prindërim pozitiv për grat dhe familjen; Msh në bshkëpunim me OJQ Medika Gjakovën janë mbajtur trajime dhe për shërbimet shëndetësore dhe kujdesit shëndetësor ndaj stresit dhe traumës për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe dhunës seksuale me temën: kualifikimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor, Institucionalizmi i shërbimeve shëndetësore të ndijshme ndaj stresit dhe traumës; Rrjetëzimi ndërkombëtar dhe avokimi; Në fazën e parë janë trajnuar 100 profesionist shëndetësor, 50 nga Prizreni, 50 nga Gjakova; Në fazën e dytë janë trajnuar 140 profesionist shëndetësor, 50 Mitrovicë, 50 Pejë, 20 Istog dhe 20 Klinë. Përfutjes të trajnimit ishin edhe profesionistët shëndetësor: mejkë të përgjithshëm, gjinekolog, infermier, psikolog, dhe mami të institucioneve shëndetësore publike. Në fazën tjetër të trajnimit janë trajnuar gjithësej 16 profesionistë shëndetësor, 8 Prizren, 8 Gjakovë. Në fazën e dytë janë trajnuar: 20 Mitrovicë, 8 Pejë, 2 Istog, 2 Klinë. Numri i trajnerëve të trajnuar në bazë të gjinisë: Gjakovë 8 trajner -7 prej tyre gra, dhe 1 burrë; Prizren gjithësej 8 gjashtë gra dhe dy burra: Mitrovicë gjithësej 8 shtatë gra dhe një burrë; Pejë gjithësej 8, katër gra dhe katër burra: Istog gjithësej 2, një grua dhe një burrë; Klina gjithësej 2, dy gra dhe zero burra. Në total 36 pjesëmarrës prof. shëndëteora në trajnim për trajner; Edhe në fazën e dytë janë trajnuar njëjtë 36 pjesëmarrës në trajnim për trajner. |
| I.1.11. | Vlerësimi i efikasitetit të programit të këshillimit për prindërimin pozitiv pranë qendrave të shërbimeve shëndetësore për grat dhe familjen, ose pranë qendrave për punë sociale dhe përgatitja e udhëzuesit | 2025-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | Ministria e Shëndetësisë/ Këshillimoret apo Konsultaret e nënave dhe fëmijëve, MFPT/ QPS, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, | Raporti i përgatitur mbi vlerësimin e efikasitetit të programeve të tilla me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. | Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV) | Në pritje sipas planit Ky aktivitet është planifikuar të fillojë në vitin 2025. |

| | | | | | | | |
|-------------|---|--|---|--|--|--|---|
| | për përhapjen e tyre në mbarë Kosovën. | | | Komunat, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ, institucionet ndërkombëtare | | | |
| I.1.12 | Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve për parandalimin e martesave të hershme | 2022 T4-2024 | Nuk ka nevojë për llogaritje të kostove shtesë ⁴ | MASHTI, DKA, QPS, OJQ | 2 fushata të realizuara në vit | Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024 (aktiviteti II.1.14) | MASHTI ka hartuar pakon e moduleve tematike për mbrojtjen e fëmijës në kontekst të shkollës. Moduli 11 është për parandalim të martesave të hershme. 100 kopje iu kanë shpërndarë shkollave të mesme të larta rreth 20 komunave. Kemi organizuar edhe sesione informuese me prindër të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptjan në komunën e Gjakovës. Një fushatë është realizuar në komunën e Gjakovës |
| I.2. | Objektivi specifik | Ndërmarrja e masave edukative dhe arsimore në të gjitha nivelet për të parandaluar dhunën | | | | | |
| I.2.1. | Hulumtim gjithëpërfshirës mbi aspektet e parandalimit të dhunës në familje nëpërmjet arsimit para universitar dhe universitar | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI | MASHTI Institutet Partnerët | Raporti me rekomandime | Kurrikulat bërthamë të arsimit parauniversitar/ programet lëndore Kurrikulat universitare/ silabuset lëndore Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15) | Eshtë realizuar hulumtimi gjithëpërfshirës mbi aspektet e parandalimit të dhunës në familje nëpërmjet arsimit parauniversitar dhe universitar nga Instituti Pedagogjik dhe MASHTI. Në muajin prill 2024 do të prezantohet dhe do t'i marrim rekomandimet para pjesëmarrësve, MASHTI, MD, mësimdhënësve. Hulumtimi është realizuar në vitin 2023. Tash në këtë vit realizohet lansimi. Nuk ka vonesë! |
| I.2.2. | Sesione informuese mbi dhunën me zyrtarë/zyrtarë të drejtorive komunale të arsimit, drejtorë/drejtorë shkollash, psikologe/psikologë shkollorë dhe njësi akademike. | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI | MASHTI, DKA shkollat, Njësitë akademike Qendra universitare për të drejtat e njeriut, partnerë të tjerë. | Më shumë zyrtarë /zyrtarë të drejtorive komunale të arsimit, drejtorë/drejtorë shkollash, psikologe/psikologë shkollorë të informuar mbi dhunën në familje | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15) | 968 shkollave iu është dërguar rekomandimi nga MASHTI që të realizojnë aktivitete ekstrakurrikulare gjatë "16 Ditëve të Aktivizmit". MASHTI ka organizuar 9 sesione informuese me mësimdhënës dhe 3 prej tyre janë mbajtur edhe me nxënës ku është diskutuar edhe për dhunën digjitale që është mbështetur nga Këshilli i Evropës me një eksperte të kësaj fushe. Nxënës të përfshirë kanë qenë 234 nxënës, 28 mësimdhënës, 8 psikologë |

⁴ Ky aktivitet është planifikuar në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024 dhe bëhet fjalë pikërisht për aktivitetin II.1.14 të këtij dokumenti. Për sa kohë që kosto për këtë aktivitet është llogaritur në dokumentin e referencës, nuk ka nevojë të përllogaritet edhe kosto shtesë në këtë Strategji. Llogaritjet për kosto shtesë të bëhen vetëm nëse mungon kosto për vitin 2024 në dokumentin e referencës.

| | | | | | | | |
|-------|---|-----------|---|------------------|--|---|---|
| | | | | | e dhunën ndaj grave dhe rolin e tyre | |). |
| I.2.3 | Adresimi dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dalta nga hulumtimi gjithëpërfshirës | 2023-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI | MASHTI | Programe mësimore dhe materiale shtesë që ndikojnë në parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. | Politikat arsimore parauniversitare dhe universitare | Hartimi I 12 moduleve tematike për mbrojtjen e fëmijës në kontekst të shkollës është realizuar në vitin 2023. Në të përfshihen: 1. Parandalimi dhe referimi I dhunës në shkolla, 2. Parandalimi I braktisjes së shkollës, 3. Mbrojtja e fëmijëve në internet, 4. Parandalimi i diksriminimit në shkolla, 5. Promovimi i barazisë gjinore, 6. Parandalimi i gjuhës së urrejtjes, 7. Parandalimi i dhunës në familje, 8. Parandalimi i trafikimit të fëmijëve, 9. Parandalimi i ngacmimeve seksuale, 10. Parandalimi i martesave të herëshme, 11. Parandalimi i punës së fëmijëve, 12. Programi i iniciativës së të rinjëve-Yrinia. Gjatë vitit 2023 është hartuar "Politika për mbrojtjen e fëmijëve në institucionet parauniversitar" https://masht.rks-gov.net/politika-per-mbrojtjen-e-femijeve-ne-institucionelet-e-arsimit-parauniversitar/ https://masht.rks-gov.net/module-tematike-permbrojtjen-e-femijes/ |
| I.2.4 | Përgatitja e një udhëzuesi për stafin e institucioneve të arsimit parauniversitar në lidhje me shenjat identifikuese të predispozitave të dhunës në familje të fëmijët në shkolla, me qëllim parandalimi dhe referimi në instancat përgjegjëse. | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI | MASHTI | Udhëzuesi i përgatitur në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15) | Ky udhëzues do të hartohet në 6 mujin e parë të vitit 2024. është themeluar grupi hartues nga MASHTI dhe ekspertët e angazhuar nga Këshilli I Evropës |
| I.2.5 | Përgatitja dhe zhvillimi i një programi trajnimi për koordinatorë/koordinatore të cilësisë dhe psikologe/psikologë shkollorë mbi parandalimin, identifikimin, trajtimin dhe referimin e incidenteve të ngacmimit | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI | MASHTI Partnerët | 2 sesione për pjesëmarrës nga 10 komuna në vit/ gjithsej 30 komuna për 3 vite Më shumë koordinatorë /koordinatorë të cilësisë dhe | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15) | Janë mbajtur sesione informuese në shtatë regjione me koordinatorë të cilësisë përgjatë fushatës një mujore kundër dhunës me qëllim të parandalimit dhe rritjes së efikasitetit të raportimit të dhunës. Këto sesione janë mbajtur në Prishtinë, Ferizaj, Gjiilan, Prizren, Mitrovicë. Normalisht së është rritur sepse kjo vazhdueshëm po realizohet prej vitit në vit. Në 2024 priten të përfshihen edhe komunat tjera, ç'ka janë edhe duke u realizuar për momentin |

| | | | | | | | |
|--------|---|------------|--|---|--|--|---|
| | seksual në shkollë, si dhe të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, në instancat përgjegjëse | | | | psikologe/psikologë shkollorë të informuar dhe të gatshëm të parandalojnë, identifikojnë, trajtojnë e referojnë incidentet e ngacmimit seksual në shkollë dhe të formave të tjera të dhunës në instancat përgjegjëse | | |
| I.2.6 | Hulumtim gjithëpërfshirës lidhur me angazhimin e psikologeve në shkollë dhe identifikimi i nevojave për secilin insitucion. | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MASHTI | Raporti i hulumtimit i realizuar dhe u publikuar së bashku me rekomandimet e ofruara. | Legjislacioni mbi arsimin Konventa e Stambollit (kapitulli III neni 14) | Hulumtimi nuk është realizuar. Por në bazë të grandit specifik të qeverisë buxheti iu është ndarë secilës komunë për punësimin e secilës shkolle me psikolog duke u bazuar në numrin e nxënësve brenda shkolles dhe komunat janë duke I punësuar. Argumentet për këtë mund t'i shihni në vitin 2017/2018 kanë qenë 79 psikolog, në vitin 2018/2019 janë 84 psikologë/pedagog, në vitin 2019/2020 janë 99 psikolog/pedagog, në vitin 2020/2021 janë 109 psikolog/pedagog. Ndrësa gjatë këtyre dy viteve për 20% është rritur numri përshkak obligimeve që kanë marrë komunat për punësim të psikologëve dhe pedagogëve |
| I.2.7. | Zhvillimi dhe shpërndarja e një informatori për rolin e sektorit të arsimit në zbatimin e Konventës së Stambollit | Tetor 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MASHTI, OSBE Këshilli i Evropës | Informatori i finalizuar dhe i shpërndarë në të gjitha institucionet arsimore në Kosovë Një botim i ri që detajon kërkesat e nenit 14 të Konventës së Stambollit pritet të jetë gati deri në vitin 2022, me mbështetjen e KiE | Konventa e Stambollit (neni 14) Kushtetuta e Republikës së Kosovës | Eshtë hartuar Informatori për staf shkollor rreth zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje e njohur si Konventa e Stambollit. Eshtë shpërndarë rreth 300 kopje në 8 DKA. Ky informatorë është hatuar dhe publikuar gjatë vitit 2023 |
| I.2.8. | Sesione informuese me Këshillat e prindërve (nëna dhe baballarë) dhe | 2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MASHTI, Institucionet e Arsimit Parauniversitar | Sesione informuese të organizuara rregullisht në | | Ky aktivitet pritet të realizohet në vitet në vijim për shkak të procedurave të konsolidimit të Këshillit të Prindërve. Ky aktivitet nuk mund të |

| | | | | | | | |
|------------|--|---|-------------------------------|---|--|---|---|
| | nxënëseve e nxënësve lidhur me barazinë e vajzave dhe djemve dhe pasojat e dhunës në familje | | | | mënyrë të përvishme Më shumë prindër (nëna dhe baballarë) si dhe më shumë nxënëse e nxënës të informuar mbi barazinë e vajzave dhe djemve dhe pasojat e dhunës në familje | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13, 14) | realizohet pa konsolidim të Këshillit të Prindërve. Presim në këtë vit dhe vitet në vazhdim të organizojmë sesione me ta. |
| I.2.9. | Edukimi i bashkëmoshatarëve, vajza dhe djem (peer education) për parandalimin dhe identifikimin e ngacmimit seksual në shkollë, si dhe për të mbajtur qëndrim kritik ndaj portretizimit negativ dhe seksist të imazhit të grave dhe vajzave në fusha të ndryshme të jetës. | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MASHITL, Institucionet e Arsimit Parauniversitar | Programet e edukimit të vajzave dhe djemve për parandalimin dhe identifikimin e ngacmimit seksual në shkollë, si dhe për të luftuar portretizimin negativ dhe seksist të grave dhe vajzave, të organizuara në mënyrë të përvitshme. Duke ofruar trajnim për DKA. | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13, 14) | Në vitin 2023 bashkë me OSBE kemi mbajtur 3 punëtori/ sesione Informuese me nxënës dhe mësuesdhënës të komunës së Gjakovës, Prishtinës dhe Gjilanit për edukim të fëmijëve dhe parandalim të ngacmimeve seksuale brenda bashkëmoshatarëve. Në vitet paraqark janë mbajtur edhe në komunën e Ferizajt, Gjakovës dhe Prizren. Në vitin 2024 presim t'i organizojmë edhe në komunat tjera |
| I.3 | Objektivi strategjik | Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, medias dhe sektorit privat për promovimin e masave për të parandaluar dhe luftuar dhunën | | | | | |
| I.3.1 | Inkurajimi i mediave për të vendosur udhëzime dhe standarde vetë-rregulluese për të rritur respektin për dinjitetin e grave, në mënyrë që të ndihmojnë në ndërtimin e roleve pozitive gjinore dhe të parandalojnë dhunën kundër grave. | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPM, ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, OJQ | Mediat inkurajohen dhe mbështeten të vendosin dhe aplikojnë udhëzime dhe standarde vetë-rregulluese që shmangin diskriminimin dhe dhunën ndaj grave. | Konventa e Stambollit (kapitulli III neni 17) | Fillimisht si njoftim paraprak: për shkak të mos funksionimit të KPM-së për më shumë se 8 muaj, prej tetor 2022 deri qershor 2024, nga mos emërimi i anëtarëve nga Kuvendi, shumë aktivitete janë shtyrë ose kanë mbetur pa u zbatuar gjatë 2023. Sa i përket inkurajimit, është çështje që zakonisht e bëjmë përmes takimeve publike me mediat, konferencave, letrave të hapura apo kërkesave me shkrim për çështje specifike, e që nuk mund të përfshihen teknikisht të gjitha ato komunikime në raport. Një shembull edhe pse nuk lidhet me çështjet e raportimit gjinor, KPM u ka bërë thirrje |

| | | | | | | | |
|-------|--|-----------|-------------------------------|---|--|--|---|
| | | | | | | <p>mediave për raportim të saktë dhe të paanshëm për situatën në veri të Kosovës gjatë sulmit terrorist me 24 shtator 2024 https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3617 dhe kjo është zbatuar plotësisht nga ana e mediave.</p> <p>KPM në kuadër të mandatit dhe kompetencave ligjore, ka monitoruar mediat në zbatimin e obligimeve ligjore -Ligjit dhe rregulloreve të KPM-së, duke përfshirë Kodin e Etikës e që ndërlidhet me aktivitetin në fjalë. Nga rezultatet e raporteve të monitorimit, nuk janë gjetuar shkelje nga ana e mediave lidhur me raportimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Pra jashtë këtyre aktivitetve të raportuara, nuk ka dicka shtesë për tu raportuar e që lidhet me aktivitetet e kësaj strategjie.</p> <p>a me qëllim të zbatimit efikas të Kodit të Etikës, respektivisht evitimit të përmbajtjeve që promovojnë gjuhë të urrejtjes, gjuhë vulgare dhe ofenduese, si dhe nxisin ose promovojnë cilëndo nga format e diskriminimit dhe jo tolerancës, me theks të veçantë ndaj grave, si gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta ku edhe ekziston mundësia e keqpërdorimit të hapësirës mediale nga të ftuarit në emisione por edhe në përmbatjet tjera programore.</p> | |
| I.3.2 | Edukimi i profesionistëve dhe profesionistëve të medias për të trajtuar me më shumë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm çështjet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPM, ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Fakulteti i gazetarisë, Unioni i Gazetarëve, MD/ZK OJQ | Më shumë profesioniste dhe profesionistë të medias vizive e të shkruar, të cilat/cilët trajtojnë me përgjegjshmëri dhe i kushtojnë vëmendjen e duhur dhunës në familje e dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17) | <p>Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), me 22 maj 2023 ka pritur në takim pune një grup gazetarësh të rinj nga Kosova, në kuadër të një vizite studimore të organizuar nga OSBE-ja, si pjesë e edicionit të 5të të programit të përvitshëm për gazetarë të rinj, ku pjesëmarrësit vizitojnë institucione dhe organizata me interes dhe shohin drejtpërsëdrejti rregullimin dhe funksionimin e mediave.</p> <p>Takimi ishte si vazhdimësi e disa takimeve tjera të këtij formati dhe bashkëpunimit të KPM-së me gazetarët e rinj dhe me studentët e gazetarisë, me qëllim të promovimit të standardeve etike të gazetarisë, rritjes së cilësisë së raportimit në media. https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3571</p> <p>Katër student të gazetarisë në Universitetin e Prishtinës kanë përfunduar punën praktike në KPM</p> |

| | | | | | | | |
|-------|---|-----------|-------------------------------|---|---|--|---|
| | | | | | | | <p>Në kuadër të bashkëpunimit në mes të KPM-së me Departamentin e Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës (UP), OSBE-së dhe Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), gjatë muajve prill - qershor 2023, ka vazhduar faza e tretë e punës praktike në KPM, për studentë të gazetarisë të përzgjedhur nga Departamenti i Gazetarisë. Angazhimi i studentëve për të kryer punë praktike në KPM kishte për qëllim hulumtimin dhe analizimin e përmbajtjeve programore sa i përket monitorimit të reklamave. Puna praktike ka qenë e planifikuar dhe është realizuar në monitorimin e mediave lidhur me përmbajtjet e caktuara programore - reklama, me temë “ Keqprezantimi gjinor në reklama”. https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3577</p> |
| I.3.3 | Promovimi dhe nxitja e rritjes së numrit të grave profesioniste të medias (gazetare, drejtuese, analiste, etj.) si dhe aftësimi i tyre për qasje, përgatitje e menaxhim të informacionit mediatik nëpërmjet teknologjisë. | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPM ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Fakulteti i Gazetarisë, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, OJQ | Më shumë profesioniste gra në fushën mediatike Gratë në media të aftësuara për të përdorur teknologjinë në menaxhimin e informacionit mediatik | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17) | <p>Punëtorja me temën “Monitorimi i raportimit të mediave për gratë në rajonin e Prizrenit” Komisioni i Pavarur i Mediave në bashkëpunim me OSBE, më 19 tetor 2023, ka organizuar në një punëtori një ditore me temën “Monitorimi i raportimit të mediave për gratë në rajonin e Prizrenit”.</p> <p>Pjesëmarrës ishin përfaqësues të disa OJQ-ve nga rajoni i Prizrenit, që fushëveprim kanë çështjet e barazisë gjinore, të cilët gjatë punëtorisë patën rastin të njihen nga afër me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të rregullatorit të mediave audiovizuale në Kosovë.</p> <p>Sa i përket peizazhit dhe monitorimit medial, u prezantua organizimi dhe roli i KPM-së, aktivitetet, monitorimi dhe metodologjia e punës. Sa i përket ambientit medial, u prezantuan rregullat dhe procedurat e licencimit: përmes konkursit publik dhe përmes procedurës me anë të kërkesës (pa frekuencë tokësore), numri i të licencuarve, kategoritë e licencimit, gjuhët e transmetimit dhe shtrirjen gjeografike të mediave, transparencën e punës së KPM-së, ku të gjitha mbledhjet, vendimet dhe aktivitetet tjera janë publike. https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3620 Ligjëratë e KPM në Universitetin “Ukshin Hoti”</p> |

⁵ https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3532?fbclid=IwAR21iS8_DF6c1yOvi9vZ58ULJenEiNJ692KPsqJXVErDYgr575dKC6FAA2M

| | | | | | | | |
|-------|--|-----------|-------------------------------|--|--|--|--|
| | | | | | | | <p>Kryetari i Komisionit të Pavarur të Mediave z.Jeton Mehmeti me 13 nëntor 2023 ka mbajtur një ligjëratë në Universitetin “Ukshin Hoti” me temën “Pasojat ekonomiko-sociale të dezinformimit”.</p> <p>Në ligjëratën e tij ai foli për pasojat ekonomike dhe sociale që lajmet e rreme mund të kenë në një shoqëri, duke potencuar nevojën për rritjen e njohurive individuale rreth edukimit medial si dhe bashkëpunimin me institucionet kompetente në parandalimin e përhapjes së dezinformatave.</p> <p>https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3624 Ligjëratë e KPM në Universitetin AAB https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3628</p> |
| I.3.4 | Nxitja e përdorimit të gjuhës jo-seksiste dhe shmangia e reklamave, apo materialeve audiovizive e të shkruara me përmbajtje seksiste dhe qëndrime favorizuese ndaj dhunës e diskriminimit, në institucionet mediatike publike e private | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPM, ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Fakulteti i Gazetarisë, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, OJQ | Emisionet televizive, spotet, reklamat dhe shkrimet në mediat publike e private përdorin gjuhë jo-seksiste, jo-diskriminuese e jo-tolerante ndaj dhunës ndaj grave e dhunës në familje | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17) | KPM gjatë periudhës raportuese nuk ka pranuar ankesa për përdorim të gjuhës seksiste. Ndërsa ka monitoruar mediat për përdorimin e gjuhës seksiste, në kuadër të raportit "Keqreprezentimi gjinor në reklama" (prill-maj 2023). dhe ndërkombëtar. |
| I.3.5 | Përgatitja dhe zbatimi i politikave të qarta dhe mekanizmave funksionalë të ankesave që ndalojnë materialet diskriminuese, me përmbajtje seksiste, apo që favorizojnë dhunën në familje dhe efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose zakonore, në median audiovizive e të shkruar | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPM, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, OJQ | Mekanizmi i ankesave dhe politikat kufizuese të qarta dhe aplikueshme në median publike e private | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17) | Memorandumi i Bashkëpunimi në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Fondacioni Terre des hommes Laussane në Kosovë Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Fondacioni Terre des hommes Laussane në Kosovë (TdHK), kanë nënshkruar ME 15 dhjetor një Memorandum Bashkëpunimi. Sipas këtij memorandumi palët zotohen të ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok për implementimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në media. Në këtë drejtim memorandumi ka për qëllim që të licencuarit e KPM-së të ndër marrin masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mental dhe moral të tyre, në veçanti programet më përmbajtje të papërshtatshme ose dhunë ekstreme. Objektivet tjetër i memorandumit është të promovojnë në |

| | | | | | | | |
|-------|---|-----------|-------------------------------|---|--|--|--|
| | | | | | | | media temat që adresojnë mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtat e komuniteteve, drejtësinë për të mitur si dhe iniciativa të ngjashme. Ndër aktivitetet që parashihen janë organizimet e përbashkëta si: fushata vetëdijesuese, trajnime, sesione informuese, tryeza diskutimi, konferenca dhe takime për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio dhe audiovizuale. |
| I.3.6 | Bashkëpunimi me mediat dhe kompanitë e informacionit e teknologjisë për të shmangur dhunën, ngacmimin seksual apo përndjekjen e grave dhe vajzave nëpërmjet medias sociale e internetit | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, Mediat, Kompanitë ICT, Unioni i Gazetarëve, ABGJ, OJQ | Vajzat dhe gratë janë më të sigurta dhe mbrohen nga format e dhunës që mund të pësojnë gjatë përdorimit të internetit dhe mediave sociale | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17, kapitulli IV dhe V) | I pazbatuar. |
| I.3.7 | Zhvillimi dhe mirëmbajtja e faqeve të ndryshme të internetit, për të siguruar informacion për fëmijët dhe prindërit për përdorimin e sigurt të internetit, mediave sociale dhe komunikimeve elektronike | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | ABGJ, Mediat, Kompanitë ICT, Institucionet e Arsimit Parauniversitar MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, OJQ | Fëmijët dhe prindërit më të aftësuar për të lundruar të sigurt në internet Faqe të caktuara të nevojshme për përdorim nga fëmijët dhe prindërit, të pajisura me kode të sigurisë dhe filtra kontrolli Një manual për shmangien e dhunës dhe lundrimin e sigurt në internet e mediat sociale, i përgatitur dhe në dispozicion të prindërve dhe fëmijëve | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17, kapitulli IV dhe V) | I pazbatuar. |

| | | | | | | | |
|-------|--|-----------|-------------------------------|---|---|--|---|
| I.3.8 | Inkurajimi i mediave të raportojnë në mënyrën e duhur dhe analizojnë dhunën në familje e dhunën ndaj grave duke reaguuar me profesionalizëm dhe duke respektuar parimet e etikës dhe mbrojtjes së të dhënave personale | 2023-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPM ABGJ Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatores Nacionale, ABGJ, OJQ | Një manual mbi raportimin dhe analizën e dhunës në familje e dhunës ndaj grave nga mediat audiovizive e të shkruara, i përgatitur dhe në dispozicion të profesionisteve e profesionistëve për zbatim Media e përfshirë aktivisht dhe pozitivisht në raportimin dhe vetëdijesimin mbi dhunën në familje e dhunën ndaj grave | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17) | KPM ka punuar një sport vetëdijesues/informues lidhur me raportimin e drejtë nga ana e mediave dhe respektimin e legjislacionit si dhe inkurajimin e ankesave të qytetarëve tek KPM. Linku: https://fb.watch/qdPcCSqxl/ Sa i përket inkurajimit të mediave që të raportojnë në një mënyrë të caktuar, pavarësisht çështjes për të cilën raportohet, KPM përmes Kodit Etik, paraprakisht ka përcaktuar standarte me të cilat inkurajohen dhe obligohet mediat të jenë profesionale në atë çka transmetojnë tek publiku. |
| I.3.9 | Hetimi i rasteve të mundshme të sulmeve ndaj gazetarëve, të dhunës familjare dhe krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, si dhe rastet që cenojnë të drejtat e personave LGBTI+, me prioritet | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KGJK KPK AD Policia e Kosovës OJQ Institucionet mediatike | Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve, të dhunës familjare dhe krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, si dhe rastet që cenojnë të drejtat e personave LGBTI+, janë hetuar dhe shqyrtuar me urgjencë Numri i vendimeve të shqiptuara nga gjykatat | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17) | VEPRAT PENALE DHUNË NË FAMILJE PËR KRYESIT MADHOR 2023 Numri i rasteve të pazgjidhura në fillim -1344 raste , me 1488 persona; Numri i rasteve të reja- 2833 raste ,me 3397 persona; Numri i rasteve në punë - 4167 raste ,me 4885 persona; Numri i rasteve të zgjidhura -3069 raste, me 3450 persona; Numri i rasteve të pazgjidhura në fund -1098 raste , me 1435 persona. Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga ana e prokurorisë për persona: Për 345 persona është hedhur kallëzimi penal; Për 1478 persona është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë; Për 24 persona është vendosur për aktakuzë për dhënien e urdhrin ndëshkimor; Për 137 persona është pushuar hetimi; Për 1270 persona është ngritur aktakuzë pas procedurës hetimore; Për 72 persona është shqiptuar masa për trajtim të detyrueshëm; Për 124 persona cedim në kompetencë; |

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | <p>Vendimet e gjykatave për personat për të cilët ka vendime :</p> <p>1483 persona me vendim te gjykatës janë shpallur fajtorë;</p> <p>18 persona , me vendim te gjykatës janë liruar;</p> <p>21 persona është refuzuar aktakuza;</p> <p>160 Masat e trajtimit të detyrueshëm;</p> <p>9 Aktvendimet e Gjykatës për shkak të parashkrimit.</p> <p>VEPRAT PENALE KUNDËR LGBT</p> <p>Numri i rasteve te pazgjidhura ne fillim -0 raste, me 0 persona;</p> <p>Numri i rasteve të reja- 1 raste ,me 2 persona;</p> <p>Numri i rasteve në punë -1 raste ,me 2 persona;</p> <p>Numri i rasteve të zgjidhura -1 raste, me 2 persona;</p> <p>Numri i rasteve te pazgjidhura ne fund -0 raste , me 0 persona.</p> <p>Mënyra e zgjidhjes se rasteve nga ana e prokurorisë për persona:</p> <p>Për 2 persona është ngritur aktakuzë pas procedurës hetimore ;</p> <p>Nxitje e urrejtjes , mos durimit kombëtarë dhe fetar ...neni 147</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i rasteve te pazgjidhura ne fillim -18 raste , me 64 persona ; • Numri i rasteve te pranuar te reja -12 raste , me 17 persona ; • Gjithsej ne punë -30 raste , me 81 persona ; • Numri i rasteve te zgjidhura - 4 raste , me 6 persona ; • Numri i rasteve te pazgjidhura ne fund -26 raste , me 75 persona ; <p>Mënyra e zgjidhjes ;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për 5 persona –Aktakuzë pas procedurës hetimore ; • Për 1 person –është hedhur aktakuza ; <p>Vendimet e gjykatave për personat për të cilët ka vendime ;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për 2 persona –Aktgjykim fajësues; <p>Veprat Penale sulmet dhe kërcënimet ndaj Gazetarëve :</p> <p>Numri i rasteve te pazgjidhura ne fillim 10 raste ,</p> |
|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | | |
|--------|--|-----------|--|---|--|---|--|
| | | | | | | | <p>14 me persona ; Numri I rasteve ne punë -19 raste me 24 persona ; Numri I rasteve te pranuar - 9 raste me 10persona ; Numri I rasteve te zgjidhura - 11 raste me 11 persona ; Numri I rasteve te pazgjidhura -8 raste me 13 persona; Mënyra e zgjidhjes se rasteve nga ana e prokurorisë për persona; Për 1 person - aktakuzë për dhënien e urdhrin ndëshkimor; Për 4 persona - është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë ; Për 6 persona - aktakuzë pas procedurës hetimore . Vendimet e gjykatave për personat për te cilët ka vendime; 3 persona - me vendim te gjykatës janë shpallur fajtorë ;</p> |
| I.3.10 | Angazhimi i sektorit privat në parandalimin e dhunës duke siguruar shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë grave dhe burrave punonjëse/punonjës të këtij sektori, si dhe duke krijuar kushte të punës që parandalojnë ngacmimet seksuale, përndjekjet dhe dhunën. | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | Ministria e Ekonomisë dhe Financave Sektori privat MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale ABGJ OJQ | Kompanitë private nxiten dhe mbështeten të krijojnë protokolle ose udhëzime për të parandaluar dhunën, ngacmimin seksual dhe përndjekjen në vendin e punës | Konventa e Stambollit (kapitulli III neni 17) Konventa C190 e ILO "Eliminimi i dhunës dhe ngacmimeve në botën e punës" | Aktivitet i pazbatuar. |
| I.3.11 | Inkurajimi dhe mbështetja e sektorit privat për të shmangur përdorimin e përmbajtjes seksiste, të dhunshme dhe të dëmshme në dizajnimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe në marketingun e tyre | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | Ministria e Ekonomisë dhe Financave Sektori privat MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale ABGJ OJQ | Biznesi privat i angazhuar në zhvillimin e standardeve etike në dizajnimin dhe marketingun e mallrave dhe shërbimeve | Konventa e Stambollit (kapitulli III neni 17) | Aktivitet i pazbatuar. |

| | | | | | | | |
|------------|---|---|--|---|--|---|---|
| I.3.12 | Vendosja e stimujve inkurajues si dhe monitorimi e vlerësimi i nismave ⁶ të ndërmarra nga sektori privat për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | Ministria e Ekonomisë dhe Financave Sektori privat MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale ABGJ OJQ | Sektori privat nxitet të ndërmarrë veprime kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave Ekziston një mekanizëm monitorues dhe vlerësues i këtyre nismave, në bazë të të cilit përcaktohet dhe niveli i stimulimit të bizneseve private në këtë drejtim | Konventa e Stambollit (kapitulli III neni 17) | Aktiviteti i pazbatuar. |
| I.4 | Objektivi specifik: | Krijimi dhe zbatimi i programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës | | | | | |
| I.4.1 | Zhvillimi i një analize për të kuptuar shkaqet e dhunës në familje me në qendër kryesin | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD MSH | Masat ndëshkimore për ndryshimin sjelljes së dhunshme për kryerësit e varur nga akooli dhe substancat dehëse, të parapara dhe përcaktuara edhe në ndryshimet e ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje | Konventa e Stambollit (kapitulli II, neni 11, kapitulli III, neni 16) | Në bashkëpunim me Keshillin e Evropës, është zhvilluar analiza për të kuptuar shkaqet e dhunës në familje me në qendër kryesin. Kjo analize I ka parapri procesit të ofrimit të programit për kryerësit e dhunës ndaj grave. Përmes kësaj analize janë zhvilluar module praktike të programit për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave. Po ashtu, gjatë hartimit të plotësimit ndryshimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me baze Gjinore, kjo analize ka shty përpara amandamentimin e nenit perkates sa i perket programit për trajtimin e vartësve të substancave narokitike dhe alkoolit si kryerës të dhunës ndaj grave. Aktualisht jemi në fazën e draftimit të udhezimit administrativ për këtë fushë |
| I.4.2 | Vlerësim për të kuptuar masat e shqiptuara për kryerësit e varur nga akooli dhe substancat dehëse | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD MSH | Vlerësim i situatës dhe rekomandim mbi masat ndëshkimore për ndryshimin sjelljes | Konventa e Stambollit (kapitulli II, neni 11, kapitulli III, neni 16) | Ky aktivitet është bartë për vitin 2023 për arsye të mungesës së planifikimit buxhetor. Aktiviteti I planifikuar pritet të zhvillohet në dy periudha gjatë vitit 2023. |

⁶ Sigurimi i informacionit dhe trajnimi mbi dhunën në familje e dhunën ndaj grave për punonjëset dhe punonjësit e sektorit privat; informimi i stafit mbikëqyrës dhe përgatitja e tyre për të identifikuar dhe referuar në mënyrën e duhur rastet e dhunës që mund të ndeshen tek punonjëset dhe punonjësit e tyre; marrja e masave dhe krijimi i lehtësirave lidhur me nënat e reja, gratë e divorcuara, punonjëset dhe punonjësit që kanë qenë subjekt i dhunës, etj., janë disa nga nismat që mund të ndërmerren nga sektori privat në këtë drejtim.

| | | | | | | | |
|--------|---|-----------|--|---------------------------------------|---|--|--|
| | | | | | së dhunshme për kryerësit e varur nga akooli dhe substancat dehëse | | Ky aktivitet është i ndërlidhur me aktivitetin 1.41 që ka të bëjë me nxjerrjen e Udhezimit Administrativ që del nga Ligji I ri për mbrojtje nga dhuna në familje. |
| I.4.3. | Identifikimi i nevojave për trajtimin e kryerësve të veprave të dhunës në familje e dhunës ndaj grave dhe vlerësim i programeve për këtë qëllim | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD, MFPT, MSH, Instituti i Forenzikës | Raporti i vlerësimit i përgatitur me nevojat e evidentuara dhe sugjerimet për llojet e programeve që mund të ngrihen. | Konventa e Stambollit (kapitulli III, neni 16) | Kurikulat e zhvilluara dhe Sipas Ligjit të ri për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Baze gjinore, programet që ndërlidhen me kryerësit e Dhunës ndaj Grave do të adresohen përmes Udhezimit Administrativ. |
| I.4.4. | Zhvillimi i një pakoje të moduleve për programet e trajtimit psiko-social të kryerësve të dhunës | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MSH, MFPT, MD, | Paketa burimore me modulet e programeve të trajtimit psiko-social e përgatitur | Konventa e Stambollit (kapitulli III, neni 16) | Është zhvilluar Pakoja burimore me modulet e programeve të trajtimit psiko-social e zhvilluar |
| I.4.5. | Trajnimi i personelit të programeve të trajtimit psiko-social të kryerësve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, dhe autorët e krimeve seksuale | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MSH MD Institucionet e pavarura OJQ | Personeli i programeve të trajtimit psiko-social të kryerësve të dhunës, i trajnuar dhe aftësuar. | Konventa e Stambollit (kapitulli III, neni 16) | Janë trajnuar 80 gra dhe 60 burra të personelit shëndetësor nga të gjitha qendrat që ofrojnë trajtime psiko-sociale, me nga dy ditë dhe janë certifikuar nga Oda e Mjekëve. |
| I.4.6. | Vënia në funksionim e programeve të trajtimit të rasteve psiko-social të kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe programeve për autorët e krimeve seksuale | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MSH, MFPT, MD, | Programet e trajtimit të kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, funksionale dhe me profesionistë të | Konventa e Stambollit (kapitulli III, neni 16) | Dy udhëzime për trajtim të kryerësve të dhunës dhe trajimet e profesionistëve shëndetësor bëhen sipas programit të tyre brenda institucionit ku trajtohen kryerësit e dhunës me vendim gjykatë. |

| | | | | | | | |
|--------|--|-----------|--|------------------------|--|--|--|
| | | | | | trajnuar për këtë qëllim, | | |
| I.4.7. | Trajtimi dhe risocializimi i kryerësve të dhunës gjatë kryerjes së dënimit | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MSH MD Partnerët | Kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave edukohen të përdorin sjellje jo-të dhunshme dhe trajtohen që gjatë kryerjes së dënimit | Konventa e Stambollit (kapitulli III, neni 16) | Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës ka ofruar shërbime sipas protokoleve ekzistuese dhe ka trajtuar të gjitha rastet me prioritet sipas Urdhëresave dhe kërkesave të parashtruara nga gjykata dhe prokurorët në IPFK, ku dhe bëhet risocializimi dhe riintegrimi në bazë të protokoleve të brendshme. Protokole dhe programet e veçanta për trajtimin e kryerësve të varur nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor, janë të miratuara. Profesionistët të trajnuar për të trajtuar personat me varësi nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor, edhe kryerësve të dhunës në familje, në përputhje edhe me grupmoshën e tyre janë trajtuar brenda institucioneve. Protokollet dhe programet e veçanta trajtimin e kryerësve të varur nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor, janë miratuar. Kemi dy Udhëzime për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje ku sipas këtyre udhëzimeve trajtohen në tri nivelet e kujdesit shëndetësor. Në IPFK janë trajtuar viktimat e dhunës në familje dhe kryerës të dhunës për vitin 2023 në bazë gjinore: 157 raste të gjinisë mashkullore kryerës të dhunës në familje dhe përdorues të substancave narkotike me Vendim Gjykata, ndërsa 18 janë të gjinisë femrore si kryerës të dhunës në familje. Kemi 6 të gjinië mashkullore që janë në trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, ndërsa 2 të gjinisë femrore po ashtu janë në trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Ezaminime hospitalore janë 145 ku prej tyre burra janë 127 dhe gra 18. Në mungesë të vendeve të lira për hospitalizim kanë qenë 40 raste të cilat janë dërguar në parabuqim. Viktimat e dhunës në familje që janë ekzaminuar për ekspertizë për gjendjen psikologjike të dëmtuar gra janë 7 raste, burra 1 rast, dhunë në familje si dhe 4 raste gra si pasojë e dhunës seksuale. |
| I.4.8. | Matja e frekuencës së rasteve recidiviste duke i ndarë të dhënat nëse kryerësit recidivistë janë | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MD | Frekuenca e rasteve recidiviste të dhunës në familje e dhunës | Konventa e Stambollit | Programi për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave është në proces e sipër. Aktualisht janë duke u trajtuar 12 burra kryerës të dhunës ndaj |

| | | | | | | | |
|---------|--|-----------|--|--|--|---|--|
| | trajtuar gjatë kryerjes së dënimit, apo më pas në programet psiko-sociale të dizenuara për ta | | Donatorët | | ndaj grave ulet, si pasojë e trajtimit psiko-social të kryerësve gjatë dhe pas dënimit | (kapitulli III, neni 16) | grave.Raporti I matjes se frekuences eshte ne proces. |
| I.4.9 | Fuqizimi i kapaciteteve të Shërbimit Sprovues të Kosovës për përcjelljen e rehabilitimit të kryerësve të dhunës | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD | Shërbimit Sprovues i Kosovës i fuqizuar me staf të trajnuar për përcjelljen e rehabilitimit të kryerësve të dhunës | Konventa e Stambollit (kapitulli III, neni 16) | Lidhur me këtë aktivitet është realizuar një trajnim intenziv dy javor për trajner për zbatimin e "Programit të Trajtimit Psikosocial" për punën me kryesit e dhunës në familje" i mbështetur nga projekti i Keshillit të Evropës. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë nëntë (9) zyrtarë sprovues (4 burra dhe 5 gra) nga secila drejtori rajonale të cilët bëjnë mbikëqyrjen e dënimeve alternative, ku pjesë e këtij dënimi është edhe vepra penale për dhunën në familje. Ky aktivitet është i ndërlidhur me Programin për Trajtimin e Kryesve të Dhunës në Familje. 2 nga Strehimorja Prishtinë, 2 nga Shtëpia e Sigurt në Gjakovë, 4 punëtor shëndetësor, 3 mjekë dhe 1 infermiere dhe 6 aktiviste. |
| I.4.10. | Krijimi i një baze të të dhënave për kryerësit që kanë marrë shërbime/ trajtim psiko-social gjatë dhe pas kryerjes së dënimit, si dhe për autorët e krimeve seksuale dhe përditësimi i tyre në vazhdimësi. | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MFPT, MD Partnerët, MSH, UP | Të dhëna të mbledhura, të ndara e përditësuara rregullisht | Konventa e Stambollit (kapitulli II, neni 11, kapitulli III, neni 16) | Databaza për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje, është zhvilluar në kuadër të databazës aktuale për evidentimin e rasteve të dhunës në familje me mbështetjen e UNDP, ndërsa lansimi i tij është bërë me 08.12.2023 nga Ministria e Drejtësisë. Kjo data baze eshte nje modul i ri i zhvilluar krahas zhvillimit te programit per trajtimin e kryerësve te dhunes ndaj grave. Aktualisht programi i trajtimit eshte ne proces te zbatimit dhe ne te njejten kohe eshte duke u zhvilluar edhe procesi i monitorimit. |
| I.4.11 | Përgatitja e raportit vjetor mbi rehabilitimin e kryerësve të dhunës | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MFPT, MD Partnerët | Raportet vjetore të publikuara rregullisht | Konventa e Stambollit (kapitulli II, neni 11, kapitulli III, neni 16) | Programi per trajtimin e kryerësve te dhunes ndaj grave eshte ne proces e sipër. Aktualisht jane duke u trajtuar 12 burra kryeres te dhunes ndaj grave.Sipas planeve, ky program planifikohet te permbyllet si projekt pilot ne qershor te vitit 2024. |
| I.4.12. | Rritja e numrit të shtretërve, përgatitja e protokollit të veçantë dhe trajnimi i profesionisteve | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MSH, Instituti i Psikiatrisë Forenzike | Protokollet dhe programet e veçanta për | | Protokollet dhe programet e veçanta për trajtimin e kryerësve të varur nga substancat, apo me probleme të shëndetit mendor, janë të miratuara. Profesionistet e trajnuar për të trajtuar personat |

| | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | /profesionistëve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike për kryerësit që janë persona të sëmurë psikikë dhe të varur nga alkooli e droga ⁷ | | | <p>trajtimin e kryerësve të varur nga substancat, apo me probleme të shëndetit mendor, të miratuara.</p> <p>Profesionistet dhe profesionistët e trajnuar për të trajtuar personat me varësi nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor, njëherazi edhe kryerës të dhunës, në përputhje edhe me grupmoshën e tyre.</p> <p>Zvogëlimi i rasteve të dërgimit në paraburgim të të pandehurve për shkak të mungesës së shtretërve</p> | | <p>me varësi nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor, njëherazi edhe kryerës të dhunës, në përputhje edhe me grupmoshën e tyre janë të trajnuar brenda institucioneve.</p> <p>Zvogëlimi i rasteve të dërgimit në paraburgim të të pandehurve për shkak të mungesës së shtretërve, nuk ka shtretër të mjaftueshëm.</p> <p>Protokollet dhe programet e veçanta për trajtimin e kryerësve të varur nga substancat, apo me probleme të shëndetit mendor, janë të miratuara.</p> <p>Kemi dy Udhëzime për trajtimin e Kryerësve të dhunës në familje ku sipas këtyre udhëzimeve trajtohen në tri nivelet e kujdesit shëndetësor.</p> <p>Profesionistët e trajnuar për të trajtuar personat me varësi nga substancat apo me probleme të shëndetit mendor, njëherazi edhe kryerës të dhunës, në përputhje edhe me grupmoshën e tyre janë të trajnuar brenda institucioneve të sëmuarit psikik.</p> <p>Ulja e rasteve të dërgimit në paraburgim të të pandehurve për shkak të mungesës së shtretërve janë të limituara, nuk ka shtretër të mjaftueshëm.</p> <p>Në Qëndrat e Shëndetit Mendor në regjion janë trajtuar viktimat të dhunës në familje në Ferizaj janë trajtuar 4 raste të dhunës në familje; në Mitrovicë janë trajtuar me Vendim Gjykate 10 gra dhe raste të dhunës në familje 5 gra dhe 10 burra; Në Gjakovë në QSHM janë trajtuar 30 raste të dhunës në familje me vendim gjykate ku kanë pasur të shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në Liri. Në kuadër të këtij procesi janë realizuar 111 seanca psiko-sociale terapeutike.</p> <p>QSHM - Prizren, gjatë vitit 2023 ka trajtuar me vendim gjykate 21 raste të dhunës në familje prej tyre 5 gra dhe 16 burra.</p> |
|--|--|--|--|---|--|--|

| | | |
|-----|-----------------------|--|
| II. | Objektivi strategjik: | Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare. |
| II. | Objektivi strategjik: | Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare. |

⁷ Të cilët duhet të trajtohen me protokolle e programe të veçanta në përputhje me moshën e tyre dhe faktin që veç varësisë apo problemeve të shëndetit mendor, janë kryerës të dhunës në familje e dhunës ndaj grave.

| II.1 | Objektivi specifik: | Përmirësimi i kornizës ligjore për trajtimin e të gjitha rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. | | | | | |
|--------|--|--|--|-------------------------------------|---|--|---|
| II.1.1 | Ndryshim/plotësimi i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe harmonizimi me Konventën e Stambollit dhe zhvillimi i vlerësimit ex post për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Kuvend MD/KN ZKM ABGJ | Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, i ndryshuar, harmonizuar me Konventën e Stambollit, i miratuar dhe i vlerësuar | Konventa e Stambollit (kapitulli V) | Ligji I miratuar nga Kuvendi I Kosoves |
| II.1.2 | Analizë e plotë e kuadrit ligjor civil dhe penal mbi dhunën ndaj grave, dhunën në familje ⁸ , si dhe evidentimi i masave që duhet të ndërmerren për ta harmonizuar këtë kuadër ligjor me instrumentat ndërkombëtarë, përfshirë CEDAW dhe Konventën e Stambollit | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD, ABGJ OJQ e specializuara | Raporti i analizës me gjetjet dhe rekomandimet, si dhe me sugjerimet për ndërhyrjet në kuadrin ligjor civil e penal, i përfunduar | Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave Konventa e Stambollit, etj. | Raporti i vlerësimit të përafritit të ligjeve, politikave dhe masave me Konventën e Stambollit, [GREVIO] ka filluar në korrik 2021. Ky raport analitik ka zgjati rreth 1 vit e gjysmë, i cili bazohet në informacionin e dhënë nga institucionet vendore dhe shoqëria civile, proces ky i koordinuar nga Ministria e Drejtësisë. Për çdo nen të Konventës së Stambollit raporti: analizon kornizën ligjore vendore, mekanizmat dhe masat; identifikon nevojat dhe mangësitë; dhe ofron rekomandime konkrete mbi përputhshmërinë me Konventën e Stambollit. Ne kuadër të kesaj analize dhe rekomandimeve të dala nga raporti, ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë veprime në harmonizimin e ligjeve dhe politikave të Grevios. Ne lidhje me këto kemi ndërmarrë veprime për plotësim ndryshim të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale si dhe plotësim ndryshim të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave. Te dy këto dokumente ligjore janë votuar nga parlamenti dhe janë në fuqi. |
| II.1.3 | Përgatitja dhe paraqitja e projekt-akteve për ndryshim/plotësimin e kuadrit ligjor civil, në përputhje me gjetjet nga analiza e mësipërme | 2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MD | Projekt aktet e përgatitura në përputhje me gjetjet nga analiza, konsultuara e të dërguara në Kuvend për shqyrtim dhe miratim | Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave Konventa e Stambollit, etj. | Ne kuadër të paraqitjes së projekt-akteve për ndryshim plotësim të kuadrit ligjor civil, ministria e drejtësisë ka ndërmarrë veprim në 3 projekt-akte: Plotësim ndryshim të Kodit Penal, Plotësim Ndryshim të Kodit të Procedurës Penale dhe Plotësim ndryshimit të Ligjit për mbrojtje nga Dhuna në familje. |

⁸ Në këtë analizë duhen konsideruar të gjitha format e dhunës ndaj grave sipas Konventës së Stambollit dhe duhet vendosur theksi veçanërisht në harmonizimin e: moshës minimale për martesë, çështje të seksizmit dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes, çështjet e migrimit, azil kërkimit dhe deportimit, etj.

| | | | | | | | |
|---------|--|-----------|--|--|--|--------------------------------------|--|
| II.1.4. | Plotësim-ndryshimi i legjislationit me qëllim lirim nga taksat gjyqësore për ekspertizën që nevojitet në trajtimin e rasteve të dhunës në familje (psikologu, interpreti i gjuhës së shenjave, taksa gjyqësore, etj) | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KGJK | Viktimat e dhunës të liruara nga detyrimi nga taksat gjyqësore, e shprehur kjo edhe në ndryshimet që do të miratohen në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje | Konventa e Stambollit | Drafti i Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka qenë në diskutim publik gjatë periudhës prej 20.02.2024 deri më 06.03.2024. Rastet e dhunës në familje janë të liruara nga taksa gjyqësore. |
| II.1.5. | Rishqyrtimi dhe pasurimi i Procedurave Standarde të Veprimit mbi shërbimet e integruara | 2023 | Qeveria, Komuna dhe donatorët | MD, Komunitat, donatorët, ABGJ | Krijimi i qasjes për ofrimin e shërbimeve të reja, efektive, të qasshme dhe të integruara mes të ndërlidhurve në sistem | Konventa e Stambollit (kapitulli IV) | Bazuar ne Ligjin e ri Ministria e Drejtësisë ne bashkëpunim me Agjencine per Barazi Gjinore jane ne proces te harmonizimit te Procedurave Standarde te Veprimit. Ky proces parashihet te perfundoj ne Gusht te vitit 2024. |
| II.1.6. | Hartimi i Protokollit Nacional për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD, PK, KPK, KGJK, IML, QPS, ZMNV, MSH, OJQ-të e specializuara | Udhëzues/protokolle për mirëfunksionimin e Mekanizmave Koordinues në nivel lokal, të përgatitur dhe aprovuar në përputhje me standardet ndërkombëtare | Konventa e Stambollit | Protokolli synon ti kushtoj vëmendje të gjithë viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale, pavarësisht kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër. Në një kapitull të veçantë do të përmenden edhe viktimat/të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, duke bërë referencë dhe në legjislationin e mekanizmat përkatës të trajtimit të tyre. Për një përdorim sa më të lehtë nga të gjithë profesionistët e profesionistët, protokollin është konceptuar i ndarë në tre pjesë: - Pjesa e parë, përmban informacion të përgjithshëm mbi dokumentin: qëllimin e tij, kuadrin ligjor dhe të politikave mbi të cilat bazohet trajtimi i rasteve të dhunës seksuale, qasjen shumë-sektoriale të koordinuar, fazat e menaxhimit të një rasti, rolin e menaxheres/menaxherit të rastit, si dhe nevojën për mbështetje profesionale të profesionisteve/profesionistëve të cilat/cilët trajtojnë drejtpërsëdrejti rastet e dhunës seksuale. - Pjesa e dytë, përmban informacion të dedikuar për secilin nga institucionet kryesore përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, bazuar mbi hapat e menaxhimit të rastit të përshkruar në |

| | | | | | | | |
|---------|---|----------------|-------------------------------|-----------------------------------|--|---|---|
| | | | | | | | <p>pjesën e parë, si dhe të ndarë në kapituj të veçantë për secilin institucion.</p> <p>- Pjesa e tretë, përmban informacion të përgjithshëm mbi trajtimin e rasteve të viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, zbatimin e këtij Protokollit edhe në kushte të fatkeqësive natyrore e fatkeqësive të tjera, si dhe këshilla të rëndësishme mbi rolin e institucioneve në lidhje me parandalimin.</p> <p>Pjesë e rëndësishme e Protokollit janë edhe shtojcat dhe referencat, të cilat krijojnë mundësi për më shumë informacion e njohuri, në varësi të nevojës gjatë trajtimit të rasteve. Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Republikën e Kosovës, u përgatit si përgjigje ndaj nevojës për të unifikuar dhe përmirësuar hapat që ndërmerren ngaduke reflektuar edhe standardet ndërkombëtare në këtë drejtim. Përgatitja e këtij Protokollit gjithashtu plotëson detyrimin për zbatimin e Konventës së Stambollit, legjislacionit në fuqi, si dhe Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 - 2026, miratuar nga Qeveria e Kosovës në 26.01.2022.</p> <p>Për këtë qëllim, me Vendimin nr.36, datë 23.03.2022 të Ministres së Drejtësisë, u emërua Grupi Punues për hartimin e këtij Protokollit, ndersa është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 23 Nentor 2023.</p> |
| II.1.7. | Hetimi efektiv dhe përgjigje e menjëhershme e policisë të thirrjeve për ndihmë, menaxhim të duhur të situatave të rrezikshme dhe hetim për të gjitha akuzat për dhunë ndaj grave dhe dhunë në familje, duke evidentuar rrethanat rënduese | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Policia | Rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave trajtohen me përgjegjshmëri dhe prioritet, duke mos anashkaluar asnjë rrethanë rënduese | Konventa e Stambollit (kapitulli V, neni 46 dhe kapitulli VI) | <ul style="list-style-type: none"> Janë hetuar 2638 raste të dhunës në familje <p>Në të gjitha rastet ku I dyshuari ka kryer veprime me të cilat ka konsumuar elemente të veprës penale "Dhune ne Familje " , si rrethanë rënduese gjate hetimit dhe vlerësimit te riskut ne këto vepra penale kihet parasysh :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E kaluara kriminale e të dyshuarit 2. Posedimi i armës tek i dyshuari , pavarësisht nëse arma është legale apo ilegale 3. Përsëritja e veprës penale të dhunës në familje 4. Përdorimi i mjeteve të ndryshme për shkaktrimin e dhunës dhe lëndimeve viktimës 5.Perdorimi i substancave te ndryshme narkotike apo varësi nga alkooli etj. 6 .Kur vepra penale kryhet në prani të fëmijëve |
| II.1.8. | Ndarja e hapësirës fizike për intervistimin e viktimës dhe kryerësit të dhunës | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KGJK Gjykata, Policia, Prokuroria | E drejta e viktimës për konfidencialitet dhe privatesi sigurohet në të gjitha fazat e menaxhimit të rastit, përfshirë dhe | Konventa e Stambollit (neni 56) | <p>Momentalisht janë 28 dhoma mike funksionale nga 41 stacionet policore. Gjate vitit 2023 jane rregulluar 2 dhoma mike</p> <p>Në ato stacione policore ku nuk ka dhoma mike janë ndarë zyra të veçanta për trajtim të viktimave të dhunës në familje</p> |

| | | | | | | | |
|----------|---|-----------|---------------------------------------|------------------------------------|---|---------------------------------|---|
| | | | | | në proceset gjyqësore civile e penale | | |
| II.1.9. | Sigurimi i teknologjisë për komunikim për intervistimin e viktimës dhe kryerësit e dhunës | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donator | KGJK, Gjykata, Policia, Prokuroria | E drejta e viktimës për konfidencialitet dhe privatësi sigurohet në të gjitha fazat e menaxhimit të rastit, përfshirë dhe në proceset gjyqësore civile e penale | Konventa e Stambollit (neni 56) | Nëpër shumicën e gjykatave ekzistojnë pajisje teknologjike dhe IT, që mund të asistojnë nevojat që mund të paraqiten, me qëllim të zhvillimit të gjyqësorisë. Që nga miratimi i strategjisë, nuk janë hasur pengesa në trajtimin e rasteve, në mungesë të teknologjisë. |
| II.1.10. | Thirrja e mbrojtësve të viktimave kur pala i drejtohet gjykatës | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Policia, Gjykata ZMN | Mbrojtësi i viktimave i pranishëm edhe në rastet kur kërkesa për urdhërmbrojtje inicohet nga pala | Konventa e Stambollit (neni 56) | Ne 2638 raste janë njoftuar mbrojtësit e viktimave përmes telefonit por edhe përmes raportit ditor në mënyrë elektronike. Në asnjë rast ku MV nuk është paraqitur në Stacione Policore. Nga Policia e Kosovës në baze të vlerësimeve janë lëshuar 127 Urdhëra Mbrojtës , Nga Gjykata janë lëshuar 589 Urdhëra Mbrojtës të cilat janë monitoruar nga Policia e Kosovës |
| II.1.11. | Monitorimi i zbatimit të përcaktimit ligjor për ashpërsimin e dënimeve ndaj kryerësve recidivistë të dhunës | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KGJK | Dënime të ashpërsuara për kryerësit recidivistë të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, në përputhje me legjislacionin në fuqi | Konventa e Stambollit | Me nxjerrjen e Udhëzuesit për Politikë ndëshkimore, synohet që dënimet të jenë brenda kufijve të përcaktuar nga Kodi Penal. I njëjti parasheh masat lehtësuese dhe rënduese, po ashtu veprimet recidiviste. I njëjti udhëzues I është shpërndarë gjyqtarëve. Më pas gjykatat e instancave më të larta bëjnë unifikim të praktikës gjyqësore për këtë pjesë. |
| II.1.12. | Vendosja e sistemit digjital të monitorimit për zbatimin adekuat të Urdhërave Mbrojtës në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen Elektronike dhe monitorimi i efektivitetit të këtij sistemi | 2023-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MPB Policia | Sistemi digjital i vendosur Monitorimet e kryera në mënyrë adekuate | | I pazbatuar - Ky aktivitet është planifikuar të fillojë në vitin 2023. |
| II.1.13. | Rishikimi i rregullores për punën e mbrendëshme të mbrojtësve të viktimave (KPK) | 2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPK | Rregullorja e rishikuar | | Eshtë hartuar një draft i Rregullores nga Komisioni për Cështje Normative të KPK-se me përkrahje të partnerëve ndërkombëtar. Pritet që në vazhdim të finalizohet dhe të dërgohet në KPK për miratim. |

| | | | | | | | |
|------------|---|--|--|--|---|---|--|
| II. 1. 14. | Raportim mbi aplikimin e procedurave të adezionit në rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022 - 2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | KGJK | Raportimi i kryer rregullisht dhe sipas kërkesës me të dhëna të detajuara | | Kodi i Procedurës Penale obligon në procedura të tilla, veçanërisht kur është e mundur të vendoset për kërkesën pasurore juridike, nuk ndikon në zvarritjen e procedurës, si dhe janë provat për një gjë të tillë. Ky aktivitet është mjaft specifik, ngase duhet të analizohen vendimet gjyqësore që është vendosur në rastet kur ka pasur vepër penale të dhunës në familje, më pas të nxirret numri i vendosjes së kërkesave pasurore juridike. |
| II.1.15. | Zhvillim i vlerësimit "peer review" lidhur me ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të dhunës në familje | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | KGJK, KPK | Raportet me rekomandime të finalizuara | | Aktiviteti i pazbatuar. |
| II.2. | Objektivi specifik: | Fuqizimi i kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. | | | | | |
| II.2.1 | Zhvillimi i kurrikulave vjetore trajnuese për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtareve / gjyqtarëve, prokurorëve / prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional, mbrojtësve të viktimave dhe akterëve tjerë relevantë për zbatimin e drejtë dhe efektiv të legjislacionit me fokus në dënimet e kryerësve të veprave penale të dhunës në familje si dhe personat që shkelin urdhrat mbrojtës | Dhjetor 2022, 2023, 2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Akademia e Drejtësisë Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) | Kurrikula trajnuese e hartuar dhe e miratuar ⁹ | Strategjia për rishikimin funksional të sundimit të ligjit 2021 Plani Strategjik i Sistemit Prokurorial 2019-2021 Programi i trajnimit të Akademisë së Drejtësisë | Si çdo vit me radhë edhe për vitin 2023 është hartuar kurrikula trajnuese dhe është miratuar nga Këshilli Drejtues me 22 nëntor 2022. Akademia sipas kërkesës ligjore (më së voni deri me 1 dhjetor) ka publikuar programin vjetor të trajnimit për vitin 2023 me 25 nëntor 2022. Për më tepër shih linkun në vijim: https://rks.gov-my.sharepoint.com/:b:/g/personal/xhevdet_pllana_rks-gov_net/EeW1dqdX7qlMILFACJWjGu4Bebb0l9waMCd-00pUP7WB9w?e=MmcPxJ Në përcaktimin e kurrikulës trajnuese për vitin 2023 kanë qenë të pranishëm gjithë krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, gjyqtarët dhe prokurorët të cilët merren me rastet përkatëse si në aspektin penal ashtu edhe atë civil dhe natyrisht janë marrë në konsideratë edhe kërkesat specifike të Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave. Në periudhën raportuese programi trajnues për dhunën në familje është shqyrtuar më tej edhe me ekspertë të Këshillit të Evropës për Programin trajnues për vitin 2024 duke e përditësuar dhe siguruar që të jetë në përputhje të plotë me ligjet, politikat dhe Konventën e Stambollit e cila mbetet për tu zbatuar gjatë vitit 2024. |
| II.2.2. | Ofrimi i trajnimeve për gjyqtarët/gjyqtarët dhe prokurorët/prokurorët për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Akademia e Drejtësisë (AD) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) | 5 trajnime të specializuara të mbajtura brenda vitit | Udhëzimi i Gjykatës Supreme me nr.113/2020 lidhur me cilësimin juridik dhe | Viti 2023 karakterizohet me aktivitete të shumta në fushën e dhunës në familje dhe përtej 4 aktiviteteve të përfshira në programin trajnues ër shkak të mungesave të theksuara në buxhetin e saj me mbështetjen e partnerëve strategjik të Akademisë (ODAT, Këshilli i Evropës, EKOJUST, UNDP, EULEX) janë zhvilluar dhe realizuar për aspektin penal gjithësejt 14 aktivitete trajnuese me temë: Program i Specializuar i Trajnimit Dhuna në familje, Akuzimi dhe dënimi i |

⁹ Projekti i KiE po punon së bashku me Akademinë e Drejtësisë për të forcuar njohuritë e profesionistëve ligjorë për t'u marrë me rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

| | | | | | | |
|--------|--|----------------|-------------------------------|---|------------------------------------|---|
| | familje dhe krimet në bazë gjinore-aspekti penal | | | | | <p>trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas KPK-së si dhe Konventës së Stambollit.</p> <p>rasteve të dhunës në familje, Vlerësimi i Rrezikshmërisë në Rastet e Dhunës në Familje, Protokollin për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje-Konventa e Stambollit dhe për Viktimat e dhunës seksuale. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre trajnimeve kanë qenë regjionale dhe janë përsëritur me të vetmin qëllim që të përfshihen gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet duke përfshirë edhe profesionistë tjerë ligjor. Aktiviteti: Program i Specializuar i Trajnimit për Dhunën në familje ka specifikën e saj meqë është bashkëdyzim i aspektit penal dhe civil prandaj do të përfshihet në raportim edhe në masat e tjera sipas kesaj strategjie. Për më tepër shih raportet e publikuara në buletinin informativ të AD-së: https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulShk23Sq_.pdf (fq-13) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulMrs23Sq_.pdf (fq-10, 20, 22) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulPrill23Sq_.pdf (fq-18) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulMaj23Sq_.pdf (fq-4, 5, 10, 11,18,19, 20) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bultetor2023shq_.pdf (fq23) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bul_korrik_gusht_.pdf (fq-15) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulshtatshq_.pdf (fq-7) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulnentorshq_.pdf (fq-24)</p> |
| II.2.3 | Ofrimi i trajnimeve për gjyqtarët për aspektin civil, përkatësisht procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, si dhe lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Akademia e Drejtësisë (AD) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) | 2 trajnime të mbajtura gjatë vitit | <p>Aspekti civil i dhunës në familje është përfshirë në trajnimin: Program i Specializuar i Trajnimit për Dhunën në familje (shih kolonën paraprake) meqë ka qenë bashkëdyzim i aspektit penal dhe atij civil. Prandaj po e parashtrojë edhe këtu duke vënë theksin vetëm në përmbajtjen sa i përket aspektit civil siq është shkelja e urdhrin mbrojtës dhe dispozitat ligjore përkatëse, Konventa e Stambollit dhe Roli i Qendrës për punë sociale si dhe aspekte tjera me rëndësi në procedurën civile. Përveq kësaj është realizuar edhe një (1) trajnim i</p> |

| | | | | | | | |
|---------|--|-----------|-------------------------------|--------------------------------|---|-----------------------|---|
| | pas shkurorëzimit, alimentacionin, mbajtjen financiare të bashkëshortit/es, etj. | | | | | | cili vazhdimisht vlerësohet i nevojshëm për gjyqtarët me temë: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje e cila ka trajtuar çështjet ligjore relevante dhe praktikën gjyqësore në këtë fushë përmes inerpretim të dispozitave ligjore dhe legjislacionit në fuqi si dhe një (1) trajnim për praktikën gjyqësore në çështje familjare. Për më tepër shih raportet publikuara në buletin informativ të AD-së: https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulShk23Sq_.pdf (fq-13) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulMrs23Sq_.pdf (fq-14-15, 21-22) |
| II.2.4 | Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve kur në procedurë penale - civile përfshihen kryerësit me çrregullime mendore | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Akademia e Drejtësisë KGJK KPK | Numri i trajnimeve të mbajtura; Të paktën 60 -të gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor | | Në periudhën raportuese AD në bashkëpunim me OPDAT dhe OSBE ka realizuar trajnime të shumta për rrisitë e Kodit të Procedurës Penale dhe në 4 prej tyre janë përfshirë edhe ndryshimet ligjore sa l përket procedurës penale të kryesve me çrregullime mendore. Përveq kësaj është realizuar dhe një trajnim që eskuzivisht ishte për procedurën penale të kryesve me çrregullime mendore. Kryesit me çrregullime mendore janë trajtuar edhe te Programi i Specilizuar i trajnimit për dhunën në familje i potencuar në dy kolonat paraprake meqë përveq përmbajtjeve të raportuara ka trajtuar edhe tajtimin social dhe preventiv të dhunës në familje dhe kryesve, bashkëpunimin ndërinstucional kur kryesit janë të sëmure psikik apo persona të varur nga substancat narkotike. Për më tepër shih raportet e publikuara në buletin informativ të AD-së: https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BIJan23Sq_.pdf (fq-11) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulShk23Sq_.pdf (fq-13) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulQershor23Sq_.pdf (fq-13) |
| II.2.5. | Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve/prokurorëve dhe prokurorëve/prokurorëve në trajtimin e rasteve të dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual me një qasje të përqendruar nga | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Akademia e Drejtësisë KGJK KPK | 2 trajnime të përbashkëta të mbajtura brenda vitit | Konventa e Stambollit | Në periudhën raportuese për masën përkatëse janë realizuar 10 trajnime. Tetë (8) prej tyre me temë: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve të cilat janë mbajtur në 7 regionet e Kosovës. (Prizren dy herë), si dhe 2 trajnime tjera me temë Kompensimi i viktimave-ndryshimet e ligjit dhe tjetra për Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve. Për më tepër shih raportet e publikuara në buletin informativ të AD-së: https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulShk23Sq_.pdf |

| | | | | | | | |
|---------|--|----------------|---------------------------------------|--|--|---------------------------------|--|
| | viktima dhe shpjegimit të traumës dhe ndikimit të traumës në viktimën | | | | | | gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulMrs23Sq_.pdf (fq-11, 14, 19, 21) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulPrill23Sq_.pdf (fq-10, 13,15) https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/BulMaj23Sq_.pdf (fq-10) |
| II.2.6. | Rishikimi i kurrikulave dhe moduleve të trajnimit në departamentin e trajnimeve në Policinë e Kosovës dhe përditësimi i tyre sipas kërkesave të kuadrit ligjor kombëtar e ndërkombëtar (me këndvështrimin gjinor të përfshirë) për ngritjen e kapaciteteve profesionale të kadetëve dhe policëve | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donator | Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) Ministria e Brendshme (MB)/Policia e Kosovës (PK), ABGJ | Kurrikula e rishikuar për ngritjen e kapaciteteve profesionale të kadetëve dhe policëve Module trajnimi të përditësuara e unifikuara për fuqizimin e kapaciteteve të zyrtareve e zyrtarëve policorë me fokus në dhunën në familje e dhunën ndaj grave | Konventa e Stambollit | Akademia e Kosovës për Siguri Publike gjatë vitit 2023 ka krijuar grupe punuese profesionale bashkarisht me Agjencitë e Sigurisë Publike (PK, IPK, AME, DK, SHKK dhe SHSK) si rezultat i të cilit kemi Rishikimin e Trajnimeve Profesionale ku përfshihen dhuna në baza gjinore është trajtuar në: - Zyrtar Korrektues - Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe - Zyrtar Policor (i cili pjesërisht është rishikuar) Përveq trajnimeve profesionale janë rishikuar edhe trajnimet afatshkurtëra në të cilat trajtohet dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave si në vijim: 1. Trajnimi Themelor i Hetimit të Krimit 2. Trajnimi Hetimi i Dhunës Familjare 3. Trajnimi i Avancuar i Hetimit të Krimit |
| II.2.7. | Trajnimi i zyrtarëve dhe stafit policorë të sapoemëruar, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Policia e Kosovës ABGJ | Punonjëse dhe punonjës të policisë më të informuar e specializuar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit (neni 15) | Ne bashkepunim me ABGJ - janë mbajtur 6 trajnime dy ditore për dhunën në familje dhe procedurat standarde të veprimit të dhunës në familje ku janë trajnuar 150 zyrtar policor nga sektori i hetimeve dhe zyrtar policor nga njësit patrulluese si reagues të parë në rastet e dhunës në familje. |
| II.2.8. | Trajnimi i zyrtarëve/zyrtarëve policorë mbi përkufizimin e dhunës në baza gjinore dhe ngacmimit seksual sipas ligjeve të Kosovës, si dhe mbi mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve, konform Kodit Penal të Kosovës | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Akademia e Kosovës për Siguri Publike Policia e Kosovës ABGJ | Numri i trajnimeve të mbajtura Numri i zyrtarëve/zyrtarëve policor të cilët kanë marrë pjesë në trajnime Përditësimi i kurseve të trajnimit konform | | Akademia e Kosovës për Siguri Publike gjatë vitit 2023 ka realizuar 12 lloje të trajnimeve me gjithësej 19 trajnime ku janë përfshirë temat e ngacmimit seksual dhe dhunës me baza gjinore ku ndër të tjerash janë realizuar edhe trajnime të fushave të veqanta si: *Ngacmimi Seksual në vendin e punës * Trajnimi Qasja ndaj Dhunës në Baza Gjinore dhe * Trajnimi Hetimi i dhunës në familje Të trajnuar: |

| | | | | | | | |
|----------|--|----------------|-------------------------------|---|---|---------------------------------|---|
| | | | | | ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal lidhur me dhunën në bazë gjinore dhe ngacmimin seksual, me përqendrim në viktimën. | | Burra 962, Gra 202 Gjithësej 1164 |
| II.2.9. | Trajnime të përbashkëta për trajtimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, për punonjëset dhe punonjësit e policisë, prokurorët/prokurorët dhe gjyqtarët/gjyqtarët në detyrë, Avokatët e Viktimave, QPS, MSH, MV, Psikiatria Forenzike, në aspektin penal dhe civil dhe ndikimit të traumës në viktimën | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | AD, ABGJ, PK, KPGK, QPS, MSH, ZMNV, Psikiatria Forenzike, Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare (KPSHSF) | Punonjëse dhe punonjës të informuar e specializuar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, përfshirë qasjen mbi informimin për traumën, që ve në prioritet rivendosjen e ndjenjave të sigurisë, zgjedhjes dhe kontrollit të viktimave. | Konventa e Stambollit (neni 15) | Nga 30 trajnimet e mbajtura në 22 trajnime kanë qenë të përbashkëta gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor. Nga raportet e publikuar në buletin shihet pjesëmarrja edhe për profile tjera që në total janë 22 Bashkëpunëtorë Profesional nga Gjykata dhe Prokuroria (10 gra 12 burra), 09 Zyrtar ligjor nga Gjykata dhe Prokuroria (06 gra 03 burra), 02 Staf administrativ nga Prokuroria (02 burra), 22 Zyrtar nga Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave (08 gra 14 burra), 01 Analist nga KPK (01 Burrë), Avokat 61 (30 gra 31 burra), 01 sekretar nga OAK (01 burrë), 10 Zyrtar nga Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas (07 gra 03 burra), 36 Zyrtar nga Qendra për Punë Sociale (22 gra 14 burra), 80 Zyrtar policor (35 gra 45 burra), 08 Zyrtar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) (03 gra 05 burra), 03 Ekspert mjeko ligjor nga Ministria e Drejtësisë (01 grua 02 burra), 01 Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e Fëmijës nga Komuna e Prishtinës (01 burrë) |
| II.2.10. | Trajnime të stafit të ZMNV-ve | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | ZMNV-ZKPSH, Akademia e Drejtësisë, OPDAT, OSBE, GIZ | Stafi i ZMNV-ve profilizuar dhe trajnuar | Konventa e Stambollit (neni 15) | Gjatë vitit 2023 stafi i ZMNV-ve ka marrë pjesë në 68 aktivitete të ndryshme në të gjitha regjionet e Kosovës punëtori dhe trajnime që lidhen me trajtimin e rasteve të dhunës në Familje, po ashtu 3 pjesëmarrës nga stafi i ZMNV-së kanë marrë pjesë në trajnim jashtë vendit në Budapest-Hungari për trajtimin e rasteve të dhunës në Familje dhe Dhunës në baza Gjinore. |
| II.2.11. | Sesione trajnuese për politikën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në sektorin e mbrojtjes dhe mirëqenies sociale | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MFPT, QPS | Profesioniste dhe profesionistë të sektorit të mbrojtjes dhe mirëqenies sociale, të aftësuar mbi çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje | Konventa e Stambollit (neni 15) | Në zbatim e sipër. |

| | | | | | | | |
|----------|---|-----------|---------------------------------------|------|---|---|--|
| II.2.12. | Përgatitja e kurrikulës dhe zhvillimi i trajnimeve për punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë për identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MSH | Profesioniste dhe profesionistë të shëndetësisë, të aftësuar mbi çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje | Konventa e Stambollit (neni 15) | Trajnimet e mbajtura ne shtatë regjionet e RKS me Moduli 1. Kuptimi i dhunës ne baza gjinore; Moduli 2. Roli i sistemit shëndetësor në reagimin në bazë gjinore; Moduli i 3. Parimet dhe standardet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore; Moduli i 4. Identifikimi I dhunës në baza gjinore; Moduli 5. Egzaminimi dhe kujdesi shëndetësor; Moduli 6. Dokumentimi i dhunës në baza gjinore; Moduli 7. Vlersimi dhe planifikimi i sigurisë; Moduli 8. Referimi dhe Proceduar Standarde të Veprimit (PSV); Një trajnim në shtatë regjione; Numri i profesionistëve shëndetësor sipas gjinisë: 88 gra profesioniste shëndetësore, 67 burra profesionist shëndetësor, gjithësej 155 prof shendetesor; Dhuna në baza gjinore në bashkëpunim me UNFPA-AMC: Modulet tri: Programi Orientues mbi Shëndetin e Adoleshentëve (trajnim katër ditor), Etika Profesionale dhe të Drejtat e Pacientëve (trajnim një ditor), Shëndeti Seksual dhe Riprodhues i Personave me nevoja të veçanta (trajnim dy ditor). Numri i profesionistëve të trajnuar është: gra 63, kurse profesionist shendetësor burra 46, gjithësej 109; gjithësej dy trajnime në gjashtë mujorin e parë. Në gjashtmujorin e dytë janë mbajtur trajnimet për idetifikim trajtim referim dhe regjistrim të viktimave të dhunës në familje, dhunë në bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave me të gjithë akterët kyq në tri regjione: Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan. Pjesëmarrës ishin profesionistë shëndetësorë meke 10; mjekë 5; 6 infermier; 2 infermier; 4 zyrtar policor dhe 2 zyrtare policore; një mbrojtës i viktimave; 2 mjekë të shëndetit mendor dhe 5 infermier; Në trajnimin e mbajtur për dhunë në bazë gjinore në regjionin e Pejës pjesëmarrës: 5 mjekë, 3 mjekë; 6 infermjere, 2 infermjer; 4 zyrtar policor, dhe 2 zyrtare policore; një mbrojtës i viktimave; 2 mjekë, të Shëndetit Mendor dhe një infermier; Në trajnimin për dhunë në bazë gjinore/DHF/DHG e mbajtur në regjionin e Gjilanit kanë marrë pjesë 4 mjeke, 2 mjekë, 5 infermiere dhe 3 infermier; 4 Zyrtare policor, dhe 2 zyrtar policor; 2 mjekë dhe një infermier të Shëndetit Mendor. Gjithësej 94 pjesmarrës të certifikuar dhe module të akredituar si dhe trajner të trajnuar nga Oda e Mjekëve të Republikës së Kosovës me nga 11 pikë dhe nga Oda e Infermierëve të Republikës së Kosovës 10 pikë. |
| II.2.13. | Zhvillimi i kurrikulës dhe trajnimi i eksperteve/ ekspertëve të cilët janë të licencuar për ekspertiza psikologjike, për elementët e dhunës psikologjike në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm për këtë formë dhune | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donator | MFPT | Ekspertë të trajnuar për të zbatuar legjislacionin në fuqi | Udhëzimi i Gjykatës Supreme të Kosovës - Lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës ne | Zbatuar pjesërisht |

| | | | | | | | |
|----------|--|-----------|---------------------------------------|-------------------|---|---|--|
| | | | | | | Familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovë me numër GJ.A.SuA 113/2020 i datës 12.06.2020 | |
| II.2.14. | Trajnime të përbashkëta mes gjyqtarëve, prokurorëve e zyrtarëve policorë për të ndaluar dhënien e aktgjykimit lirues përkundër deklaratave të viktimave të dhunës, duke aplikuar ndjekjen kryesisht të kësaj vepre penale | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donator | KGJK KPK PK | Zbatimi në mënyrën e duhur i legjislacionit dhe standardeve për mbrojtje nga dhuna në familje. | Konventa e Stambollit | Është hartuar plani i trajnimeve nga Akademia e Drejtësisë për gjykatat, ashtu që për pjesën e trajnimeve që kanë të bëjnë me dhunë në familje, krimet në baza gjinore janë trajnime këtë vit. Trajtimet që janë mbajtur deri më tani dhe janë të planifikuara gjatë vitit 2024 janë : Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje ; kompensimi i viktimave ; Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje ; Trajnim për praktikën gjyqësore në rastet familjare . Deri tani, në baza të rregullta janë mbajtur trajnime për çështje të dhunës në familje. |
| II.2.15. | Mbajtja e ligjëratave të vazhdueshme, në baza vjetore, nga gjyqtarët/gjyqtarët dhe prokurorët/prokurorët për vetëdijesimin e profesionistëve e profesionistëve të rinj në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KGJK dhe KPK | Ligjërata të mbajtura në mënyrë të përvitshme. Më shumë profesioniste e profesionistëve të vetëdijësuar. | Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15) | Ekziston plani i trajnimeve për gjyqtarët e sapoemëruar, të cilët në kuadër të trajnimeve të programit fillestar, kanë edhe trajnime lidhur me dhunën në familje, e po ashtu edhe në programin e trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë me mandat të përhershëm janë të parapara trajnimet edhe për dhunë në familje |
| II.2.16. | Ngritja e zhvillimi i policimit në bashkësi dhe policimit të drejtuar në inteligjencë lidhur me dhunën në familje, dhe dhunën ndaj grave, si dhe trajnimi i Njësisë Policore të Hetimit të Krimin në Internet, për dhunën ndaj grave përmes internetit | 2024-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donator | MPB/PK | Policimi në bashkësi i zhvilluar dhe në mbështetje të identifikimit e parandalimit të rasteve të dhunës në familje. Njësia Policore e Investigimit të Krimin në Internet,e aftësuar për ndjekjen dhe parandalimin e dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit | Ky aktivitet është planifikuar të zbatohet në vitin 2024. Policia e Kosovës në kuadër të Strategjisë së integruar të policimit të drejtuar nga inteligjenca dhe policimit në bashkësi, ka paraparë një sere aktivitetesh, që ndërlidhen me dhunën në familje, përfshirë organizimin e fushatave vetëdijësuese, ngritjen e kapacitetetev njerzore dhe profesionale etj. |

| | | | | | | | |
|---------|--|--|--|-------|--|-----------------------|--|
| | | | | | e vazhaze në internet. | | |
| III. | Objektivi strategjik: | Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave. | | | | | |
| III.1 | Objektivi specifik: | Fuqizimi i grupit koordinues ndërinstytucional në nivel qendror. | | | | | |
| III.1.1 | Themelimi dhe funksionalizimi i mekanizmit mbështetës të Zyrës së Koordinatores Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN | Zyra e themeluar stafi i ristrukturuar dhe i në numër të përshtatshëm për qëllimet dhe përgjegjësitë e kësaj zyre, si dhe i trajnuar për mbështetjen e zyrës. | Konventa e Stambollit | Ky aktivitet është në proces. Gjatë muajit dhjetor janë inicuar procedurat për punësimin dhe funksionalizimin e zyre mbështetëse. Ky proces parashihet të përfundojë në fund të muajit maj 2024. |
| II.1.2. | Trajnimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Koordinatores Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në aspekte të monitorimit dhe vlerësimit në tërësi të legjislativitetit dhe politikave kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN | | | Ky aktivitet është i ndërlidhur me Rregulloren e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë dhe është caktuar numri i personave të cilët do të angazhohen në këtë sekretariat. Pritet që Zyra të funksionalizohet deri në fund të vitit 2023. Ky aktivitet është i ndërlidhur me aktivitetin III.1.1 |
| III.1.3 | Ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN | Sistemi i monitorim-vlerësimit i ngritur dhe funksional Mjetet që do përdoren nga niveli qendror dhe lokal për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve dhe objektivave të strategjisë, të përgatitura dhe dakordësuara | Konventa e Stambollit | Më 16 qershor 2023 është finalizuar instrumenti raportues pas konsultimit me institucionet përgjegjëse që raportojnë në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026). Ky instrument ofron pasqyrë të qartë mbi zbatimin e strategjisë dhe ndihmon MD në monitorimin e saj dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë. Për herë të parë përmes këtij formati mundësohet raportimi i organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare në mbështetje të zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit. |

| | | | | | | | |
|---------|---|--------------------------|--|---|---|-----------------------|---|
| III.1.4 | Ngritja e kapaciteteve për akterët përgjegjës për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të kësaj strategjie, në nivel qendror e lokal | 2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | ZKN-MD, MFPT, Komunitat | Kapacitetet partnerëve zbatues të ngritura e fuqizuara | Konventa e Stambollit | Në pritje sipas planit për zbatim |
| III.1.5 | Monitorimi periodik i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave dhe planit të saj të veprimit, si dhe publikimi i rezultateve përkatëse | Në vazhdi mësi (çdo vit) | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN Institucionet përgjegjëse për zbatim në nivelin qendror e lokal OJQ Organizatata Ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë | Formati standard i raportit të monitorimit i përgatitur nga Zyra e Koordinatorës Nacionale. Të dhënat për ecurinë e zbatimit të strategjisë të mbledhura çdo gjashtëmuor nga të gjithë akterët përgjegjës Raporti i monitorimit me të dhëna të detajuara sipas objektivave strategjike e specifike, i publikuar në mënyrë të përvitshme në faqen e internetit të MD | Konventa e Stambollit | Përmes formularit për raportim, institucionet përgjegjëse në baza tre mujore dergojnë të dhëna sipas aktiviteteve të parapara me Strategji dhe Plan të Veprimit 2022-2026. Në shkurt të vitit 2023, është publikuar "RAPORTI VJETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NDAJ GRAVE" për vitin 2022, i cili është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu, më 16 qershor 2023 është finalizuar instrumenti raportues pas konsultimit me institucionet përgjegjëse që raportojnë në zbatim të SMDHFDHG (2022-2026). Ky instrument ofron pasqyrë të qartë mbi zbatimin e Strategjisë dhe ndihmon MD në monitorimin e saj dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë. Për herë të parë përmes këtij formati do të mundësohet raportimi i organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare në mbështetje të zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit. Në kuadër të monitorimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, është dërguar formati raportues tek institucionet përgjegjëse për hartimin e Raportit 6 muor (Janar - Qershor 2023). |
| III.1.6 | Përcaktimi në Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje përgjegjësia e Zyrës së Koordinatorës Nacionale si organi shtetëror që mbikëqyr koordinimin, monitoron zbatimin e Konventës së Stambollit, si dhe që raporton mbi zbatimin e | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN | Profilizimi dhe aftësimi i stafit të Zyrës së Koordinatorës Nacionale, për njohjen, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të | Konventa e Stambollit | Sipas Ligjit të ri për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë gjinore, janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për koordinatorin kombëtar. Po ashtu sipas ligjit në fuqi, është rritur përgjegjësia politike në adresimin e dhunës në familje dhe dhunes ndaj grave. Me ligj të ri, ministria/ministri është koordinatore/or kombëtare. |

| | | | | | | | |
|---------|--|-----------|--|---------------|---|-----------------------|--|
| | kësaj Konvente në GREVIO | | | | Konventës së Stambollit ¹⁰ Raportet e përgatitura dhe dërguara sipas kërkesave të GREVIOs | | |
| III.1.7 | Fuqizimi i kapaciteteve të organit shtetëror dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për raportim në GREVIO | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN ABGJ | Profesioniste e profesionistë të aftësuar për të përgatitur raportimet në GREVIO sipas standardeve ¹¹ | Konventa e Stambollit | Ky aktivitet është në proces |
| III.1.8 | Zhvilimi i një raportimi mbi përgjigjen nga ana e institucioneve përgjegjëse në rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe vlerësimi i mundësive për inspektim lidhur me ndihmën e ofruar nga institucionet përgjegjëse dhe cilësinë e bashkëpunimit ndërinstytucional | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN | Ndihma e ofruar nga institucionet përgjegjëse dhe cilësia e bashkëpunimit ndërinstytucional, të vlerësuara. Raporti mbi përgjigjen nga ana e institucioneve përgjegjëse në rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave i përgatitur e publikuar | | Në kuadër të aktivitetit, është zhvilluar raporti mbi përgjegjësinë në rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave si dhe inspektimet në rastet e caktuara. Për shkak të konfidencialitetit raportet inspektuese për rastet e caktuara nuk janë publikuar, ndërsa në shkresat zyrtare dërguar institucioneve përgjegjëse ndaj rasteve janë hartuar dhe dërguar në kohë. |
| III.1.9 | Publikim i praktikave më të mira të identifikuara gjatë funksionimit të institucioneve përgjegjëse | Çdo vit | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN | Një raport me praktikat më të mira të funksionimit të institucioneve përgjegjëse i publikuar | | Pas hartimit dhe publikimit të raportit vjetor për vitin 2023, do të nxjerren rekomandime dhe praktika të mira gjatë funksionimit të institucioneve përgjegjëse. |

¹⁰ Raporti përfundimtar i vlerësimit GREVIO dhe takimet zyrtare të organizuara në këtë kontekst, do të ofrojnë udhëzime për përmirësimin e përputhjes me nenin 10 të Konventës së Stambollit, duke përfshirë kuadrin ligjor në fuqi që përcakton mandatin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

¹¹ *Ibid.*

| | | | | | | | |
|----------|---|---|---|--|---|--------------------------------|---|
| III.1.10 | Krijim i raporteve të bashkëpunimit me autoritete të vendeve tjera për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/KN | Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave, me autoritete të vendeve të tjera, i krijuar dhe fuqizuar | | Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues dhe Sprovues në Suedi, janë në proces të finalizimit të dokumentit i cili përcakton fushat e bashkëpunimit. Ky proces do të paraprijë projektit shumë vjeçar me kete institucion ne fushen e sherbimit korrektues dhe sprovues si dhe adresimi i dhunës në familje. Projekti parashihet të jetë ne periudhe 5 vjeçare. |
| III.2. | Objektivi specifik | Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave koordinues në nivel lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës. | | | | | |
| III.2.1 | Shtrirja e qasjes shumë-sektoriale të koordinuar të trajtimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në mbarë Kosovën, përmes themelimit të Mekanizmave Koordinues në komunat ku mungojnë | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MD/KN, Komunat, Të gjitha institucionet përgjegjëse për të qenë antare të MK në nivelin lokal, OJQ | Mekanizmat Koordinues të themeluar në mbarë Kosovën, në përputhje me qasjen shumë-sektoriale të koordinuar të Konventës së Stambollit | Konventa e Stambollit (neni 7) | Në bashkëpunim me OSBE-në për zbatimin e shtrirjes dhe e qasjes shumë-sektoriale të koordinuar të trajtimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në mbarë Kosovën, në nivel vendi janë themeluar 36 Mekanizma Koordinues. Gjatë 6-mujorit të parë janë themeluar 3 Mekanizma Kordinues në komunat e Novobërdës, Shtërpcës, si dhe Mamushës. Sfidë mbetet themelimi i Mekanizmave Koordinues në katër komunat veriore: Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut dhe Zveqan. Me miratimin e Projektligjit nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, më 21/09/2023 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, parashihet dhe zgjerimi i kompetencave të Mekanizmit Koordinues Lokal. Në kuadër të fushëveprimit dhe krijimit të mekanizmave koordinues lokal, deri më tash janë themeluar 34 mekanizma koordinues lokal. Mekanizmat Kordinues Komunal, nuk kanë qenë të përfshirë në Ligjin paraprak për mbrojtje nga Dhuna në Familje. Këtij Mekanizmi i është vendosur baza ligjore, përgjegjësitë dhe funksionimi i tij, si dhe është hartuar Udhëzuesi për punë efektive të Mekanizmit Kordinues Komunal. |
| III.2.2 | Hartimi i udhëzuesve/protokollev e për standardet e funksionimit dhe veprimet për mekanizmat koordinues në nivel lokal, në përputhje me qasjen shumë-sektoriale të koordinuar. | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MD/KN, MAPL, ABGJ | Udhëzues/protokolle për mirëfunksionimin e Mekanizmave Koordinues në nivel lokal, të përgatitur dhe aprovuar në përputhje me standardet ndërkombëtare | Konventa e Stambollit (neni 7) | Me 17 maj 2023 është lansuar udhëzuesi për funksionalizimin e mekanizmave lokal kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Qëllimi i Udhëzuesit është themelimi dhe koordinimi i mekanizmit lokal koordinues, hartimi i procedurave dhe protokolleve duke përfshirë bazën e të dhënave në nivel lokal, avokimi për ndarjen e buxhetit nga vendimmarrja komunale, hartëzimi dhe definimi i referimit për shërbime specifike, si dhe ngritja e kapaciteteve, po ashtu, koordinimin dhe bashkërendimin e politikave me organizatat e grave dhe të shoqëris civile duke mbështetur gratë në komunitet dhe grupet e marginalizuara. Ky dokument është hartuar në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë. Sipas Ligjit te ri ne fuqi, parashihet hartimi i Udhëzimit Administrativ per funksionalizimin e Mekanizmit Kordinues Lokal |
| III.2.3 | Krijimi i linjes se vecant buxhetore e financiare për funksionimin e | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MFPT, MD/KN, Komunat, | Koordinatorët e Mekanizmave Koordinues të | | Aktivitet i pazbatuar. |

| | | | | | | | |
|---------------|---|---|---|--|--|--------------------------------|--|
| | Mekanizmave Koordinues në nivelin lokal | | Komunat Donatorët | Të gjitha institucionet përgjegjëse për të qenë antare të MK në nivelin lokal, OJQ | emëruara me kohë të plotë në çdo komunë. Mbulimi i kostove të koordinimit dhe aktiviteve të Mekanizmave Koordinues nga buxheti vjetor i komunës | Konventa e Stambollit | |
| III.2.4 | Ngritja/ fuqizimi i kapaciteteve të anëtarëve të Mekanizmave Koordinues të nivelit lokal përmes trajnimeve periodike për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MD/KN ABGJ Komunat Policia MFPT/QPS MSH ZMNV OJQ | Trajnimet periodike të përbashkëta të antarëve të Mekanizmave Koordinues të zhvilluara çdo vit Profesioniste dhe profesionistë nga të gjitha fushat të aftësuar për të trajtuar në mënyrë adekuate dhe me përgjegjshmëri rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit (neni 7) | Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, në bashkëpunim me Rrjetin e Grave dhe Strehimoret, janë organizuar trajnime në nivel Regjional për mekanizmin koordinues lokal. Këto trajnime kryesisht janë zhvilluar në fushën e njohurive dhe zbatimit të protokollit shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunimeve seksuale. |
| III.2.5 | Mbështetja e komunave në zbatimin e kësaj strategjie në Strategji lokale, përfshirë dhe hartimin i planeve të punës të Mekanizmave Koordinues | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MD/KN MAPL ABGJ Komunat OJQ | Strategjia 2022-2026 e zbatueshme dhe lehtësisht të monitorueshme | | Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Misionin e OSBE në Kosovë kanë mbështetur komunat (Rahovec, Gjilan, Malisheve dhe Skenderaj) në zbatimin e MDHFDHG në strategji lokale. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, i është drejtuar komunave për obligimin ligjor në hartimin e strategjive lokale për adresimin e DHFDHG. Në kuadër të kësaj mbështetje, MD bazuar në Ligjin e ri për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Baze gjinore, do të nxjerr udhëzimet administrative që ndërlidhen me këtë çështje. |
| III.3. | Objektivi specifik: | Avancimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe Organizatave të Shoqërisë Civile. | | | | | |
| III.3.1 | Organizimi i tryezave të rregullta konsultuese me OJQ dhe shoqërinë civile gjatë përgatitjes dhe përditësimit të kuadrit ligjor dhe të politikave në | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat | MD/KN ABGJ Komunat Institucionet përgjegjëse në hartimin e kuadrit ligjor apo | Kuadri ligjor dhe i politikave për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, i përditësuar në konsultim dhe | Konventa e Stambollit | Në bashkëpunim me UNWOMEN, UNFPA/ OSCE/ EULEX dhe shoqëri civile janë organizuar tryeza me theks të vecantë kuadri ligjor që adreson dhunën ndaj grave dhe dhunën me baze gjinore. Kuadri Ligjor dhe politikave të mbrojtjes nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave kanë qenë tema të debatit dhe diskutimit në këto tryeza, vecanërisht |

| | | | | | | | |
|---------|---|-----------|---|---|--|-----------------------|---|
| | mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave | | Donatorët | institucional lidhur me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave | bashkëpunim me OJQ e specializuara dhe shoqërinë civile | | Projekt Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjejn nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore. |
| III.3.2 | Mbështetja nga organet shtetërore qendrore e lokale, si dhe të punuarit bashkërisht me shoqërinë civile dhe OJQ-të, si partnerë të vlerësuar në zbatim të Konventës së Stambollit (<i>hartimi i planeve të përbashkëta për zbatim</i>) | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MD/KN ABGJ Komunat | Konventa e Stambollit e njohur dhe e kuptuar për t'u zbatuar në mënyrën e duhur nga OJQ dhe shoqëria civile | Konventa e Stambollit | Në bashkëpunim me Rrjetin e Grave të Kosovës, Ministria e Drejtësisë është në proces të harmonizimit të veprimeve të përbashkëta strategjike, në veçanti organizimin e fushatave të përditshme kundër dhunës dhe të gjitha formave të saja. Ky aktivitet planifikohet të fillojë të zbatuar nga marsi i vitit 2023. Në lidhje me këtë proces, jemi në koordinim edhe me partner strategjik mbështetës për zbatimin e Konventës së Stambollit. |
| III.3.3 | Fuqizimi i kapaciteteve të OJQ për të raportuar në mënyrën e duhur zbatimin e aktiviteteve për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, në përputhje me kërkesat dhe standardet e Konventës së Stambollit | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MD/KN ABGJ Komunat | Stafi përkatës i OJQ dhe shoqëria civile, të mirë informuar për raportimin adekuat sipas standardeve të Konventës së Stambollit ¹² | Konventa e Stambollit | Në qershor të vitit 2023, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të OJQ për raportim, është mbajtur një trajnim gjithë ditore në lidhje me mekanizmin e ri raportues |
| III.3.4 | Selektimi i OJQ partnere që punojnë ngushtësisht në zbatim të Konventës së Stambollit, në drejtim të parandalimit, përfshirë dhe OJQ që punojnë me djemtë dhe burrat, dhe ofrojnë shërbime në parandalim dhe rehabilitim me kryerësit e dhunës. | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MD/KN MFPT ABGJ Komunat MKRS | OJQ që veprojnë në zbatim të konventës së Stambollit, kryesisht në drejtim të parandalimit si dhe ato të fokusuar tek djemtë dhe burrat apo shërbime rehabilitimi për kryerësit e dhunës, të mbështetura me burime financiare e infrastrukturore | Konventa e Stambollit | Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2023, ka bashkëpunuar me një numër shumë të madhe të OJQ. Në lidhje me këtë vlen të theksohet bashkëpunimi me INTEGRA, SIT dhe 10 strehimoret. Ky bashkëpunim me këto dy organizata është i nderlidhur me zbatimin e Konventës së Stambollit duke përfshirë adresimin e parandalimit. |

¹² Në kontekstin e vlerësimit GREVIO, KIE mund të mbështesë shoqërinë civile në ofrimin e raporteve në hije nëse kërkohet.

| III.4. | Objektivi specifik: | Hulumtimi, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave ndër-institucionale për evidentimin e rasteve. | | | | | |
|---------|---|---|--|---|--|---------------------------------|--|
| III.4.1 | Përgatitja e një udhëzuesi mbi llojin e të dhënave (administrative dhe nëpërmjet hulumtimeve) si dhe metodologjinë e mbledhjes dhe analizës së këtyre të dhënave, në përputhje me përkufizimet dhe kërkesat në Konventën e Stambollit | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD ABGJ ASK | Udhëzuesi i përgatitur me metodologjinë e përcaktuar ¹³ | Konventa e Stambollit (neni 11) | Sipas Ligjit në fuqi , është themeluar grupi punues i cili do të hartoj udhëzimet administrative që rrjedhin nga ligji. |
| III.4.2 | Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse qendrore e lokale për mbledhjen e të dhënave administrative në përputhje me metodologjinë e dakordësuar më sipër | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD ABGJ ASK Partnerët | Zyrtaret/zyrtarët përgjegjës për mbledhjen e të dhënave administrative për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, të trajnuar dhe aftësuar | Konventa e Stambollit (neni 11) | Ky aktivitet është i ndërlidhur me aktivitetin III.4.1 |
| III.4.3 | Mobilizimi dhe koordinimi me palët e interesuara (si Institucione të Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor, OJQ, ekspertë të fushës, institucione të pavarura, etj.) për dakordësimin mbi metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nëpërmjet hulumtimeve | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD ABGJ Instituti i Statistikave Partnerët | Partnerët dhe bashkëpunëtorët e identifikuar, të dakordësuar mbi metodologjinë dhe aplikimin e standardeve ndërkombëtare | Konventa e Stambollit (neni 11) | Ky aktivitet është i ndërlidhur me hartimin e udhëzimit administrativ që rrjedh nga Ligji në fuqi. |
| III.4.4 | Kryerja e hulumtimeve kombëtare periodike (çdo 4 vite) mbi fenomenin, përmasat, profilin e dhunuesve dhe perceptimin e qytetareve dhe qytetarëve ndaj | 2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD MFPT ABGJ Partnerët | Raporti i studimit i botuar, me të dhëna të detajuara e ndara | Konventa e Stambollit (neni 11) | Në bashkëpunim me Rrjetin e Grave të Kosovës, do të nisë hulumtimi mbi perceptimin e dhunës në familje në vitin 2024. Nje hulumtim i tillë tashmë është zhvilluar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe jemi në finalizimin e raportit të këtij hulumtimi i cili është zhvilluar vetëm me një kategori të responentëve (gra dhe vajza) Ky hulumtim do të filloj nga mesi i vitit 2024 |

¹³ Autoritetet inkurajohen të marrin në konsideratë Raportin e Këshillit të Evropës “Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: metodologji dhe mjete”. Shiko: <https://rm.coe.int/semnar-pristina-report-eng/16807316df>

| | | | | | | | |
|---------|---|----------------|--|---|--|---------------------------------|--|
| | dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. | | | | | | |
| III.4.5 | Fuqizimi i kapaciteteve të zyrtareve/zyrtarëve të institucioneve përgjegjëse të integruara në databazën kundër dhunës në familje, në evidentimin e rasteve në aplikacion gjatë procesit të regjistrimit | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ZKNMDHF Institucionet përgjegjëse | Zyrtaret/zyrtarët për hedhjen e të dhënave në databazë, i trajnuar dhe aftësuar për kryerjen e detyrës së tyre me përgjegjshmëri | Konventa e Stambollit (neni 11) | <p>1. Trajnimi është mbajtur në QPS-Prishtinë me datë 04.04.2023. Gjithsejtë të pranishëm në trajnim ishin 23 pjesëmarrës, prej të cilëve 17 gra dhe 6 burra.</p> <p>2. Me kërkesë të Policisë së Kosovës: kemi realizuar 5 punëtori me të gjithë hetuesit e dhunës në familje në nivel qendror , rajonal dhe lokal në kuadër të PK-së. Datat e trajnimeve të mbajtura ishin: Dita e parë: 18.09.2023 Dita e dytë: 22.09.2023 Dita e tretë: 25.09.2023 Dita e katërt: 27.09.2023 Dita e pestë: 28.09.2023 Numri i përgjithshëm i hetuesve që janë trajnuar gjatë 5 ditëve është 111 (65 M dhe 46 F).</p> <p>3.Me kërkesë të Qendrës për Punë Sociale të komunës së Drenasit,me datë 04.10.2023 kemi realizuar trajnimin për zyrtarët social të kësaj qendre. Numri i pjesëmarrësve në trajnim ishte 5 (prej tyre 3 gra dhe 2 burra).</p> <p>4.Me 18.10.2023 është mbajtur trajnim me Strehimoret të cilat mirren ekskluzivisht me rastet e dhunës në familje, dhe njëherit janë të autorizuar që databazën nacionale ta përditësojnë me të dhëna. Gjithsejtë të pranishme në trajnim ishin 9 pjesëmarrëse, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strehimorja Prishtinë (2) • Strehimorja Pejë (1) • Strehimorja Gjilan (2) • Strehimorja Ferizaj (2) • Strehimorja Gjakovë (2). |
| III.4.6 | Evidentimi/përditësimi i të dhënave në kohë reale nga gjashtë institucionet e integruara në databazën kundër dhunës ne familje | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD, PK, KPK, KGJK, QPS, MV dhe Strehimoret. | Databaza e kompletuar me të dhëna të përditësuara në kohë reale | Konventa e Stambollit (neni 11) | <p>Databazën për evidentimin e rasteve të dhunës në familje e përditësojnë me të dhëna gjithsejtë 497 përdorues, prej tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjykata – 216 • Prokuroria – 30 • Policia – 114 • MV – 24 • QPS – 101 • Strehimoret – 12 <p>Mirëpo me KGJK jemi në proces të ndërlidhjes së databazave, ku Ministria e Drejtësisë do të ketë mundësi të gjenerimit të të dhënave për rastet e dhunës në familje nga sistemi i Gjyqësorit (SMIL).</p> |

| | | | | | | | |
|---------|--|--|--|--|---|--|--|
| III.4.7 | Gjenerimi i statistikave dhe përgatitja e buletineve statistikore periodike mbi numrin e rasteve të raportuara dhe trajtuara në mënyrë multi-disiplinare | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ ZKNMDHF | Raportet tre mujore dhe vjetore me statistika të përditësuara, të përgatitura dhe publikuara | Konventa e Stambollit (neni 11) | Në zbatim e sipër |
| III.5 | Objektivi specifik: | Përmirësimi i qasjes në drejtësi të viktimave/të mbijetuarave të dhunës | | | | | |
| III.5.1 | Informimi i viktimave / të mbijetuarave të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, si dhe publikim në tërësi, mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet ku mund të marrin ndihmë, përfshirë ndihmën juridike falas për personat e ekspozuar ndaj dhunës, në një gjuhë që ato/ata e kuptojnë | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ ZKNMDHF ANJF ABGJ Policia Gjyqësori Komunitat Antarët e Mekanizmave Koordinues QPS OJQ Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit | Informacioni mbi të drejtat dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe ndihmën juridike falas, i përgatitur me gjuhë të qartë e të kuptueshme dhe i shpërndarë në komunitet | Konventa e Stambollit (neni 19) | Në kuadër të aktivitetit, me qëllim të informimit të drejtë mbi shërbimet për rastet e dhunës në familje, MD ka hartuar dokumentin "Manuali 2023" Në këtë dokument janë listuar informata mbi dhunën dhe format e saja, si dhe shërbimet që ofrohen nga institucionet përgjegjëse, duke përfshirë ndihmën juridike falas, kompensimin e viktimave të krimit. Ky manual është i përkthyer në gjuhën angleze dhe serbe, po ashtu përvleë manualit, janë përgadite dhe shpërndare fletushka informuese mbi format e dhunës, institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimit, numrat e raportimit. Në lidhje me këto, janë përgaditur fletushka për format e reja të dhunës të parapara me Kod Penal-Ndihmimi Seksual. -Me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve në vazhdimësi janë mbajtur takime informuese me akterë të ndryshëm komunal (mbi 200 takime nga ofruesit e Ndihmës Juridike Falas). Përmblajtja, dizajnimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve – broshurave (rreth 4000), posterave (rreth 260) dhe fletushkave (rreth 1600) është bërë në 4 gjuhët, si dhe në shkrimin Brail dhe në formën digjitale për personat e shurdhër. Po ashtu, janë ndërmarrë aktivitete tjera si promovimi i numrit telefonik falas, plasimi i informatave në ueb faqe, prezenca e vazhdueshme në rrjete sociale, publikimi i videove promovuese (realizimi i videos për të pasqyruar punën e ANJF-së gjatë një viti kalendarik, si dhe Ministria Albulena Haxhiu, me rastin e mbylljes së Javës së Ndihmës Juridike Falas, i është drejtuar nëpërmjet një videoje viktimave të dhunës). Po ashtu, ANJF ka organizuar Javën e Ndihmës Juridike Falas me moton "Mbroj të drejtën tënde" dhe kampanja të vetëdijesimit me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit për ekzistimin e ndihmës juridike falas dhe mundësi që ajo siguron për qasje më të mirë në drejtësi. |
| III.5.2 | Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit në gjuhët zyrtare dhe të përshtatshme për personat me nevojë të veçanta (alfabeti braille, etj), mbi legjislativën në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MD/ Zyra e Koordinatorëve, ABGJ, Asociacioni i gazetarëve, MASHT, | Materiale sensibilizuese për njohjen e formave të dhunës në familje e dhunës ndaj grave si dhe për mbrojtjen që ekziston, të përgatitura dhe | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12, 13 dhe 17) | Me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve në vazhdimësi edhe gjatë kësaj periudhe janë mbajtur takime informuese me akterë të ndryshëm komunal (mbi 200 takime nga ofruesit e Ndihmës Juridike Falas). Krijimi i përmblajtjes, dizajnimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve – broshurave (rreth 4000), posterave (rreth 260) dhe fletushkave (rreth 1600) është bërë në 4 gjuhët zyrtare si dhe në shkrimin Brail dhe në formën digjitale për personat e shurdhër. |

| | | | | | | | |
|---------|--|--------------------------|--|---|--|---|---|
| | përkatëse ku duhet të adresohen viktimat/ të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | | | ZBGJ dhe MK nivel lokal, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ, institucionet ndërkombëtare | shpërndara çdo vit në disa gjuhë dhe sipas alfabetit braille Informacionet vetëdijesuese të shpërndara edhe nëpërmjet mediave sociale | | |
| III.5.3 | Organizimi i javës për të drejtat e viktimave, me fokus të veçantë viktimat e formave të ndryshme të veprave penale të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, siç parashikohen në Konventën e Stambollit ¹⁴ | Në vazhdi mësi (çdo vit) | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | ZMNV, ZKPSH | Më shumë informacion dhe vetëdijesim mbi të drejtat e viktimave/ të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave Përgatitja e materialeve përkatëse dhe (në varësi të formatit) një stendë informacioni për gratë/viktimat do përgatitet nga KiE ¹⁵ | Java për të drejtat e viktimave Konventa e Stambollit (kapitulli IV, nenet 18, 19) | 24.10.2023 Organizimi i Tryezës regjionale në Prishtinë me temë të diskutimeve nga institucionet pjesëmarrëse KPK,KGJK, ZKPSH,MD, OJQ për: • Obligimin për informimin e viktimës të drejtat e tyre dhe shërbimet ekzistuese • Parandalimi i riviktimizimit- koordinimi institucional në identifikimin e viktimave, hetimin e rastit, ofrimin të shërbimeve dhe ndjekjen e rastit 25.10.2023 Organizimi i Tryezës regjionale në Gjakovë 26.10.2023 Organizimi i Tryezës regjionale në Mitrovicë 27.10.2023 Organizimi i Punëtorisë një ditore - shkëmbimi i përvojave në mes të prokurorëve Amerikan dhe Mbrojtësve të viktimave . |
| III.5.4 | Sesione informuese me grupe të ndryshme të grave, të rejave, vajzave, burrave, të rinjve e djemve, mbi rolet gjinore dhe ekzistencën e mekanizmave | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MAPL Komunat/ZBGJ | Sesione informuese të zhvilluara në të gjitha komunat ku ekziston dhe aty ku do të ngrihen | Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 7, 12 dhe | Nga viti I kaluar është rritur numri i sesioneve informuese nga 28 në 51 sesione minimum për vitin 2023. 1. Sa i përket vetëdijesimit në fushën e parandalimit të dhunës në familje dhe dhunës së gruas, pjesë e madhe e komunave kanë shënuar hapjen e fushatës '16 ditë aktivizimit' Ndërsa për rritjen e vetëdijesimit të publikut për dhunën në familje në 30 komuna: Deçan, Obiliq, Klinë, Skenderaj, Rahovec, Junik, Dragash, Glogoc, Pejë, Hani Elezit, |

¹⁴ Konventa e Stambollit mbulon këto vepra penale: dhunën në familje (dhunën fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike), përndjekjen, dhunën seksuale, duke përfshirë edhe përdhunimin, ngacmimet seksuale, martesat e detyruara, gjymtimin e organeve gjentiale të femrave, abortin ose sterilizimin e detyruar. Shiko: <https://rm.coe.int/168046246b>

¹⁵ Në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës "Përforsimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: faza III", rezultati 2.2

| | | | | | | | |
|----------|---|----------------|-------------------------------|--|--|---------------------------------|--|
| | koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në nivelin lokal, si dhe mbrojtjes, trajtimit e qasjes në drejtësi përmes këtyre mekanizmave. | | Donatorët | Institucionet antare të Mekanizmave Koordinues OJQ | Mekanizmat Koordinues Më shumë grupe të ndryshme të grave, të rejave, vajzave, burrave, të rinjve e djemve, të informuar mbi mbrojtjen, trajtimin e qasjes në drejtësi përmes këtyre mekanizmave. | 13, kapitulli IV, nenet 18, 19) | <p>Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Istog, Viti, Kamenicë, Prizren, Klokot, Podujevë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Novobërdë, janë ndërmarr masa si: ndriqimi i objekteve të komunës me ngjyrë portokalli, vetëdijesimi i qytetarëve mbi pasojat e dhunës në familje, senaca informative në shkolla, takime, vizita etj.</p> <p>2. Gjithashtu, vazhdimi mbi implementimin e projektit të bankës botërore “Komunat për të rinjtë” nga projekti I MAPL nw komuna me komunitete të cënueshme:</p> <p>2.1 Raundi i parë i programit të trajnimit dhe subgranteve për të rinjtë po zbatohet në 10 komuna anembanë Kosovës. MAPL ka përzgjedhur dhe nënshkruar marrëveshje për implementim me këto komuna si përfituese të projektit M4Y: Glogoc, Hani Elezit, Rahovec, Skenderaj, Vushtrri, Junik, Kaçanik, Ferizaj. Uroševac, Ranillug/Ranilug dhe Zvečan/Zvečan. Në fazën e dytë projekti është duke u zbatuar në 15 komuna: Glogoc/Glogovac, Hani Elezit/ElezmHan, Rahovec/Orahovac, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Junik/Junik, Kaçanik/Kaçanik, Ferizaj/Urougnill, , Pejë, Gjakova, Podujevë, Graçanicë, Shtime; Fushë Kosovë/Kosovo Polje. - 249 vullnetarë janë trajnuar (25 vullnetarë nga komuniteti; 174 vullnetarë të nënprojektit; 50 monitorues të rinj) gjatë periudhës raportuese. Në trajnim morën pjesë gjithsej 159 femra dhe 90 meshkuj. Vullnetarët nuk ishin të angazhuar në raundin e parë për shkak të vonësve të pagesave nga MAPL. Vullnetarët do të angazhohen në muajin e dytë të vitit 2024.</p> <p>2.3. info shtesë Përmbledhje e nën-përfituesve</p> <p>Numri i përgjithshëm i anëtarëve të ekipit brenda grupeve të shpërblyera 788</p> <p>Totali i subgranteve të dhëna 141</p> <p>Numri i subgranteve të zbatuara nga grupet informale të të rinjve 71</p> <p>Numri i subgranteve të zbatuara nga OBK-të formale 82</p> <p>Numri i drejtuesve meshkuj të ekipit 59</p> <p>Numri i femrave drejtuesve të ekipit 94</p> <p>këtu hyjnë të gjitha grupet e cënueshme.</p> |
| III.5.5. | Lehtësimi i qasjes në drejtësi për qytetaret/qytetarët që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, veçanërisht për viktimat e dhunës në baza gjinore, | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Agjencia për Ndhim Juridike Falas si dhe OJQ-të e specializuara KGJK KPK | Numri i qytetarëve/qytetarëve të cilët kanë përfituar shërbime falas për qasje në drejtësi (përfshirë edhe për | | <p>Ofrimi i Shërbimeve Juridike Falas:</p> <p>Në ANJF gjatë vitit 2023 është ofruar ndihma juridike falas për të gjithë personat që kanë plotësuar kriteret e parapara me Ligjin 04/L-17 për Ndhim Juridike Falas dhe Ligjin 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik. Në vitin 2023 ndihma juridike falas u është ofruar 6081 qytetarëve, 2890 femrave dhe 3191 meshkujve. Sipas përkatësisë etnike prej tyre ndihmë juridike falas kanë përfituar 5214</p> |

| | | | | | |
|---|--|------------------|--|---|---|
| <p>dhunës seksuale, komuniteteve jo-shumicë dhe personat e zhvendosur, si dhe mbështetja me ndihmë juridike falas për personat e ekspozuar ndaj dhunës në procedura gjyqësore</p> | | <p>Donatorët</p> | | <p>rastet e ekspozuara ndaj dhunës në procedura gjyqësore), i ndarë sipas etnisë dhe gjinisë së përfituesve</p> | <p>shqiptar, 175 serb, 73 boshnjak, 54 turk, 213 ashkali, 156 egjiptian, 137 rom, 54 goran dhe 5 tjerë.</p> <p>Krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 32.19 %, ndërsa krahasuar me vitin 2022 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 3.75 %.</p> <p>Ofrimi i Shërbimeve Juridike Falas Viktimave të Dhunës në Familje gjatë vitit 2023:</p> <p>Gjatë vitit 2023 nga lëmia Penale - Dhunë në Familje ndihmë juridike falas kanë përfituar 76 qytetarë – prej tyre 54 femra dhe 22 meshkuj, për ta janë ndërmarrë 76 veprime juridike. Sipas përkatësisë etnike prej tyre ndihmë juridike falas kanë përfituar 66 shqiptar, 3 serb, 1 boshnjak, 1 turk, 4 ashkali dhe 1 rom.</p> <p>Ndërsa nga lëmia Civile - Dhunë në Familje, ndihmë juridike falas kanë përfituar 130 qytetarë – prej tyre 118 femra dhe 12 meshkuj, për ta janë ndërmarrë 256 veprime juridike. Sipas përkatësisë etnike prej tyre ndihmë juridike falas kanë përfituar 118 shqiptar, 1 serb, 4 boshnjak, 5 turk dhe 2 rom.</p> <p>Duke e parë trendin e rasteve të cilat frekuentojnë zyrat e ANJF-së, lidhur me rastet familjare të renditura më lartë, ku në pothuajse të gjitha rastet e zgjidhjes së martesës, besimit të fëmijëve, alimentacionit, ndarjes së pasurisë së përbashkët, kontaktit me fëmijë, kthimit të gjësendeve etj, përfituesit e ndihmës juridike falas kanë deklaruar se në vazhdimësi i janë ekspozuar dhunës fizike, psikike dhe ekonomike, por nuk i kanë raportuar rastet. Gjatë vitit 2023, në lëmin Civile - Familjare, është ofruar ndihma juridike falas për 782 përfitues të ndihmës juridike falas. Sipas gjinisë kanë përfituar 527 femra dhe 255 meshkuj. Për ta janë ndërmarrë 1214 veprime juridike. Sipas përkatësisë etnike prej tyre ndihmë juridike falas kanë përfituar 637 shqiptar, 45 serb, 13 boshnjak, 1 turk, 47 ashkali, 34 rom, 3 goran dhe 2 tjerë.</p> <p>Me ndryshimet ligjore që janë bërë gjatë vitit 2022 është bërë lehtësimi i qasjes në drejtësi për disa kategori të qytetarëve, kjo me Ligjin Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, ku janë përcaktuar kategoritë e veçanta përfituese të ndihmës juridike falas ku pavarësisht nga kriteret e kërkuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit bazik (pra, pa i shikuar fare kriteret) ndihma juridike falas i ofrohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. personave të dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999; 1.2. viktimave të dhunës në familje; 1.3. viktimave dëshmitare të dhunës, të cilët janë në varësinë e viktimave të dhunës në familje; 1.4. viktimave të dhunës në baza gjinore; 1.5. viktimave të cilitdo lloj të dhunës seksuale, përfshirë dhe |
|---|--|------------------|--|---|---|

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | <p>ngacmimin seksual;</p> <p>1.6. viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;</p> <p>1.7. viktimave të mitur;</p> <p>1.8. fëmijëve që jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;</p> <p>1.9. fëmijëve nën kujdestari që kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;</p> <p>1.10. personave të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent sipas ligjit në fuqi për mbrojtje nga diskriminimi;</p> <p>1.11. Gazetarëve, gazetarëve të pavarur, fotoreporterëve, kameramanëve dhe redaktorëve që punojnë në/për media të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe/ose në media anëtare në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).</p> <p>ANJF e ka të hartuar një strategji të komunikimit objektiv, qëllimi i së cilës është fokusimi në forcimin e nevojës për informim për të përmirësuar njohuritë ligjore dhe fuqizimin e qytetarëve, veçanërisht individëve ose grupeve në pozitë të pafavorshme, duke ofruar informacione ligjore që drejtojnë në ndërmarrjen e veprimeve përdorimin e platformave ekzistuese të informacionit dhe aktivizimin e një rrjeti të shoqërisë civile, organizatave në nivel lokal dhe të rinjve për të përçuar informacion.</p> <p>ANJF e ka zbatuar Udhëzuesin për Procesimin e Rasteve për Ndhimë Juridike Falas i cili është hartuar me përkrahjen e USAID vite më parë, ku u jepet përparësi rasteve të viktimave të dhunës dhe grupeve të marginalizuara. Poashtu ka edhe Manualin e Praktikuesve të Ndhimës Juridike në Kosovë – Çështjet civile, familjare dhe pasurore juridike si dhe Manualin e Praktikuesve të Ndhimës Juridike në Kosovë – Çështjet administrative i cili është hartuar gjatë vitit 2023.</p> <p>Agjencia ka bashkëpunuar me Zyrat për Mbrojtjen e Viktimave, Policinë e Kosovës, Strehimoret, Qendrat për Punë Sociale etj. nëpërmjet të cilave viktimat mund të njoftohen me mundësinë për të përfituar ndihmë juridike falas.</p> <p>Agjencia ka nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit për themelimin e Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje në këto komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Shtërpcë · Ranillug · Klinë · Pejë · Novobërdë · |
|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|----------|--|-----------|-------------------------------|--|---|--|
| | | | | | | <p>Deçan · Istog</p> <p>Me qëllim të bashkëpunimit Zyrat rajonale dhe zyrat mobile për ndihmë juridike falas përditësojnë listën e ofruesve të shërbimeve juridike, organizatave të interesit publik (p.sh. grupet e komuniteteve, grupet e përkrahjes si viktimave, shërbimet e këshillimit, grupeve të avokimit etj.) dhe ofruesve të shërbimeve sociale (p.sh. përkrahja e viktimave, shërbimet e këshillimit, strehimoret, etj.) në rajonin e tyre, duke mbajtur takime me këto grupe për të përcaktuar interesimin e tyre për komunikim të rregullt me Agjencinë.</p> <p>Me qëllim të informimit dhe vetëdijësimit ANJF organizon dhe bëhet pjesë e këtyre fushatave të ndërgjegjësimit: - Java e Ndihmës Juridike Falas me moton “Mbroj të drejtën tënde”, janë mbajtur konferenca, takime informuese me akter të ndryshëm komunal, është bërë informimi i qytetarëve përmes shpërndarjes së 5000 broshurave në 4 gjuhë shqip, serbisht, anglisht dhe turqisht si dhe në alfabetin BRAIL, 80 posterëve, 3 spoteve televizive, publikimeve në web faqe dhe rrjete sociale, 5 paraqitjeve në media, ligjeratave në institucione dhe me grupe të interes publik; me komitetet jo shumicë.</p> <p>Me përkrahjen e donatorit USAID Projekti JAK dhe donatorin GIZ kemi punuar në përgatitjen broshurave, postereve që u shtypen me rastin e Javës së Ndihmës Juridike Falas. Këtë vit kemi përgatitur edhe fletushka të veçanta lidhur me Ndihmën juridike falas për personat e riatdhesuar në Kosovë.</p> <p>- ANJF i është bashkangjitur si çdo vit tjetër edhe këtë vit kampanjës botërore "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore" duke qenë pjesë e dhjetra aktiviteteve u realizuan nga Ministria e Drejtësisë. Gjatë kësaj kampanje u shpërndanë afro 500 broshura.</p> <p>Me qëllim të arritjes së informacionit tek komunitetet jo shumicë gjatë vitit 2023 janë mbajtur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 6 Sesione informative ligjore me komunitetin Rom për Qasjen në Drejtësi së bashku me Eukojust në rajone të ndryshme të Kosovës. • 1 Sesion informativ ligjor me komunitetet jo shumicë në rajonin e Pejes nga ANJF, si dhe shumë takime e tryeza tjera. |
| III.5.6. | Të sigurohet qëndrueshëmeria e Ndihmës Juridike Falas në të gjitha komunat, përmes trajnimit të stafit për ndihmë juridike online, | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Agjencia për Ndihme Juridike falas si dhe OJQ-te e specializuara | Është rritur numri i zyrtareve/zyrtarëve e për ndihmë juridike në zyrat rajonale të Agjencisë | Shërbime të ofrimit të Ndihmës Juridike Falas. Aktualisht, Ndihma Juridike Falas ofrohet nëpërmjet 7 (shtatë) zyrave rajonale për ndihmë juridike falas të cilat funksionojnë në: ZRNJF Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj dhe përmes 14 (katërmëdhjetë) zyrave mobile të cilat funksionojnë në komunat në vijim: Fushë Kosovë, Drenas, Deçan, Istog, Suharekë, |

| | | | | | | |
|---------|--|----------------|-------------------------------|--|---|--|
| | për ndihmë juridike në zyrat e saj rajonale. | | Donatorët | | | <p>Dragash, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Malishevë, Graçanicë, Skënderaj dhe Kamenicë. Këto zyra financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.</p> <p>Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor, kemi dorëzuar projekt-propozime te donatorët dhe kemi arritur që ndihma juridike falas të ofrohet edhe përmes 6 (gjashtë) zyrave mobile të përkrahura financiarisht nga GIZ-i deri me 30 Qershor 2023, të cilat kanë funksionuar në komunat: Podujevë, Klinë, Lipjan, Shtime, Kaçanik dhe Hani i Elezit, duke mundësuar punësimin e 4 (katër) zyrtarëve të cilët kanë ofruar ndihmën juridike falas. Po ashtu Agjencia për Ndhmë Juridike Falas ka edhe Klinikën Mobile Lëvizëse, e cila funksionon për realizimin e fushatave senzibilizuese dhe informuese të qytetarëve.</p> <p>ANJF nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë nenin 22 të Ligjit për Ndhmë Juridike Falas ku për të arritur mbulueshmëri të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, parashihet hapja e Zyrave Mobile në të gjitha komunat e Kosovës.</p> <p>Kërkesa buxhetore e ANJF-së për të hapur Zyrat Mobile edhe në 6 komuna ka hasur përkrahje nga Ministria e Drejtësisë. Me qarkoren e fundit buxhetore të vitit 2024 janë siguruar 4 (katër) pozita zyrtar ligjor për zyrat mobile të përkrahura nga GIZ, e po ashtu është lejuar edhe 1 (një) pozitë zyrtar ligjor për hapjen e zyrës mobile edhe në një Komunë tjetër.</p> <p>Por ndihma juridike falas duhet të ofrohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës ngaqë mos hapja e këtyre zyrave paraqet qasje jo të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e këtyre komunave, të cilët janë në gjendje ekonomike të dobët.</p> <p>Sa i përket trajnimeve, paraprakisht është hartuar plani i trajnimeve dhe bazuar në plan gjatë vitit 2023 janë realizuar rreth 40 trajnime me përkrahjen e donatorëve dhe me buxhetin e ANJF-së. Në këto trajnime kanë marr pjesë të gjithë zyrtarët e zyrave Rajonale dhe Mobile (21) e po ashtu edhe zyrtarët e 6 zyrave mobile të përkrahura nga GIZ (6), pra gjithsejtë numri i komunave me staf të trajnuar është 28.</p> |
| III.5.7 | Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Ndhmë Juridike falas dhe Organizatave Joqeveritare të cilat ofrojnë Ndhmë Juridike falas | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | Agjencia për Ndhmë Juridike Falas Zyrat rajonale për ndihmë juridike falas OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike falas | Marrëveshjet e mirëkuptimi të arritura ndërmjet Agjencisë për Ndhmë Juridike falas dhe Organizatave Joqeveritare të cilat | Në Qershor të vitit 2023 është nënshkruar Rregullorja MD - NR. 05/2023, për përcaktimin e kriterëve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga OJQ-të që hynë në partneritet me Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas. Andaj bazuar në rregullore janë përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme; është hapur thirrja publike për OJQ-të për aplikim për hyrje në partneritet, është formuar Komisioni për vlerësimin e kriterëve dhe nga vlerësimet e Komisionit, gjashtë OJQ kanë plotësuar kriteret e |

| | | | | | | | |
|----------|---|----------------|--|--|--|---|---|
| | | | | | ofrojnë Ndihme Juridike falas | | përcaktuara në rregullore. Andaj tani jemi në fazën e lidhjes së Marrëveshjeve të Partneritetit me OJQ-të. |
| III.5.8. | Informimi i publikut përmes aktiviteteve për promovimin e Programit për kompensimin e viktimave të krimit ¹⁶ | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MD Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit | Është promovuar e drejta për kompensimin e viktimave të krimit, përmes kampanjave vetëdijuese, debateteve apo formave tjera të promovimit. | | Ne kuader të informimit të publikut për kompensimin e viktimave, janë zhvilluar aktivitete promovues përmes shtypjes së fletushkave dhe manualeve. Keto materiale kanë përmbajtur pjesë të ligjit mbi kompensimin e viktimave si dhe informata në lidhje me procesin e aplikimit, për cila vepra kërkohej kompensimi dhe infomatat e detajuara. Keto aktivitete janë zhvilluar në nivel regional përmes kandidateve të informimit dhe komunikimit të drejtperdrejt me qytetare. |
| III.5.9. | Sensibilizimi i shoqërisë përmes avokimit dhe vetëdijimit për qasje në drejtësi duke u fokusuar në të drejtat pronësore, dhunën në baza gjinore, të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe të drejtat tjera që rrjedhin nga legjislatiioni përkatës | 2022 T4 | Nuk ka nevojë për kosto shtesë ¹⁷ | ABGJ, Mbrojtësit e Viktimave-ZPSH, Avokati i Popullit Donatorët, shoqëria Civile | Fushata të realizuara | Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 - 2024, aktiviteti III.1.6 | <ul style="list-style-type: none"> • ABGJ ka realizuar 4 videospote vetëdijuese të cilët janë shfaqur në televizionin publik të Kosovës RTK : Vlera totale është 7250.00 euro: <ul style="list-style-type: none"> 1.Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve 2023 https://www.youtube.com/watch?v=NYuCL7TtB1Y 2.Parandalimin e ngacmimit seksual tek fëmijët https://www.youtube.com/watch?v=EqCHdzoEQmY 3.Parandalimi i Dhunës të çiftet adoleshente https://youtu.be/8RQ7lcjh7OM https://abgj.rks-gov.net/publikimet/120/video/120 4.Kosova Nderon kujtimin e Grave të Ndjera Viktima të Dhunës në Familje https://youtu.be/kl30-Pv8T1o https://abgj.rks-gov.net/publikimet/120/video/120 • ABGJ propozoi për miratim Qeverisë vazhdimin e masës afirmative “Udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë.” UA është vazhduar edhe për një vit prill 2023-prill 2024. • Agjencia për Barazi Gjinore ka mbështetur Komisionin Parlamentar për të Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat |

¹⁶ Ligji i Kosovës 05 / L-036 për kompensimin e viktimave të krimit (shiko:<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10936>) rregullon të drejtën për kompensim për viktimat e krimeve të dhunshme si dhe të varurit e tyre. Ligji u miratua në 2015 duke renditur krimet e dhunshme që kompensohen nga fondi i kompensimit të viktimave.Krimet që duhet të kompensohen përfshijnë: trafikimin e qenieve njerëzore, përdhunimin, abuzimin seksual të fëmijëve, vrasjen,dhe krimet e dhunës në familje siç përcaktohen në ligjin për mbrojtjen nga familja Dhuna.

¹⁷ Ky aktivitet është planifikuar në Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 - 2024 dhe bëhet fjalë pikërisht për aktivitetin III.1.6 të këtij dokumenti. Për sa kohë që kosto për këtë aktivitet është llogaritur në dokumentin e referencës, nuk ka nevojë të përlogaritjet edhe kosto shtesë në këtë Strategji. Llogaritjet për kosto shtesë të bëhen vetëm nëse mungon kosto për vitin 2024 në dokumentin e referencës

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | <p>e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione lidhur në procesin e Amendamentimit të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore. Në vlerë totale 3,422.00 euro.</p> <ul style="list-style-type: none"> • ABGJ ka realizuar 6 trajnime për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Gjatë muajve janar- dhjetor 2023 janë certifikuar 119 polic, në këto Komuna: Pejë, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. Në vlerë totale 6,853.60 Euro. • ABGJ me ftesë të Zyrtareve për Barazi Gjimore ka mbajtur 4 punëtori ne nivelin lokal ku kanë qenë të ftuar edhe Mekanizmat koordinues kundër dhunës ne familje, ku janë prezantuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Ligjin për Barazi Gjimore. Punëtorja është mbajtur ne këto Komuna: Fushe Kosove, Deçan, Vushtri, Lipjan dhe kane marre pjese 72 persona, nga këta janë 46 gra dhe 26 burra. Në vlerë totale 1,326.00 Euro. • ABGJ në bashkëpunim me Institutin e Kosovës së Administratës Publike dhe ne mbështetje te asistencës teknik UN Women, ka realizuar 16 trajnime për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës. Janë certifikuar 36 Zyrtare për Barazi Gjimore (ZBGJ) në Ministri dhe Komuna. Ne Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor janë certifikuar 112 zyrtare te nivelit udhëheqës dhe menaxherial. Trajnimet janë mbajtur ne 11 Komuna : Drenas, Viti, Lipjan, Kline, Deçan, Obiliq, Dragash, Kamenice, Skenderaj, Istog, Prizren janë certifikuar 227 zyrtare te nivelit udhëheqës dhe menaxherial. Buxheti i ABGJ ne vlerë prej 9,054.50 euro. • ABGJ ne vazhden e 16 Dite te Aktivizmit- Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas kane vizituar Qendër Korrektuese ne Lipjan, ku u takuan me gra te burgosura ne kete qendër dhe u diskutua për legjislacionit e Kosovës ne avancimin dhe përmirësimin e pozitës se gruas ne shoqëri. • Ndriçimi i Ndërtesës se Qeverise ne kuadër te fushatës se 16 Ditëve te Aktivizim, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës ne baza gjimore, ne vlere • Ndriçimi i Ndërtesës se Qeverise ne kuadër te fushatës se 16 Ditëve te Aktivizim, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës ne baza gjimore, ne vlere 1,587.70 euro. • Me rastin e mbajtjes se Konferencës te organizuara nga Ministrinë e Drejtësisë dhe presidentja ne kuadër te fushatës se 16 Ditëve te Aktivizim, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës ne baza gjimore, ABGJ ka mbështetur Ndriçimi e Ndërtesës se Ministrisë se Drejtësisë(ish Objekti i Rilindjes) ne vlere 1,587.70 euro. • Shtypja e materialeve promovuese (ombrellat, totbeg, kordelet e bardha, fletore) ne kuadër të shënimit të 16 Ditëve të Aktivizmit. Vlera |
|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|---|
| | | | | | | <p>totale 5477.15 euro.</p> <p>është</p> <p>• Me rastin e mbajtjes se Konferencës te organizuara nga Ministrinë e Drejtësisë dhe presidentja ne kuadër te fushatës se 16 Ditëve te Aktivizim, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës ne baza gjinore, ABGJ ka mbështetur Ndrichimi e Ndërtesës se Ministrisë se Drejtësisë(ish Objekti i Rilindjes) ne vlere 1,587.70 euro.</p> <p>• Shtypja e materialeve promovuese (ombrellat, totbeg, kordelet e bardha, fletore) ne kuadër të shënimit të 16 Ditëve të Aktivizimit. Vlera totale është 5477.15 euro.</p> <p>5. ABGJ përmes subvencionimit ka mbështetur “Qendrën Kosovare për Studime Gjinore” per realizimin e hulumtimit “ <i>Streotipet Gjinore dhe barrierat qe sfidojnë pjesëmarrjen e grave ne sport</i> “ne vlerë 10.000.00 euro. https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20dhe%20Vajzat%20n%C3%AB%20Fush%C3%ABn%20e%20Sportit.pdf Fushatat vetdijësuese : janë realizuar 2 fushata vetdijësuese dhe 2 tryeza diskutimi . Janë realizuar dy fushata vetëdijësuese :a) Muaj i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit- ABGJ në kuadër të muajit Tetor, Muaj i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit ka ndriçuar ndërtesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës me ngjyrën vjollcë dhe kordelen rozë si shenjë solidarizimi me të gjitha gratë që janë prekur nga kanceri i gjirit. buxheti në vlerë prej 1,587.70 euro. b) Fushata e 16 Ditëve të Aktivizimit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas- s, Është ndriçuar ndërtesa e Qeverisë me ngjyrë portokalli, në përmbyllje te fushates eshte realizuar nje tryeze diskutimi. Janë prodhuar materiale promovuese (fletore me numra kontaktues te institucioneve qe ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës ndaj grave dhe materiale tjera) . Totali i buxhetit 3,541.7 euro.</p> <p>Tryezat e diskutimit : ABGJ Shënimi i 8 Marsit Dita Ndërkombëtare e Gruas me temën “ Zhbëjmë paragjykimet, synojmë gjithë përfshirjen” me qellim te rritjes së pjesëmarrjes se grave ne procese vendimmarrëse ne nivelin legjislativ ekzekutiv, misione diplomatike dhe shërbimin civil. Buxheti në vlerë prej 2,000.00 €</p> <p>ABGJ në bashkëpunim me QKSGJ kanë mbajt takimin tradicional konsultativ të nivelit të lartë, me temë “ Pjesëmarrja e Grave në Tregun e Punës”. Janë publikuar rekomandimet per fushat përkatëse te rritjes se pjesëmarrjes se grave nd vendimmarrje ne administratën publike dhe ne</p> |
|--|--|--|--|--|--|---|

| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | <p>tregun e punës . Buxheti në vlerë vlere prej 1,405.50 euro. ABGJ ka realizuar tre videopsote senzibilizuese per ngritjen e vetëdijes dhe informimine opinionit për : a) Parandalim ndaj diskriminimit: https://www.youtube.com/watch?v=X81HgDOXFDc buxheti 1,240.00 €</p> <p>b) Videospoti Për raportimin e dhunimeve seksuale- Provat Biologjike https://www.youtube.com/watch?v=MpFOMw8f8LY buxheti 1,240.00 €</p> <p>c) videospoti për Parandalimin dhe trajtimin i ngacmimit seksual ne sport https://www.youtube.com/watch?v=bDswiLSu1Xc buxheti 1,240.00 €</p> <p>ABGJ ne bashkëpunim me Zyrtaret për Barazi Gjinore ne nivelin qendror - Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore dhe Infrastrukturës (28 pjesmarres) , dhe Ministrinë e Shëndetësisë (15 pjesmarres) ka realizuar dy punëtori me zyrtaret e këtyre ministrive ne kuadër te 16 Ditëve te aktivizmit- Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas. ABGJ - ka prezantuar kornizën ligjore për mbrojtjen nga dhuna ne familje dhe dhuna ndaj grave, dhe Procedurat Standarde te Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje.</p> |
|--|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | | |
|--------|---|---|---------------------------------|-----------------------|---|--|---|
| IV. | Objektivi strategjik: | Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat | | | | | |
| IV.1. | Objektivi specifik: | Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara për viktimat/ të mbijetuarat nga të gjithë grupet¹⁸, si dhe fëmijët viktimat dhe dëshmitarë të dhunës | | | | | |
| IV.1.1 | Avokimi në nivel qendror dhe lokal për rritjen e fondeve ekzistuese. | 2022-2024 | Buxheti i Kosovës dhe donatorët | MD, MFPT, MSH. Komuna | Rrija e buxhetit dhe fonde të qëndrueshme | | Mbështetja financiare e Strehimoreve që ofrojnë Shërbime Strehimi për viktimat e Dhunës në Familje: Me qëllim të qëndrueshmërisë financiare për strehimoret të cilat ofrojnë shërbime strehimi për viktimat e dhunës në familje, Ministria e Drejtësisë ka rritur buxhetin për Strehimoret, nga 1 milion ne 1,5. Nga ky buxhet, 10 strehimore në nivel të Kosovës, për herë të parë mbështeten plotësisht për shërbimet e strehimit dhe trajtimit psiko-social të viktimave gjatë qëndrueshmërisë në strehimore. |
| IV.1.2 | Ofrimi i trajnimeve të specializuara, sipas profilizimit të nevojshëm për shërbimet | 2022-2024 | Buxheti i Kosovës dhe donatorët | MFPT, MD, MSH. Komuna | Përmbushja e standardeve minimale | Konventa e Stambollit, Ligji për Zyrtar Publik, LSHSF, | Pjesërisht e zbatuar. |

¹⁸ “Nga të gjithë grupet” nënkupto nga zonat urbane dhe rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj

| | | | | | | | |
|---------|--|-----------|---------------------------------|--|---|---------------------------------|---|
| | mbështetëse të specializuara, në institucione publike dhe OJQ e specializuara, në proporcion me numrin e banorëve në secilën Komunë, duke ofruar edhe shërbime mobile për trajtimin e rasteve të dhunës në familje | | | | profesionale dhe strukturore Shërbimi i specializuar dhe mobil i këshillimit psiko-social i përshtatur me nevojat e grupeve të veçanta | Ligji për profesionet | |
| IV.1.3 | Funksionalizimi i Linjës Telefonike Kombëtare të ndihmës për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në dispozicion 24 orë, 7 ditë të javës, në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit | 2022-2026 | Buxheti i Kosovës dhe donatorët | MSH MFPT MD/KNDHF ABGJ MASHTI MAPL Komunat OJQ të specializuara | Linja Telefonike e Ndihmës funksionale dhe me efikasitet, me shërbim mbarë kombëtar, në dispozicion 24/7, dedikuar të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, me shërbim në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë dhe që plotëson standardet e Konventës së Stambollit. | Konventa e Stambollit | Linja telefonike ndihmëse në Ministrinë e Shëndetësisë është për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, funksionale në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë dhe shumë efektive me shërbime mbarë kombëtare në dispozicion 08:00 -16:00 (8 orë në ditë, në 5 ditë të javës, dedikuar të gjithë qytetarve të Kosovës. Vlenë të theksohet se kjo linjë telefonike nuk është e ndarë vetëm për rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave. |
| IV.1.4 | Ngritja e shkathtësive profesionale të stafit aktual dhe stafit të ri të shërbimeve riintegruese e fuqizuese, përmes punëtorive dhe trajnimeve, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave. | 2022-2024 | Qeveria, Komuna dhe donatorët | ZKN -MD, IKAP, KPSHSF, MSH OJQ të specializuara Këshilli i Evropës | Modul i validuar, ngritja e kapaciteteve profesionale ¹⁹ Lista e stafit të cilët kanë ndjekur trajnimet e specializuara | Konventa e Stambollit (neni 15) | Shërbimet Sociale nga Janari i vitit 2023 kanë kaluar në Ministrinë e Drejtësisë, aktualisht është duke u zhvilluar analiza ligjore dhe analiza e nevojave të Qendrave për Punë Sociale e cila pritet të publikohet në Prill, 2023. |
| IV.1.5. | Mbështetja e strehimoreve me financim të vazhdueshëm | 2023-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MAPL, Komunat, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e | Strehimoret të mbështetura në terma | Konventa e Stambollit | MD ka siguruar fondin shtesë edhe për 0,5 milion euro për mbështetje të strehimoreve në 10 komuna. Tani ky fond është 1,5 milion euro. |

¹⁹ Në përputhje me udhëzimet e cilësisë për strehimoret për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të zhvilluara nga KiE do të kryhen trajnime për qendrat për punë sociale dhe strehimoret (rezultati i projektit 3.1)

| | | | | | | | |
|---------|--|----------------|--|---|--|-----------------------|---|
| | | | | Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Prokuroria e Shtetit | infrastrukturorë e financiarë | | |
| IV.1.6. | Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe të strehimit për grupe të veçanta (djem dhe burra viktimat të dhunës në familje, personat LGBTI+, etj) | Në vazhdi mësi | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MAPL, MFPT MF Komunat OJQ | Shërbimi i specializuar i strehimit i përshtatur me nevojat e grupeve të veçanta | Konventa e Stambollit | <p>Në komuna ekzistojnë nëntë (9) strehimore funksionale për viktimat e dhunës në familje, në: Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë të Jugut, Novobërdë dhe Zubin Potok.</p> <p>Mekanizmat mbështesin strehimoret për të trajtuar më mirë rastet e dhunës në familje dhe dhunën ndaj grave, duke siguruar qasje të shpejtë në shërbimet e disponueshme për viktimat, shërbejnë si platformë për avokim në mënyrë që të marrin mjete financiare nga komunat përkatëse dhe mbështesin përfshirjen e të mbijetuarve të dhunës në baza gjinore në programet e banimit social.</p> <p>MAPL/ Në komunat: Novobërdë, Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Prizren dhe Pejë, objektet ku janë vendosur strehimoret janë dhuruar nga komunat përkatëse, derisa strehimoret tjera në Ferizaj dhe Mitrovica e Jugut paguajnë qira mujore. Ndërsa në Zubin Potok ekziston Strehimorja e quajtur "Shtëpia Regjionale e Sigurt", dhe operon në 4 komuna në veriun e Republikës së Kosovës, si dhe në 6 komuna kanë siguruar objektin: Gjakovë, Gjilan, Prishtinë, Prizren, Ranillug dhe Pejë.</p> <p>Bashkëpunimi ndër komunal në këtë fushë, janë 21 komuna të cilat ofrojnë mbështetje financiare për strehimoret: Prishtinë, Deçan, Glogoc, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Istog, Kamenicë, Lipjan, Malishevë, Mitrovica e Jugut, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prizren, Junik, Rahovec, Suharekë dhe Viti. Sipas përmbledhjes së komunave për mbështetja financiare është me shumë prej 107,500 €. Ndërsa komuna e Vushtrrisë ka raportuar se nuk kanë ofruar gatishmëri për marrëveshja të bashkëpunimit nga ana e Strehimores.</p> |
| IV.1.7. | Mbështetja financiare e shërbimeve për viktimat e sulmeve seksuale të ofruar në institucionet publike ose në OJQ e specializuara | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MFPT MF Komunat | Shërbimi i specializuar për viktimat e sulmeve seksuale i përshtatur me nevojat e grupeve të veçanta | Konventa e Stambollit | Vazhdon ofrimi i shërbimeve të strehimit, rehabilitimit dhe ri-integrimit për viktimat e dhunës në familje, grave dhe fëmijëve viktimat të formave të ndryshme të krimit në strehimoret e Kosovës. |
| IV.1.8. | Mbështetja financiare e shërbimeve për fëmijët viktimat dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës të ofruar në institucionet publike ose në OJQ e specializuara | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MFPT MF Komunat | Shërbimi i specializuar për fëmijët viktimat dhe fëmijët dëshmitarë të dhunës, i përshtatur me nevojat e | Konventa e Stambollit | Vazhdon ofrimi i shërbimeve të strehimit, rehabilitimit dhe ri-integrimit për fëmijët si viktimat të dhunës në familje, si dhe fëmijëve si viktimat të formave të ndryshme të krimit në strehimoren e specializuar vetëm për fëmijë, e cila ekziston në kuadër të OJQ-së "Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve". |

| | | | | | | | |
|---------|---|------|-------------------------------|------|--|---------------------------------|--|
| | | | | | grupmohës së targetuar | | |
| IV.1.9 | Caktimi në gjykata i koordinatorëve dhe gjyqtarëve e gjyqtarëve të profilizuar, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në aspektin civil dhe penal | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KGJK | Profesioniste e profesionistëve të profilizuar të gjyqësorit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit (neni 15) | Me miratimin e strategjisë, nga kryetarët e gjykatave është kërkuar të caktohen koordinatorët. Deri tani të gjitha gjykatat kanë caktuar koordinator. Në një pjesë të gjykatave tanimë janë profilizuar gjyqtarët, kurse për pjesën tjetër, mbetet të behet një gjë e tillë. |
| IV.1.10 | Themelimi i njësitit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në prokuroritë ku paraqiten një numër i madh i rasteve të dhunës në familje | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | KPK | Profilizimi i profesionisteve e profesionistëve të prokurorisë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit (neni 15) | Në të gjitha prokuroritë themelore janë të caktuar koordinatorët dhe zëvendës koordinatorët e dhunës në familje. |
| IV.1.11 | Themelimi i drejtorisë së veçantë në polici në nivel qendror dhe njësi nga niveli rajonal dhe lokal për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, angazhimi i 20 policeve | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MPB | Profesioniste e profesionistëve të profilizuar të policisë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave | Konventa e Stambollit (neni 15) | Sipas strukturs së re organizative të PK-së është formuar Drejtoria për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje, është emëruar Drejtori i Drejtorisë dhe është në proces të kompletimit me staf sipas strukturs. |
| IV.1.12 | Blerja e veturave për drejtorinë së veçantë në polici në nivel qendror dhe njësi nga niveli rajonal. | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MPB | Blerja e 7 veturave për drejtorinë së veçantë në polici në nivel qendror dhe njësi nga niveli rajonal | Konventa e Stambollit (neni 15) | Është në shqyrtim në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, blerja e veturave të reja. Aktualisht të gjithë stacionet policore dhe hetimet rajonale janë të pajisura me vetura. |
| IV.1.13 | Funksionalizimi i drejtorisë së veçantë në polici në nivel qendror dhe njësi nga niveli rajonal dhe lokal për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MPB | Funksionalizimi i drejtorisë së veçantë në polici në nivel qendror dhe njësi nga niveli rajonal dhe lokal. | Konventa e Stambollit (neni 15) | Menjëherë pas aprovimit të strukturës organizative e cila është në proces do të funksionalizohet Drejtoria për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje. Aktualisht këtë përgjegjësi e ka Sektori për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje. |

| | | | | | | | |
|---------|---|-----------|---|--|---|---------------------------------|---|
| IV.1.14 | Rritja e perqindjes se numrit të zyrtareve policore gra | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | MPB/PK | Më shumë zyrtare policore gra në plotësim edhe të parashikimeve ligjore kombëtare e ndërkombëtare për respektimin e parimit të të drejtës së viktimës për t'u trajtuar nga zyrtarë të të njëjtës gjini | Konventa e Stambollit (neni 15) | Nga 7811 gra police ne 2022 ka rritje ne 7949 ne vitin 2023. Numri i zyrtarëve gra në vazhdimësi lëviz për arsye të lëvizjes së stafit brenda organizatës policore edhe pse në të gjitha njësitë që merren me rastet e dhunës në familje, kemi të sistemuara femra. Personeli i Policisë së Kosovës të cilët/cilat merren me rastet e trajtimit të dhunës në familje janë; Drejtoria Rajonale e Policisë: Prishtinë 15 F / 15 M, Mitrovicë Jug 8 F/ 6 M, Mitrovicë Veri 1 F/1 M, Pejë 5F/5M, Prizren3 F/9 M,Ferizaj 6 F/ 7 M, Gjilan 8 F/ 9 M dhe Gjakovë 5 F/ 4M. Gjithsej: 51 gra dhe 56 burra. |
| IV.1.15 | Ngritja dhe funksionalizimi i dhomave mike për intervistimin dhe trajtimin e viktimave në nivel lokal për Policinë | 2022-2026 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët | MPB Policia | Dhomat mike për intervistimin e viktimave të ngritura dhe funksionale në godinat e policisë së Kosovës | Konventa e Stambollit | Në kuadër të Policisë së Kosovës janë 26 dhoma mike-funksionale për intervistimin e viktimave të dhunës në familje, të njëjtat shfrytëzohen edhe për viktimat e trafikimit dhe për delikuencë me të mitur. Jemi në ngritje të kapaciteteve shtesë duke ndarë edhe hapësirë të tjera. |
| IV.1.16 | Sigurimi i mjeteve të nevojshme për transport të menjëhershëm dhe adekuat të viktimave si dhe i buxheti për shujtë dhe shërbimeve tjera të domosdoshme për viktimat, përgjatë kohës së qëndrimit në stacionin policor | 2022-2024 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës Komunat Donatorët | MPB Policia MSH Komunat MFPT ASKK | Transporti i viktimave sipas nevojës në polici apo QPS i kryer menjëherë dhe me mjete të përshtatshme Mjete transporti për policinë Mjete transporti për Qendrat për Punë Sociale Buxhet i menaxhueshëm cash për shujtë për viktimat | Konventa e Stambollit | Për të gjitha viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e tjera, Policia e Kosovës, në rastet e raportimit paraqitet në vendin e ngjarjes dhe kryen transportimin e tyre në stacion policor, nëse kërkohet edhe në institucionet shëndetësore. Çështje e sigurimit të shujtave është duke u shqyrtuar për shkak të planifikimit të buxhetit dhe besohet që për periudhën 6 mujore do të rregullohet. Në bazë të Ligjit 08/L-185, neni 21 paragrafi 2 - QPS duhet të krijojne një fond emergjent për nevojat e viktimave gjatë periudhës kur ata/ato janë në polici. Policia siguron : - transportin e viktimës dhe vartësve të saj, në objektin shëndetësor për trajtim ose kontrollim mjekësor gjatë procedimit të rastit; -transportin e viktimës e sipas nevojës edhe vartësve të saj deri në një vendstrehim apo vendqëndrim tjetër të përshtatshëm dhe të sigurt, me kërkesën e viktimës dhe së bashku me punëtorin social. Transporti ofrohet me veturat zyrtare të PK-së |

| | | | | | | | |
|-------------|---|---|---------------------------------|---|--|--|--|
| IV.1.17 | Fuqizimi i ZMNV-ve me kapacitete adekuatë njerëzore, financiare e infrastrukturore | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | ZKPSH | Shtimi i stafit të ZMNV nga 25 në 40 punonjëse dhe punonjës të rekrutuar | | Për momentin në ZMNV janë të punësuar 34 zyrtarë. Prej tyre 3 kanë filluar punën në vitin 2023. |
| IV.1.18 | Fuqizimi i zyres së ZMNV-ve | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | ZKPSH | Furnizimi me laptop/kopjuter, dhe inventare të zyres për stafin e ri. | | Të gjithë zyrtarët e ZMNV janë të furnizuar me kompjuter të cilët kanë performancë të avancuara si dhe kanë qasje në sistemin elektronik për menaxhimin e rasteve. Po ashtu, Ambasada e Amerikës i ka furnizuar me disa laptop udhëheqësit regional të ZMNV. Gjatë vitit 2023 nuk kemi pranuar asnjë kërkesë për furnizim me pajisje të TI. Sa i përket inventarit stafi janë të pajisur me inventarin e nevojshme dhe kurdo që kanë nevojë, KPK i mundëson sipas kërkesave të tyre dhe mundësive buxhetore. |
| IV.1.19 | Blerja e veturave për ZMNV-ve | 2022-2023 | Buxheti i Qeverisë së Kosovës | ZKPSH | Shtimi i mjeteve lëvizëse (makina) për 7 vetura. | | KPK çdoherë u ka ofruar përkrahje ZMNV në këtë drejtim dhe për momentin janë 9 vetura në shfrytëzim të ZMNV. |
| IV.2 | Objektivi specifik | Zbatimi i politikave që mundësojnë riintegrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave të dhunës | | | | | |
| IV.2.1 | Profilizimi i profesionistëve/profesionistëve që ofrojnë shërbime riintegruese e për fuqizim të qëndrueshëm të viktimave | 2022-2024 | Buxheti i Kosovës dhe donatorët | MAPL, Komunitat | Lista e stafit të profilizuar | Ligji për zyrtar publik, Ligji për profesionet, Ligji SHSF | 34 komuna kanë caktuar zyrtarë të cilët janë/do të profilizohen. |
| IV.2.2 | Krijimi i databazës për numrin e viktimave/ të mbijetuarave të dhunës të riintegruara e fuqizuara përmes programeve përkatëse, në nivel qendror e lokal | 2022 | Buxheti i Kosovës dhe donatorët | MD/Zyra e koordinatores, MFPT | Databaza e krijuar/përditësuar | Konventa e Stambollit | Masa e punësimit për gra viktime të dhunës është lansuar në dhjetor të vitit 2023. Në lidhje me zbatimin e kësaj mase janë përfshirë një sërë mekanizmesh institucionale. Kjo masë e lansuar është për periudhë gjashtëmujore me mundësi vazhdimi dhe aktualisht është në proces të zbatimit |
| IV.2.3 | Identifikimi i shkathtësive, referimi për orientim profesional dhe dizajnimin e programeve të | 2024 - 2026 | Qeveria e Kosovës dhe Donatorët | MFPT, MSH, MD, MASHT, OJQ e specializuara | Lista e shkathtësive të identifikuar | Konventa e Stambollit | Ky aktivitet është planifikuar të fillojë në vitin 2024. |

| | | | | | | | |
|---------|--|-----------|-------------------------------|--|--|-----------------------|---|
| | reja në përputhje me nevojat e identifikuar për zhvillim të shkathtësive dhe përshtatja e programeve aktuale për aftësim profesional. | | | | Programe të konsoliduara për aftësim profesional. | | |
| IV.2.4. | Ofrimi i mundësive për punësim të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, përmes bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat. | 2022-2026 | Qeveria e Kosovës dhe Donoret | MFPT, Zyrat e Punësimit Komunitat Institucione të tjera lokale, antare të Mekanizmave Koordinues | Rastet e referuara të trajtuara me prioritet dhe të punësuara. | Konventa e Stambollit | Pjesërisht e zbatuar nga OJQ-të në bashkëpunim me QPS-në dhe Zyrat e punësimit. |
| IV.2.5. | Zhvillimi i planit të banimit social trevjeçar në Komuna dhe planifikimi i banimit social për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (qiratë, ofrimi i banimit). | 2022-2024 | Qeveria e Kosovës, Komunitat | MAPL, Komunitat | Banimit social për viktimat i konsoliduar | Konventa e Stambollit | 1. Komunitat kanë raportuar edhe për miratim të Planit tre-vjeçar për strehim social, i cili është hartuar në 15 komuna: Deçan, Glllogoc, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gracanicë, Istog, Kaçanik, Klinë, Malishevë, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Rahovec, Skenderaj dhe Suharekë, derisa 6 komuna janë në proces: Ferizaj, Gjilan, Kamericë, Prizren, Junik, dhe Viti. v. Gjatë vitit 2022 mbështetje e komuniteteve, nëpërmjet Fondit prej 1 milion euro; vi. Gjatë vitit 2023 janë ndarë 2,915,000.00 € nga qeveria për komunitetet jo shumicë të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale dhe që nuk kanë kushte adekuate të banimit, në mënyrë që të ju krijohen kushte normale për jetesë nëpër komunitat e tyre. Prej 2,915,000.00 € ku 2,000,000.00 € janë ndarë për ndërtimin e shtëpive dhe 915,000.00 € për renovimin e shtëpive (Per ndërtim kane perfituar gjithësjt 78, 57 shtëpi në 34 komuna dhe 21 shtëpi në komuna e veriut të Republikës së Kosovës). Nga 57 shtëpi, përfituesit janë 5 gra. Ndërsa në 21 shtëpi tjera, nuk jane nxjerr te dhenat. https://mapl.rks-gov.net/shpallje-konkurse/thirrje-per-propozime/ |
| IV.2.6. | Krijimi i fondit për grande për punësim të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022-2024 | Qeveria e Kosovës, Komunitat | MD, MFPT | Fondi i krijuar | Konventa e Stambollit | I pazbatuar. |
| IV.2.7. | Krijimi i fondit për grande për vetëpunësim të viktimat të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022-2024 | Qeveria e Kosovës, Komunitat | MFPT, MBPZHR, MTI-se Qeveria e Kosovës | Fondi i krijuar | Konventa e Stambollit | I pazbatuar. |

| | | | | | | | |
|---------|---|-----------|-------------------|-----------------------------------|---|--|--|
| IV.2.8. | Krijimi i lehtësirave për punëdhënësit/bizneset të cilët punësojnë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë, përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022-2024 | Qeveria e Kosovës | MD, Qeveria e Kosovës, MFPT, MZHE | Raportimi i numrit të viktimave të punësuar. | Konventa e Stambollit | Ky aktivitet nderlidhet me aktivitetin IV.2.2 |
| IV.2.9. | Subvencionimi i projekteve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022-2024 | Qeveria e Kosovës | ABGJ/ZKM; Komunitat; MKRS; MTI | Projektet për fuqizimin ekonomik të grave të zbatuara | Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 -2024 | Këtë periudhë raportimi nuk janë përzgjedhë ende OJQ-të për shkak që nuk i kanë plotësuar kriteret |
| IV.2.10 | Subvencionimi i pagesave për kopshte të fëmijëve të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave | 2022-2024 | Qeveria e Kosovës | ABGJ, Komunitat | Lehtësimi i situatës së grave viktime të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe qasjes në edukim të fëmijëve të tyre | Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 -2024 | Në pyetjen e cila sipas pyetësorëve të përgatitur nga MAPL ka qenë se sa është bërë subvencionimi i pagesave për kopshte të fëmijëve të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në komuna. Në këtë pikë komunitat të cilat veç kanë filluar të zbatojnë janë 11: Deçan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjiilan, Istog, Lipjan, Malishevë, Prishtinë, Junik, Suharekë, dhe Vushtrri. Komuna e Fushës Kosovës dhe Malishevës kanë raportuar me shifra, 11 fëmijë në Fushë Kosovë dhe 8 fëmijë në komunën e Malishevës. Sa i përket komunës së Gjilanit gjatë vitit 2022 ka subvencionuar fëmijët e nënave vetëshqyese dhe është në proces për subvencionimin e pagesave të kopshteve për fëmijët të viktimave të dhunës në familje. Ndërsa komuna e Lipjanit subvencionimin e pagesave të kopshteve për fëmijët e dhunës në familje e zbaton nga viti 2016-2017. Në raportin e Performancës, janë pasqyruar të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe: Përqindje me e lartë është shënuar në dy tregues, Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 69.13% dhe fëmijë në nevojë që iu është siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 90.99% https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/01/Raporti-i-Performances-se-Komunave-janar-Dhjetor-2022.pdf |